

**Organizata punëtore
ndërkombëtare:**

**Doracak për pakicat
dhe vendasit**

nga Chandra Roy dhe Mike Kaye



minority
rights
group
international

Organizata punëtore ndërkombëtare: Doracak për pakicat dhe njerëzit vendës

© Minority Rights Group International and Anti-Slavery International 2002
Të gjitha të drejtat të mbrojtura

Materiali nga ky publikim mund të shumëzohet për mesimdhënie ose qëllime të tjera jo-komerciale. Asnjë pjesë nuk mund të shumëzohet në asnjë formë për qëllime komerciale pa leje paraprake të shprehura qartë nga bartësit e autorizimit.

Për informata të tjera ju lutemi kontaktoni MRG Katalog CIP (kasetë) për këtë botim keni në dispozicion në Librarinë Britanike
ISBN 1 8976 93 39 7
Botuar në Maj 2002
Pëpunimi grafik i bërë nga Kavita Graphics
Shtypur në Mbretërinë e Bashkuar në letër të bardhë (pa ngjyrë)

Falënderim

Organizata MRG (Minority Rights Group International) dhe organizata Anti-Slavery International shprehin mirënjohje të lartë falënderuese ndihmës së Komisionit Europian, Trustit Bëmirs T.U.U.T. dhe Fondacionit Bëmirs U.I.A. dhe të gjitha organizatave dhe individëve të cilët dhanë ndihmë financiare dhe të tjera për këtë botim. Minority Rights Group International dhe Anti-Slavery International janë mirënjohës ndaj gjithë personelit dhe ekspertëve lexues të pavarur që i dhanë kontribut këtij botimi, veçanërisht ndaj Chris Chapman (nëpunës i MRG) dhe Katrina Payne (Redaktore në MRG).

Ky botim është autorizuar dhe është botuar nga Minority Rights Group International dhe Anti-Slavery International kontribut për njohjen publike të çështjes që e përbën temën. Teksti dhe vështrimet e autorëve nuk paraqesin detyrimisht në çdo detaj dhe në të gjitha aspektet vështrimet kolektive të të dy organizatave.

Atorët

CHANDRA ROY është një gjykatëse ndërkombëtare e cila ndihmoi të themelohet organizata UNPO (në Anglisht- Unrepresented Nations and Peoples Organization) (Organizata e Popujve dhe Njerëzve të Papërfaqshuar). Ajo ka punuar në departmanin juridik të degës Equality and Employment Branch të organizatës ILO (Dega e Barabarsisë dhe Zhvillimit e ILO), dhe ishte ndihmëse në vendosjen e një projekti të ILO-s në Konventën Nr.169. Chandra momentalisht punon si një konsultante e pavarur.

MIKE KAYE është koordinator i degës së komunikimeve në organizatën Anti-Slavery International.

Organizata ndërkombëtare për të drejtat e pakicave Minority Rights Group International (MRG)

MRG është një organizatë ndërkombëtare joqeveritare që punon t'i mbrojtë të drejtat e pakicave etnike, religjioze dhe gjuhësore si dhe të njerëzve vendës (autoktonë) anembanë botës, dhe të përkrahë bashkëpunimin ndërmjet komuniteteve.

MRG:

- Bën autorizimin dhe publikimin e Raporteve të hulumtuara mirë dhe të arritshme, Libra dhe referate mbi çështjen e pakicave dhe të njerëzve vendës.
- Organizon dhe përkrah të drejtat e pakicave dhe të njerëzve vendës nëpërmes mbrojtjes së drejtpërdrejtë në forumet ndërkombëtare dhe në dialogje me qeveritë.
- Thurr një rrjetë globale të organizatave të qëllim-ngjajshme dhe bashkësive pakicore që të bashkëveprojnë në çështje të të drejtave të pakicave dhe njerëzve vendës.

Të gjitha porositë për këtë doracak duhen dërguar në MRG.

Për informata më detale kontaktoni:
Minority Rights Group International
379 Brixton Road
London
SW97DE
UK

Tel: +44 (0)20 7978 9498
Fax: +44 (0)20 7738 6265

E-mail: minority.rights@mrgmail.org
Website: www.minorityrights.org

Së pari e publikuar në anglisht si The International Labour Organization: A Handbook for Minorities and Indigenous Peoples, © Minority Rights Group, London, UK dhe Anti-Slavery International, London, UK, 2002.

Ky edicion © ADI, Gostivar, Maqedoni 2003 Përkthimi shqip © ADI, Gostivar, Maqedoni
ISBN 9989-133-09-3
1. Roy, Chandra 2. Kaye, Mike
a) Organizata punëtore ndërkombëtare - Doracakë
COBISS-ID 51579658

Kundër skllavërimin - (organizatë) ndërkombëtare (Anti - Slavery International)

Anti-Slavery International është organizata më e vjetër botërore joqeveritare ndërkombëtare e të drejtave të njeriut, dhe është themeluar në 1839. Anti-Slavery International angazhohet t'i eliminojë të gjitha format e robërisë nëpërmes të hulumtimeve, ngritjes së vetëdijes dhe fushatave. Ajo punon me organizata lokale që t'u bëjnë shtypje qeverive të pranojnë robërinë (skllavërinë) dhe të ndërmarrin hapa efektive për të zhdukur atë praktikë.

Për informata më detale kontaktoni:
Anti-Slavery International
Thomas Clarkson House
The Stableyard
Broomgrove road
London
SW9 9TL
UK

Tel: + 44(0)20 7501 8920
Fax: + 44(0)20 7738 4410

E-mail: info@antislavery.org
Website: www.antislavery.org

Asociacioni për Iniciativa Demokratike dhe Minority Rights Group i falemenderohen Charles Stewart Mott Foundation, European Commission dhe UK Department for International Development - Know How Fund për përkrahjen e tyre financiare të projektit për përkthimin në gjuhën shqipe.

Përktheu: Zejnelabedin Gashi

Tirazhi: 1.000 kopje

Organizata punëtore ndërkombëtare: Doracak për pakicat dhe vendasit

Përmbajtja	Faqe
Fjalori	4
Parathënie	5
I. Organizata Punëtore Ndërkombëtare	
1. Prapavija (biografia) historike	6
2. Principet fundamentale	6
3. Struktura e ILO-s	7
II. Standardet punëtore ndërkombëtare	
1. Hyrje	9
2. Ndikimi i standardeve punëtore ndërkombëtare	10
3. Klasifikimi i standardeve punëtore ndërkombëtare	11
III. Të drejtat e njeriut	
1. Hyrje	12
2. Diskriminimi	12
3. Puna e detyrimshme	15
4. Liria e asociacionit	16
5. Puna e fëmijëve	17
6. Deklarata mbi Principet dhe të Drejtat Fundamentale në Punë (1988)	19
IV. Njerëzit vendës	
1. Prapavija historike	21
2. Konventa e ILO-s mbi njerëzit vendës	21
V. Mekanizmat që sigurojnë përshtatje me standardet e ILO-s	
1. Sistemi mbikëqyrës	26
2. Trupat mbikëqyrës	27
3. Ndihma teknike	32
VI. Ankesat	
1. Procedura kushtetuese	33
2. Procedurat speciale për ankesat në lidhje me Lirië së Asociacionit	36
3. Kontaktet e drejtpërdrejta	37
VII. Studimet e rasteve	
1. Hyrje	39
2. Burma (Myanmar)	39
3. Bangladeshi	40
4. Meksikoja	41
VIII. Si të punohet me ILO-n	
1. Qasja në ILO	43
2. Puna me ILO-n	45
Shënime	48
Bibliografi	52
Adresa të dobishme	53

nga Chandra Roy dhe Mike Kaye

Fjalori

Komiteti i Ekspertëve për Zbatimin e Konventave dhe Rekomandimeve (Komiteti i Ekspertëve) në origjinal - **Committee of Experts on the Application of Conventions and Recommendations (Committee of Experts)**

Komiteti përbëhet prej 20 ekspertëve të pavarur dhe nga fusha të ndryshme të cilët vështrojnë se gjer në çfarë mase zbatohen Konventat dhe Rekomandimet e ILO-s. Përfundimet e tija publikohen në një raport -

çdo vit në Mars, dhe diskutohen në Konferencën Ndërkombëtare të Punës-(International Labour Conference) nga ana e Komitetit mbi Miratimin e Standardeve.

Komisioni për Hetime - (në origjinal - Commission of Inquiry) - Ky organ përbëhet prej tre anëtarëve të cilët janë të emëruar nga Trupi Drejtues (Governing Body) sipas rekomandimit të Drejtorisë së Përgjithshme (Director-General). Ky komision është i themeluar posaçërisht në bazë të Artikullit 26 (Neni 26) të procedurës ankesore që të vë në dukje shkeljen (mosrespektimin) e raportuar të ndonjë Konvente të ILO-s.

Komiteti Këshillues për Miratimin e Standardeve - (Komiteti Aplikativ) - në origjinal- **Conference Committee on the Application of Standards - (Applications Committee)** - Ky është një Komitet Trepalësh i cili takohet çdo vit në Konferencën Ndërkombëtare të Punës. Ai debaton çështje që vijnë prej (raporteve të)

Komitetit të Ekspertëve të ILO-s mbi të dy aspektet - të zbatimit të përgjithshëm të standardeve, dhe të rasteve të vendeve të posaçme.

Trupi Drejtues -(T. Qeverisë) - (në origjinal - **Governing Body**)- Trupi Drejtues është organ ekzekutiv i ILO-s. Ai vë në zbatim vendimet politike të marrura në Konferencën Ndërkombëtare të Punës dhe tjetërkundi në sistemin e ILO-s. Ai përpilon programin dhe buxhetin e ILO-s për diskutim në Konferencën Ndërkombëtare të Punës dhe gjithashtu zgjedh edhe Drejtorinë Gjenerale të ILO-s.

Instrument -(në origjinal-Instrument) Ky është një term tjetër për dokumente si Konventë, Covenant (Marrëveshje e Vulosur), Deklaratë, Rekomandim, Traktat, etj.

Konferenca Ndërkombëtare e Punës - (në origjinal - **International Labour Conference**) - Konferenca Ndërkombëtare e Punës takohen çdo vit për të diskutue dhe përcaktue politikën dhe prioritetet e ILO-s. Ajo debaton dhe miraton Konventa dhe Rekomandime të reja të ILO-s, dhe bën monitoring mbi zbatimin e standardeve ekzistuese të punës. Ajo gjithashtu miraton buxhetin e ILO-s dhe zgjedh Trupin Drejtues të saj nga anëtarët e vet.

Zyra Ndërkombëtare e Punës - (në origjinal- **International Labour Office**) - Zyra Ndërkombëtare e Punës është sekretariati i përhershëm i ILO-s, përgjegjëse për kërkime (hulumtime), publikime dhe stërvitje (trejnim).

Trupi Drejtues e zgjedh për periudhën e ardhëshme pesë-vjeçare Drejtorinë e vet të Përgjithshme.

Organizata Ndërkombëtare e Punës - (në origjinal - **International Labour Organization - ILO**) - (në vijim do të përdoret shkurtesa **ILO**) - Ky është një agjencion i specializuar i sistemit të Kombeve të Bashkuara që zhvillon, nxit dhe përkrah standardet ndërkombëtare të punës. ILO është një organizatë trepalëshe që nënkupton se përfaqësuesit e sindikatave, organizatave punëdhënëse dhe të qeverive janë të gjithë të përfaqësuar në proceset vendim-marëse të ILO-s.

Mekanizmi i ILO-s - (në origjinal - **ILO mechanism**) - Ky është term tjetër për procedurë.

Ratifikimi (ose -Zbatimi zyrtar) - (në origjinal- **Ratification**) - Ky është një akt formal me anë të të cilit një shtet lidhet që të ve në zbatim një Konventë ose Traktat të veçantë. Procedura e brendshme mund të dallojë nga një shtet në tjetër, dhe mund të përfshijë miratim ose përkrahje nga Parlamenti. Sidoqoftë, ratifikimi është i kompletuar kur një komunikim formal si një letër ose dokument tjetër të ketë arritur në organizatën ndërkombëtare në barrë të asaj konvente, dmth. të ILO-s, dhe është regjistruar.

Rekomandimi - (në origjinal - **Recommendation**) Ky paraqet kryesisht një udhëheqje se si një Konventë ose Traktat mund të zbatohet në një mënyrë praktike. Ai është jo-lidhës, nuk mund të të ratifikohet dhe nuk krijon kurrfarë obligimesh.

Standardi - (në origj. - **Standard**) Ky është një Konventë, Marrëveshje (e vulosur), Traktat ose pajtim tjetër ndërkombëtar, që vendos kushte ose direktiva minimale në një subjekt të posaçëm.

Shteti Anëtar - (në origj.- **State Party**) - Shtet që është i lidhur me një Konventë ose Traktat të veçantë.

Komitetet Trepalëshe të Trupit Drejtues - (në origjinal - **Tripartite Committees of the Governing Body**)-

Këto përbëhen prej tre anëtarëve të Trupit Drejtues, nga një anëtar prej secilit prej anëtarëve përbërës të ILO-s, dmth. të punëdhënësve, të punëtorëve dhe të grupeve qeveritare. Komitetet Trepalëshe janë posaçërisht të themeluara sipas Artikullit 24 të procedurës së Paraqitjeve që të vë në dukje shkeljen e raportuar të një Konvente të ratifikuar të ILO-s.

Parathënie

Organizata Ndërkombëtare e Punës - (ILO) u krijue në 1919 duke bashkuar qeveritë, punëdhënësit dhe sindikatat që të punojnë për drejtësi shoqërore dhe kushte më të mira të jetës dhe punës. Pesëdhjetë vite më vonë, në 1969, ajo fitoi Çmimin e Nobel-it për Paqe si njohje të zotimit të saj për qëllimin - barazi dhe drejtësi për të gjithë.

ILO nuk është aq shumë i njohur, sidomos jo jashta qarqeve të punëtorëve dhe sindikatave punëtoje. Ajo është agjencion udhëheqës i Kombeve të Bashkuara i specializuar në të drejtat e punës, dhe ka një mandat që përfshin një sërë të çështjeve socio-ekonomike. ILO ka qenë aktivisht e angazhuar në mbrojtjen dhe përparimin e të drejtave njerëzore, por puna e saj në këtë fushë ka qenë e nënçmuar shumë dhe nuk i është dhënë vëmendje e duhur si një forum i qëndrueshëm për çështje tjera përveç se për pyetje të punës.

Veprimtaria e ILO-s është përqëndruar, por jo kufizuar, në ambientin e punës, dhe ka përfshirë çështje si puna e detyrimshme, liria e asociimit, punëtorët emigrantë, puna e natës, sigurimi social, etj. Por ajo gjithashtu ka pasë punuar për fëmijë, diskriminim, gjininë, dhe njerëzit vendës (autoktonë) dhe pakicat - çështje që shumë njerëz nuk do t'i lidhnin automatikisht me botën e punës.

Fuqia e ILO-s mund të shihet në Marrëveshjet e shumta Ndërkombëtare që ajo i ka miratuar. Ato janë të mbështetura në tema të përgjithshme që janë të përbashkëta për shumë shtete, dhe që mund të aplikohen anembanë botës. Marrëveshjet e ILO-s përcaktojnë minimumin e standardeve që ndihmojnë të udhëhiqet puna në nivele nacionale, dhe janë përdorur për të inkurajuar zhvillimin e legjislativitetit të brendshëm dhe të kodeve punuese që këto t'a përmirsojnë mbrojtjen e të drejtave të punës.¹

ILO gjithashtu ka krijuar një sistem për të u kujdesë për miratimin e standardeve të saja (dmth. standardet ndërkombëtare legale ose instrumentet të përfshijnë Marrëveshje, Konventa etj.). Ky sistem përfshin një numër të trupave dhe proceseve që të vlerësojnë se gjer në çfarë mase një shtet i plotëson obligimet e tija ndërkombëtare. Në këtë mënyrë iu është tërhequr vëmendje shumë shprehjeve të të drejtave njerëzore, duke përfshirë probleme si çështjen e punësimit të fëmijëve në Brazil dhe Indi, punën e detyrimshme në Burmë, dhe pozitën e grave në Afganistan.

Në botën e sotshme të tregëtisë së lirë dhe integritit të ekonomive, ndikimi i globalizimit ka ndryshuar nga shteti në shtet dhe nga një sektor në tjetrin. Në disa shtete hasim prodhimtari të rritur dhe begati

Ndërsa në disa të tjera pabarazitë janë ngulitur thellë - të varfërit duke u varfëruar ende më tepër. Kjo ka patur ndikim më të rëndë në grupet më të dobëta, duke përfshirë pakicat dhe njerëzit vendës.

Është me rëndësi të orvatemi të bindemi se me çmim të mbrojtjes më të ultë sociale nuk janë arritur pengesa më të ulëta tregëtare dhe konkurrenca më e madhe.

Lidhja ndërmjet tregëtisë dhe punës është gjë qendrore në debatimin mbi globalizimin, dhe ka ngjallur interesim në punën e ILO-s. Prandaj është gjë e dobishme për organizatat dhe individët që të informohen mbi ILO-n dhe atë se si punon ajo, dhe t'i gjurmojnë potencialet e saja me synim të arritjes së barazisë dhe drejtësisë për të gjithë.

Ky pra është shkaku që MRG dhe Anti-Slavery International e botojnë këtë doracak mbi ILO-n.

Qëllimi i tij kryesor është që të sigurojë një njohim mbi ILO-n dhe qasjet që i siguron për mbrojtjen dhe përkrahjen (avancimin) e të drejtave të pakicave dhe të njerëzve vendës.² Ai i ofron lexuesit një pasqyrë të strukturave kryesore të ILO-s, këshillave (komiteteve) dhe metodave të saja punuese, në një format të përshtatshëm, dhe me njohim praktik mbi përdorimin e tyre.

Meqenëse Doracaku është posaçërisht i dizajnuar për pakicat dhe njerëzit vendës, dhe për organizatat joqeveritare (OJQ në tekst në vijim, e në origjinal - non-governmental organizations - NGO) - qofshin ato OJQ të pakicave ose të njerëzve vendës ose OJQ që punojnë me njerëzit vendës apo me pakicat - ai mund të përdoret nga ana e secilit që dëshiron të njohet më tepër me ILO-n, dhe forcimin dhe mbrojtjen e të drejtave njerëzore.

Partnerët e ILO-s, në veçanti organizatat e punëtorëve, kanë luajtur rol udhëheqës në monitoringun (kontrollimin) në aplikimin e Konventave të ILO-s. Doracaku është i mbështetur në bazë të përvojave të tyre të të kuptuarit të vlerës dhe rëndësisë së standardeve ndërkombëtare të punës në përmirsimin e kushteve të jetesës dhe punës. Njerëzit vendës, pakicat dhe OJQ-të mund të mësojnë nga përvoja e tyre e gjërë me qasje dhe pjesëmarrje në procedurat dhe proceset e ILO-s.

Shpresohet se ky botim do të arrijë të jep një kontribut (sadopak) të vogël përforcimit, përparimit dhe mbrojtjes së të drejtave të pakicave dhe njerëzve vendës, si dhe të grupeve të tjera të dobëta (të lëndueshme).

**Anti-Slavery International
Minority Rights Group International
Maj 2002**

I. Organizata punëtore ndërkombëtare

1. Prapavija historike

Organizata Ndërkombëtare e Punës (I L O) është krijuar si një pasojë e revolucionit industrial. Gjatë kësaj periudhe të ekspansionit ekonomik, kushtet e punës kanë qenë të ashpëra dhe shpeshherë johumane, dhe puntorët punonin nën kushte që arrinin gjer në eksploitim, me kurrfarë sigurimi ekonomik ose social. Prej kësaj kohe ka patur thirrje dhe kërkesa për mbrojtje më të madhe të punëtorëve.

Si rrjedhojë e Luftës së Parë Botërore, këto kërkesa gjetën momentin dhe sindikatat e punëtorëve e theksuan nevojën për sigurim shoqëror, dhe për një institucion të specializuar për çështje të punës.³ Në Prill të 1919 gjatë negociatave të paqes në Paris u themelue një Komision Punëtor (Labour Commission) që të shqyrtojë këtë çështje dhe si rezultat, u krijua një organizatë ndërkombëtare kushtuar vetëm një pyetje të punës.⁴ Në Tetor të këtij viti, në Washington u mbajt Konferenca e Parë Ndërkombëtare e Punës (puntore). Në këtë Konferencë u miratuan gjashtë Konventa (marrëveshje), duke përfshirë një të përcaktonte punë ditore 8-orëshe që u bë normë e pranuar në vendet e industrializuara.

Ndërmjet dy luftërave botërore (1919-'39), ILO-ja vepronte si një organizatë autonome në kuadër të Lidhjes së Kombeve, paraardhëse e Kombeve të Bashkuara. Gjatë kësaj, edhe ajo u fokusua në mbrojtjen e maternitetit (amësisë), sigurimin social, papunësinë, orët e punës dhe kushtet e punës së grave dhe njerëzve të moshës rinore. Ajo ishte e vendosur me qendër në Gjenevë, Zvicër, por e zhvendosi përkohësisht kryeqendrën në Montreal, Kanadë gjatë Luftës së Dytë Botërore për shkakë sigurie.

Kur u krijua OKB në 1946, ILO-ja ishte agjencioni i parë i specializuar që ndoqi (u bashkua me) sistemin e OKB-së, me përgjegjësi të posaçme për çështje të punës dhe shoqërore. Që nga Nëntori, 2001 ILO ka 175 shtete anëtare të veta.

2. Principet fundamentale

ILO përpiket që të bëhet një institucion zhvillues dhe dinamik. Ajo i rishqyrton principet e veta themelore duke i marrë parasysh zhvillimet dhe trendet e fundit zhvillimore në konsiderim, dhe duke shikuar se si t'a bëjë - më së miri - punën e saj relevante dhe të vlefshme.

2.1 Themelimi i ILO-s (1919)

Dokumentet themelore të ILO-s përfshinin një statut të përpiluar gjatë Traktatit të Paqës së Versajit,

të bazuar në principet vijuese:

- Heqja e punës në moshë feminare;
- Rroga të mjaftueshme;
- Tretman të barabartë;
- Pagesë të barabartë;
- Sisteme inspektimi;
- Puna të mos shikohet vetëm si mall tregëtie ose si artikull i tregëtimit;
- Orë të arsyetueshme të punës;
- Liri të shoqërimit (asocimit).

Këto principe mbeten thellë në agjendën e (rendin e ditës së) ILO-s dhe shërbejnë për të udhëhequr punën e saj në të gjitha fushat. Një tjetër çels-princip i ILO-s është edhe premisa (kushti paraprak) se: **Paqëja univerzale dhe e qëndrueshme mund të arrihet vetëm nëqoftëse ajo është e bazuar në drejtësi shoqërore.**

Ky formon shtyllën e punës së ILO-s gjer më sot, dhe është bazë në punën e saj për barazi dhe jo-diskriminim dhe zbutje të skamjes. Në 1969, në përvjetorin e saj të 50të, ILO është shpërblyer me Çmimin e Nobel-it për Paqe. Sot, ajo ka mbi 40 zyra anëmbanë botës, dhe punëson një staf (kolegjium) prej mbi 2500 veta.

2.2 Deklarata e Filadelfisë (1944)

Gjatë konferencës së saj vjetore në 1944, të mbajtur në Filadelfi, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës (SHBA), ILO miratoi një çels Deklaratë (deklarata e vlerave), që e zgjeroi statutin e 1919-së. Kjo Deklaratë i riafirmon principet fundamentale mbi të cilat ILO bazohet dhe përmban katër principe të lidhura:

- Liria e të shprehurit dhe e të bashkuarit (asocimit) janë esenciale për përparim të qëndrueshëm;
- Puna nuk është mall;
- Skamja, kudoqoftë, paraqet (përbën) rrezik për përparim kudoqoftë;
- Të gjithë qenjet njerëzore, pa marrë parasysh racën, besimin ose gjininë, e kanë të drejtën të synojnë edhe mirëqenien e tyre materiale si dhe zhvillimin shpirtëror në kushte të lirisë dhe dinjitetit, të sigurisë ekonomike dhe të mundësive të barabarta.

Deklarata i është shtue Kushtetutës më 1946 dhe formon një pjesë integrale të punës së ILO-s.

2.3 Principi i tripartizmit - (anëtarisë trepalëshe)

- ILO është organizata e vetme ndërkombëtare që vepron mbi një princip trepalësh. Që nga fillimi i saj, organizatat e punëtorëve dhe të punëdhënësve kanë punuar kraher për kraher me qeveritë, në një bazë

tre palëshe (tre antarëshe). Qeveritë, punëdhësit dhe punëtorët njihen si anëtarë përbërës të ILO-s.

Qeveritë, punëdhënësit dhe punëtorët punojnë dhe votojnë pavarësisht nga njëri - tjetri. Çdo shtet - anëtar i ILO-s ka katër vota, të cilat janë të ndara ashtuqë organizatat e punëtorëve kanë një votë, organizatat e punëdhënësve kanë një votë dhe qeveria ka dy vota.

Në përgjithësi, në mbledhjen e ILO-s, përfaqësuesit e qeverisë rrinë në mes të dhomës, me përfaqësuesit e organizatës së punëtorëve në anën e tyre të majtë dhe ata të organizatës së punëdhënësve në anën e djathtë. Këto tre grupe marrin pjesë aktive në të gjitha ngjarjet e ILO-s, duke përfshirë këtu pjesëmarrjen në komitetet dhe konferencat (këshillimet), si dhe në miratimin dhe monitorimin e standardeve të ILO-s (për detalet tjera do të sqarohet më vonë).

3. Struktura e ILO-s

ILO ka tre trupa kryesor:

- Konferenca Ndërkombëtare e Punës;
- Trupi Drejtues
- Zyra Ndërkombëtare e Punës.

3.1 Konferenca Ndërkombëtare e Punës

Konferenca Ndërkombëtare e Punës (në origjinal - the International Labour Conference) është asambleja e përgjithshme e ILO-s (Kuvendi i Përgjithshëm) kur të gjithë anëtarët e saj -qeveritë, punëdhënësit dhe punëtorët mbledhen së bashku si një trup. Ajo takohet një herë në vit, në Qershor, për tre javë rresht, dhe marrin pjesë mbi 2000 delegatë.

Përgjegjësitë e Konferencës përmbledhin:

- Miratimin e buxhetit të ILO-s, i cili është i financuar nga kontributet prej shteteve-anëtare, (çdo dy vjet);
- Miratimin e standardeve ndërkombëtare të punës dhe mbikëqyrje të aplikimit të tyre;
- Pranimin e anëtarëve të rinj;
- Zgjedhjen e Trupit Drejtues (çdo tre vjet);
- Parapregatitjen e një forumi global për diskutim mbi çështje të temave sociale dhe të punës;
- Pregaditjen e direktivave (Plan-përcaktimeve paraprake) për politikën e përgjithshme të ILO-s dhe aktivitetet e ardhshme me anë të Rezolutave.

Si shtesë, në kushte të jashtëzakonshme, Konferenca mund të miratojë Deklarata mbi politikën dhe akcionin në çështje relevante me ILO-n. Për shembull, në 1964, ai miratoi një deklaratë mbi apartheidin në Afrikën e Jugut - kjo u anuloi në 1994 me arsyetim se nuk është më e vlefshme. Dhe, në 1998 ajo miratoi një Deklaratë mbi Principet dhe të Drejtat Fundamentale në Punë (shih kapitullin III).

Në përgjithësi, është çështje e një qeverie të vendosë se kush do ta formojë pjesën e delegacionit zyrtar në Konferencë 'në pajtim me organizatat industriale...të cilët janë përfaqësuesit më reprezentativë të punëdhënësve ose të njerëzve punues...në shtetet e tyre përkatëse' (Artikulli 3.5 i Kushtetutës së ILO-s). Çështjet mund të ngriten

(shtrohen) në Konferencë mvarësisht nga ajo se a është ndonjë organizatë e veçantë e punëtorëve përfaqësuese ose jo. Përveç delegatëve zyrtarë në Konferencë, çdo delegacion zakonisht ka edhe një numër të këshilltarëve. Prandaj, çdo delegacion në Konferencë mund të jetë shumë i madh në numër.

Në Konferencë, përfaqësuesit e punëdhënësve dhe të punëtorëve i formojnë grupet e punëdhënësve dhe të punëtorëve - të zgjedhur nga kolegjet elektorale të punëdhënësve dhe të punëtorëve çdo tre vjet - dhe ata, së bashku me qeveritë, i zgjedhin anëtarët e Trupit Drejtues.

Për të lehtësuar punën e saj, Konferenca ka një numër të këshillave (komiteteve) që punojnë në çështje të posaçme; p.sh. Komiteti i Konferencës mbi Aplikimin e Standardeve (shkurt-Kom. i Aplikimeve /Zbatimeve) i cili luan rol kyç në tërheqjen e vëmendjes ndaj problemeve në zbatimin praktik të Konventave të ILO-s në vende të ndryshme (shih më vonë për detale).

Gjatë Konferencës zhvillohet një debat i gjallë, duke marrë pjesë të gjithë delegatët në çështje që kanë të bëjnë me ILO-n, duke përfshirë punësimin e fëmijëve dhe globalizmin, etj. Si rezultat, Konferenca Ndërkombëtare vjetore e Punës është bërë një forum global për diskutime politike mbi çështjet sociale dhe të punës.

3.2 Trupi Drejtues

Trupi Drejtues shërben si këshill ekzekutiv i ILO-s. Funkcionet kryesore të tija përfshijnë:

- Drejtimin e punës së organizatës;
- Zgjedhjen e Drejtorisë së Përgjithshme;
- Pregaditjen e planprogramit dhe të buxhetit të ILO-s;
- Marjen e vendimeve mbi atë se si të zbatohet politika e ILO-s.

Trupi Drejtues përbëhet prej 56 anëtarëve: me 28 përfaqësues qeveritarë, 14 përfaqësues të punëdhënësve. Antarët e Trupit Drejtues zgjidhen nga Konferenca Ndërkombëtare e Punës për afat prej tre vitesh, dhe ata i emërojnë përfaqësuesit e tyre për trupa (organe) të ndryshme të ILO-s siç janë Komiteti mbi Zbatimet (aplikimet), Komisionet e Hetimeve, etj.

Dhjetë nga vendet guvernatore (postet mandatore) janë vazhdimisht të rezervuara për ata që emërtohen "shtete të rëndësishme kryesore industriale" (Brazil, Kina, Franca, Gjermania, India, Italia, Japonia, Federata Ruse, Mbretëria e Bashkuar dhe SHBA). 18 përfaqësues - guvernatorët të tjerë zgjidhen nga ana e konferencës Ndërkombëtare të Punës në lidhje me shpërndarjen gjeografike. Punëtorët dhe punëdhënësit i zgjedhin përfaqësuesit e tyre të vet veçurazi.

Trupi Drejtues mbledhen tre herë në vit: në Mars, Qershor dhe Nëntor, në qendrën e ILO-s në Gjenevë.

3.3 Zyra Ndërkombëtare e Punës

Zyra Ndërkombëtare e Punës ('Zyra') është sekretariati i përhershëm i ILO-s dhe është e

vendosur në Gjenevë. Drejtoria e Përgjithshme, e cila zgjedhet nga trupi drejtues për periudhë të ardhshme pesë vjeçare, e udhëheq Zyren. Në mars të 1999, Juan Somavia prej Çile-s është zgjedhur si Drejtor Gjeneral.

Funksionet kryesore të Zyres përmbledhin, por nuk janë të kufizuara me-, aktivitetet vijuese:

- Grumbullimin e informatave dhe statistikave;
- Bërjen e kërkimeve për çështjet relevante të ILO-s;
- Lehtësimin e kooperacionit teknik dhe të programeve të stërvitjes (trejnimit);
- Organizimin e konferencave dhe mbledhjeve;
- Pregaditjen e sfondit të dokumenteve dhe raporteve për ILC-n (Konferencën

Ndërkombëtare të Punës) dhe tubimeve tjera;

- Sigurimin e ndihmës ndaj zgjedhësve;
- Publikimin e materialeve mbi çështjet sociale dhe të punës;
- Shërbimin ndaj trupave të ILO-s, duke përfshirë ILC-në dhe Trupin Drejtues;

Një fakt që zakonisht është nënçmuar, nga shkollarët dhe hulumtuesit -përveç të tjerëve, është funksioni i Zyres si një qendër dokumentimi. Ajo ka ngritur (grumbulluar) një koleksion mjaft të gjërë të informatave dhe të dokumenteve duke përfshirë libra, raporte qeveritare, studime historike dhe materiale të tjera. Këto janë në dispozicion për konsultim në kryeqendrën e ILO-s në Gjenevë.

Lista e shteteve anëtarë të ILO-s

Afganistani, Shqipëria, Algjeria, Angola, Antigua dhe Barbuda, Argjentina, Armenia, Australia, Austria, Azerbejxhani, Bahamat, Bahreini, Bangladeshi, Barbadosi, Bellorusia, Belgjika, Belize, Benini, Bolivia, Bosna dhe Hercegovina, Bocuana, Brazili, Bugaria, Burkina Faso, Burundi, Kamboxha, Kameruni, Kanada, Kejp-Verde, Republika e Afrikës Qendrore, Çad-i, Çileja, Kina, Kollumbia, Komorotë, Kongoja, Kosta Rika, Cote d'Ivoire, Kroacia, Kuba, Qiproja, Republika e Çekisë, Republika Demokratike e Kongos, Danimarka, Xhibuti, Dominika, Republika Dominikane, Ekuadori, Egjipti, El Salvadori, Guineja Ekuatoriale, Eritreja, Estonia, Etiopia, Fixhi, Finlanda, Franca, Gaboni, Gambia, Xhorxhia, Gjermania, Gana, Greqia, Grenada, Guatemala, Guineja, Guineja Bisao, Guajana, Haiti, Hondurasi, Hungaria, Islanda, India, Indonezia, (Republika Islamike e) Irani Iraku, Irlanda, Izraeli, Italia, Jamajka, Japonia, Jordani, Kazakistani, Kenia, Kiribati, Republika e Koresë, Kuvajti, Kirgizistani, Republika Demokratike Popullore e Laosit, Latvia, Libani, Lesoto, Liberia, Xhamahiria Arabe e Libisë, Lituania, Luksemburgu, Madagaskari, Mallavi, Malezia, Mali, Malta, Mauritania, Mauriciusi, Meksikoja, Republika e Moldavisë, Mongolia, Maroko, Mozambiku, Mianmari (Burma), Namibia, Nepali, Hollanda, Zelanda e Re, Nikaragva, Nigeri, Nigeria, Norvegjia, Omani, Pakistani, Panama, Papua Guineja e Re, Paraguaji, Peru, Filipinet, Polonia, Portugalia, Katari, Romania, Federata Ruse, Ruanda, Saint Kitts and Nevis, Santa Lucija, Sen Vinsenti dhe Grenadinet, San Marinoja, Sao Tome dhe Prinsipe, Arabia Saudike, Senegali, Sejshet, Siera Leone, Singapori, Slovakia, Slovenia, Ujdhesat Solomone, Somalia, Afrika Jugore, Spanja, Shri Lanka, Sudani, Surinami, Svazilendi, Suedia, Zvicra, Republika Arabe e Sirisë, Taxhikistani, Republika e Bashkuar e Tanzanisë, Tajlanda, Ish Republika Jugoslave e Maqedonisë, Togoja, Trinidad dhe Tobagoja, Tunizia, Turqia, Turkmenistani, Uganda, Ukraina, Emiratet e Bashkuara, Mbretëria e Bashkuar, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Uruguaji, Uzbekistani, Venecuela, Vietnami, Jemeni, Jugosllavia (Sërbia & Mali i Zi) Zambia, Zimbabve

(Si më: 4 Nëntor 2001 - Burimi: ILO)

II. Standarde ndërkombëtare të punës

1. Hyrje

Për t'i vënë qëllimet dhe objektivat e veta në praktikë, ILO formulon dhe miraton standarde të ndryshme (marrëveshje ndërkombëtare siç janë Konventat), që rezultojnë nga arritja e koncenzusit ndërmjet anëtarëve mbi një çështje të posaçme. Format kryesore të përdorura nga ana e ILO-s kanë qenë Konventat dhe Rekomandimet, por ato gjithashtu mund të përfshijnë marrëveshje joformale, si p.sh. Deklarata dhe Rezoluta.

Që nga krijimi i saj, ILO ka qenë aktive në miratimin, implementimin dhe monitorimin e standardeve ndërkombëtare që kanë lidhje me të drejtat themelore dhe liritë fundamentale, duke përmblodhë: lirinë e bashkimit (asocimit), sigurinë në punë, kushtet e punës, etj. Ndikimi i tyre është i konsiderueshëm.

Të gjithë shtetet anëtare të ILO-s janë (ose duhet të jenë të angazhuara për arritjen e synimeve dhe qëllimeve të ILO-s, dhe standardet ndërkombëtare të punës përdoren si udhërrëfyese për autoritetet nacio-

-nale për zbatimin e politikës sociale dhe të punës në nivel nacional. Ka dy kategori të standardeve ndërkombëtare të punës:

- **Konventat** - Këto janë Traktate ndërkombëtare, të cilat i lidhin (obligojnë) shtetet anëtare që t'i zbatojnë ato - pasiqë të jenë ratifikuar një herë.
- **Rekomandimet** - Këto janë të jo-obligueshme, dhe janë të destinuara t'a orientojnë ligjin politikën dhe akcionin. Këto shpeshherë miratohen bashkë me një konventë, dhe i zgjerojnë klauzolat e saja. Ata i sigurojnë direktivat për aplikimin e një Konvente, dhe shpeshherë përmbajnë gjithashtu edhe klauzola të tjera sqaruese, të cilat mund të jenë të dobishme në zbatimin e Konventës. Ata mund të miratohen edhe pavarësisht nga një Konventë. Rekomandimet nuk mund të ratifikohen.

1.1 Ratifikimi

Teksti vijues është një sqarim i shkurtë i ratifikimit:

- **Ratifikimi** - Ky paraqet një pajtim nga ana e një shteti se ai do të lidhet legalisht për një Konventë të caktuar. Ratifikimi është një obligim formal i marrur nga një shtet që t'i përmbahet edhe me ligj, edhe me praktikë, klauzolave të një Konvente ose traktati të caktuar. Ai është një akt vullnetar dhe i ndërmarrur pasiqë të jenë marrë tërësisht në konsiderim implikimet e tija.
- **Procesi i ratifikimit** - Një Konventë përgjithsisht ratifikohet pasiqë të kompletohen procedurat e

nevojshme nacionale. Këto ndryshojnë nga shteti në shtet dhe zakonisht përfshijnë aprovim nga ana e Parlamentit. Pasiqë të jenë kompletuar procedurat interne, dhe vendimi për të ratifikue një Konventë të caktuar të jetë marrë, shteti anëtar - zakonisht nëpërmes të ministrisë së tij të jashtme - dërgon një komunikatë formale në adresë të Drejtorisë së Përgjithshme të ILO-s. Me anë të kësaj letre ata e informojnë ILO-n mbi vendimin e shtetit se ai do t'u përmbahet klauzolave të një Konvente përkatëse⁵.

- **Efekt i ratifikimit** - Kur një shtet anëtar ratifikon një Konventë, ai pajtohet ndaj dy obligimeve: t'i zbatojë klauzolat e Konventës me ligj dhe në praktikë; dhe **(ii)** t'i nënshtrohet mbikëqyrjes së ILO-s në lidhje me atë se si e zbaton ai Konventën. Shënim: Mundësohet një periudhë njëvjeçare para se një Konventë të hyjë në veprim për shtetin. Qëllimi është që t'iu lejohet qeverisë kohë që t'ia bien ligjin nacional dhe praktikën në një përshtatshmëri më të madhe me Konventën.

- **Rezervime (përmbajtje) nuk lejohen** - Cilësi unike e Konventave të ILO-s është se rezervimet nuk lejohen. Të gjitha Konventat e ILO-s duhen patjetër të jenë të miratuara dhe pranuar në tërësi. Kjo gjë nuk pajtohet me praktikën e OKB-së, ku një shtet mundet të fusë rezervime ndaj Klauzolave të Trakta-teve dhe Konventave⁶. Kështu, një qeveri detyrohet t'i aplikojë të gjitha klauzolat e një Konvente të miratuar dhe nuk mund t'a përjashtojë vehten nga klauzola të caktuara. -Shënim: Prapsepapë, mund të përcaktohen përjashtime të posaçme ose alternativa në rast se këto janë të lejuara brenda klauzolave të konventës së miratuar, p.sh. arsye të reja për diskriminim mund të identifikohen nën Konventën No.111

(shih më vonë në kapitullin III - mbi të drejtat e njeriut)

- **Denoncimi** - Kjo është procedurë me të cilën një shtet deklaron se ai më nuk dëshiron të jetë i lidhur me Klauzat e një Konvente. Të gjitha Konventat e ILO-s përmbajnë një nen që përcakton se si dhe kur munden ata të denoncohen, si dhe kur denoncimi realizohet - zakonisht një vit pasiqë ai të jetë i regjistruar.

Shënim: Ekzistojnë gjithashtu klauzolla speciale për konventa të cilat i rishikojnë ata të mëparshmet - dmth. kur ratifikimi i Konventës së fundit arrin që të bëjë denoncimin automatik të një Konvente të mëhershme; psh. nëse një shtet që ka miratuar Konventën No.-107-më vonë e miraton Konventën No.169.⁷

2.Ndikimi i standardeve ndërkombëtare të punës

Konventat Ndërkombëtare dhe Rekomandimet -standartet ndërkombëtare të punës- kanë bërë ndikim në zhvillimin e ligjit të drejtave ndërkombëtare njerëzore. Ndikimi i tyre në politikën qeveritare dhe legjislaturën nacionale, bile edhe në vende ku ndonjë konventë përkatëse nuk është ratifikuar, është i konsiderueshëm.

Kjo mund t'i mveshet, në një sasi të caktuar, treantarsisë, pasi që të gjitha anëtarët e ILO-s marrin pjesëmarrje aktive në procesin e miratimit të një Konvente ose rekomandimi, prej shtruarjes së saj/tij, nëpërmes bërjes së projektit dhe diskutimit, e gjer në diskutimin final dhe miratimin në Konferencën Ndërkombëtare të Punës. ILO-ja ka një orar të përpiktë për miratimin e standardeve të saja dhe ky zakonisht silleth rreth 2 vjet.⁸ Pasi që njëherë të jetë miratuar një Konventë, anëtarët e ILO-s synojnë të sigurojnë aplikim efektiv të saj në nivel nacional. Organizatat e punëtorëve dhe të punëdhënësve janë poashtu të angazhuara në këtë përpjekje, dhe luajnë rol kyç në monitorimin e ndikimit praktik të konventave të ILO-s. Prandaj, zhvillimi dhe ruajtja e marrëdhënjeve të mira me këto organizata duhet të jetë fokusi më i rëndësishëm për njerëzit vendës, pakicat dhe OJQ-të (qofshin ata OJQ të vendësve ose të pakicave, ose OJQ që mirren me njerëzit vendës ose me pakicat).

Standardet ndërkombëtare të punës (gjithashtu të quajtura 'instrumente') përdoren si pika referimi jo vetëm nga shtetet anëtare, por gjithashtu edhe nga trupat (organet qeverisëse) nacionale, internacionale dhe regjionale për të udhëhequr politikën dhe akcionin. Ata formojnë një trup të rëndësishëm të ligjit ndërkombëtar dhe janë me rëndësi në përpilimin e dokumenteve të reja legale. Kjo arrihet pasi që princip i përgjithshëm është se cilido dokument i ri nuk guxon të bjerë nën standardet e vendosura me standardet ekzistuese.

Standardet e ILO-s ofrojnë garancat minimale në një sërë çështjesh. Ata kanë rol të rëndësishëm në ndërtimin e standardeve ndërkombëtare, jo vetëm në ILO, por gjithashtu edhe për trupa tjerë ndërkombëtarë dhe të OKB-së. Për shembull, instrumentet e ILO-s u morrën në konsiderim gjatë përpilimit të Deklaratës Univerzale mbi të Drejtat e Njeriut (1948); dy Marrëveshjet e OKB-së mbi të drejtat civile dhe politike, dhe mbi të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore; dhe Traktatet e OKB-së mbi femrat dhe robërinë.

Konventa No.169 mbi Njerëzit Vendës dhe Fisnorë (1989) është bërë pikë referimi në të drejtat e vendësve, dhe kjo ka një rëndësi të posaçme gjatë procesit të përpilimit të Deklaratës së OKB-së mbi të Drejtat e Njerëzve Vendës. Ajo gjithashtu është përdorë nga agjencionet ndihmëdhënëse shtetërore si psh. Danish Government's International Development Assistance - DANIDA (Ndihma Ndërkombëtare e Qeverisë Daneze për Zhvillim), nga Gjermania dhe Holanda, dhe nga institucionet financiale ndërkombëtare, si psh. Asian

Development Bank (Banka Aziatike për Zhvillim) dhe World Bank (Banka Botërore), për ta orientuar politikën e tyre të zhvillimit .

Një karakteristikë parimore e standardeve ndërkombëtare të punës është se ata pranohen në një mënyrë fleksibile. Kjo gjë reflektohet në klauzolat e tyre, që shpeshherë shpeshherë përmbajnë edhe njohtim gjuhësor se klauzolat duhen të zbatohen në një mënyrë fleksibile, dmth. gjer në sasi të mundshme duke marrë parasysh kushtet nacionale, etj. Kjo është me qëllim që t'i përgjigjet nevojës për t'a bërë një Konventë ose Rekomandim -relevante anëmbanë botës. Prap se prapë , ajo gjithashtu ka shpër në kritikim të ILO-s se këto formulime u sigurojnë mundësi qeverive që të bëjnë sa më pakë lëshime që mundet në zbatimin e klauzolave të standardeve ndërkombëtare.

Standardet ndërkombëtare gjithashtu sigurojnë garanca kundër miratimit të ligjeve nacionale dhe rregullave të cilat janë të kundërta me standardet ILO-s, ashtu që pasi të jetë e ratifikuar një konventë, qeveria është e lidhur me klauzolat e saja dhe e ka përgjegjësinë që të ndërmarë akcion për t'i zbatue ata. Konventat mbajnë gjithashtu edhe njëfarë force morale, pasi që dënimi publik i një shteti sovran dhe dështimi i tij që të jetojë (ekzistojë) sipas obligimeve të tija legale ndërkombëtare zakonisht vlerësohet si turbullues për një qeveri, dhe shumica e qeverive janë të ndieshme ndaj cenzurës publike.

Standardet e ILO-s sigurojnë kornizën legale dhe institucionale për t'i adresue çështjet me interes-anëtarëve të vet. Ata gjithashtu sigurojnë zgjidhje praktike në lidhje me zhvillimin ekonomik; shpërndarje të drejtë të të ardhurave; kushte të përmirsuara jetësore dhe punuese për të gjitha sektorët ; krijim të vendeve të reja të punës; përkrahje dhe mbrojtje për grupet sociale të dobëta (fëmijët, punëtorët migrues, pakicat dhe njerëzit vendës, dhe gratë); dhe stërvitje profesionale. Ata mundën poashtu të japin kontribut zhvillimit, pasi që zgjerimi i mbrojtjes sociale nëpër të gjitha sektorët e ekonomisë i jep kontribut të dukshëm zhvillimit dhe përparimit shoqëror. Si që qëndron theksuar në Kushtetutën e ILO-s:

'Dështimi i cilitdo popull (shtet) për t'i miratue kushtet humane të punës është pengesë në rrugën e popujve tjerë që dëshirojnë t'i përmirsojnë kushtet në vendet e tyre përkatëse'.

Që nga nisja e saj më 1919, ILO ka miratuar 183 Konventa dhe 194 Rekomandime (bazuar në shënimet e shtatorit - 2001). Të gjitha kanë të bëjnë me çështje që synojnë t'i arrijnë qëllimet dhe objektivat e ILO-s, dhe kaplojnë një varg subjektesh që kanë të bëjnë me botën punuese dhe gjithashtu - të drejtat themelore njerëzore.

ILO-ja rregullisht i rishqyrton standardet e saja për t'u sigurue se Konventat dhe Rekomandimet e

saja janë relevante. Nëse ata konsiderohen si të vjetëruara, ose në tjetër mënyrë të panevojshme, standardet shfuqizohen ose revizionohen. Për shembull, standardi i vitit 1957 mbi njerëzit vendës dhe fisnorë, u revizionue (rishikue) dhe u miratue një i ri më 1989.

Është përgjegjësi e qeverive që të sigurojnë se standardet e ILO-s aplikohen edhe me ligj edhe në praktikë; në këtë proces punëdhënësit dhe puntorët luajnë rol kyç, siç bëjnë edhe OJQ-të. Sidoqoftë përgjegjësia kryesore për përmbushjen e obligimeve ndërkombëtare mbetet tek qeveria përkatëse.

3. Klasifikimi i standardeve ndërkombëtare të punës

Konventat dhe Rekomandimet e ILO-s mund të ndahen në një sërë kategorish, dhe këto janë të shpallura më poshtë:

- Kushtet e punës;
- Punësimi (në përgjithsi);
- Punësimi i fëmijëve;
- Punësimi i grave;
- Të drejtat fundamentale njerëzore (duke përfshirë edhe ata të pakicave);
- Njerëzit vendës dhe fisnor;
- Marëdhëniet industriale;
- Administrimi (udhëheqja) i punës;
- Punëtorët migrues;
- Punëtorët e moshuar;
- Kategori të tjera të posaçme të punëtorëve (punëtorët e doqeve, personeli i hoteleve dhe furnizimit, peshkatarët, navigacioni i brendshëm, punëtorët e plantazheve, detarët, qiraxhinjtë dhe tokë-marrësit - në blegtori);⁹
- Politika sociale;
- Sigurimi social.

Ky Doracak fokusohet në Konventat fundamentale të ILO-s, dhe në Konventat që kanë të bëjnë me njerëzit vendës dhe njerëzit fisnor - pasi ata janë më relevantë për pakicat dhe njerëzit vendës. Sidoqoftë, është me rëndësi të theksohet se standardet ndërkombëtare të punës janë të ndërlidhura dhe plotësojnë njëra - tjetrën.

III. Të drejtat njerëzore

1. Hyrje

Sipas të dhënave të shtatorit 2001, ILO ka miratuar 183 Konventa. Temat e përfshira në këto Konventa kaplojnë çështje prej punës së natës, gjer në ato për detarët dhe minoritetët, si edhe çështjet e gjinisë.

Më 1995, ILO vendosi t'i përcaktojë çështjet e interesit prioritar si një mënyrë për ngushtimin e energjisë dhe resurseve - si të ILO-s ashtu edhe të shteteve anëtare të saja. Si çështje me rëndësi fundamentale për ILO-n u zgjodhën këto:

- Heqja e punësimit me dhunë;
- Eliminimi i punësimit të fëmijëve;
- Eliminimi i diskriminimit në punësim dhe në procesin e punës;
- Liria e asociimit dhe mbrojtja e së drejtës për tregëtim kolektiv.

Këto katër çështje përfshihen brenda kornizës së Konventave vijuese:¹⁰

- Konventa No. 29 - Konventa e Punës me Dhunë (1930)
- Konventa No.105 - Konventa mbi Heqjen e Punës me Dhunë (1957)
- Konventa No.138 - Konventa mbi Moshën Minimale (1973)
- Konventa No.182 - Konventa për Format më të Rënda të punësimit të Fëmijëve (1999)
- Konventa No.100 - Konventa mbi Pagesën e Barabartë (1951)
- Konventa No.111 - Konventa mbi Diskriminimin (në punësim dhe në procesin e Punës) - (1958)
- Konventa No. 87 - Konventa mbi Lirinë e Asociimit dhe Mbrojtjen e së Drejtës për t' u Organizuar (1948)
- Konventa No. 98 - Konventa mbi të Drejtën për t' u Organizuar dhe për Tregëtimin në mënyrë Kolektive (1949)

Identifikimi i këtyre 8 Konventave si Konventa të drejtave fundamentale njerëzore nuk don të thotë se tërhiqemi prej rëndësisë dhe relevancës së Konventave të tjera të ILO-s. Qëllimi kryesor ishte që t' u indikohet shteteve - anëtare nevoja për një angazhim të shtuar në përkrahjen e këtyre vlerave thelbësore të ILO-s.

ILO-ja ndërmori një fushatë për të nxitur ratifikimin dhe implementimin¹¹ e këtyre çështjeve, që mori një impuls të shtuar me miratimin e Deklaratës mbi Parimet dhe të Drejtat Fundamentale në Punë (1998) (shih më vonë). Fushata e ILO-s për ratifikim është në vazhdim e sipër, plotësuar nga programet e asistencës (ndihmës teknike) për të ndihmuar ratifikimin dhe/ose implementimin e tyre.

Si çështje kyçe për interesim (angazhim) për ILO-n, këto katër kategori të të drejtave u sigurojnë organizatave të pakicave dhe të njerëzve vendës, si dhe organizatave të tjera joqeveritare të përfshira në këtë, një pikë hyrëse në përdorimin efektiv të ILO-s dhe të mekanizmave të saja. Të gjithë ata (Konventat) mund të përdoren për përkrahjen dhe mbrojtjen e të drejtave të pakicave dhe të njerëzve vendës, qoftë në mënyrë direkte ose indirekte, me ndihmën e organizatave ndihmëdhënëse (përkrahëse) të punëtorëve.

2. Diskriminimi

Konventat mbi Diskriminimin janë më të rëndësishmet për pakicat dhe njerëzit vendës, dhe për organizatat që mirren me ta dhe për ta. Këto konventa përgjithsisht kanë të bëjnë me gratë dhe pakicat, dhe në njëfarë shkallë me njerëzit vendës. Mbrojtja e grupeve të dobëta - siç janë fëmijët, pakicat dhe njerëzit vendës, dhe gratë-ka qenë një nga shtyllat fundamentale të ILO-s që nga krijimi i saj.

Dy nga Konventat të miratuara nga ana e Konferencës së parë të ILO-s më 1919 kanë të bëjnë me gratë: pikërisht puna e natës për gratë¹² (Konventa No.4) dhe mbrojtja e maternitetit (amësisë) (Konventa No.5). ILO-ja ka luajtur rol të rëndësishëm në ngritjen e pozitës së gruas në vende të punës. Konventa No.100 dhe 111 kanë të bëjnë me diskriminimin gjinor (Konventa No.111 gjithashtu i përfshin edhe pakicat dhe kategoritë tjera).

2.1 Konventa e Shpërblimit të Barabartë në Punë (1951) – (Konventa No.100)

Konventa No.100 posaçërisht i adresohet çështjes së dallimeve në pagesë ndërmjet punëtorëve meshkuj dhe femra. Femrat për një kohë të gjatë kanë qenë më pak të paguajtura se sa barasvlerësit e tyre në punë. Konventa No.100 e ILO-s siguron mënyrën si t'i adresohemi kësaj çështjeje, plotësuar me Rekomandimin e saj (No.90). Cilësitë kryesore të Konventës No.100 janë:

Qëllimi i Konventës

- Aplikimi i principit të 'pagesës së barabartë për punë me vlerë të barabartë';
- Eliminimi i dallimeve në tarifën e shpërblimit që bëhet për punëtorët meshkuj ndaj atyre femra.

Fushëveprimi

- U drejtohet të gjithë punëtorëve.

Elementet

- Përfshin dallimin ndërmjet punëve që mund të jenë të ndryshme por që kanë karakteristika të ngajshme

- Shpërblimi përmbledh paga të të barabarta si dhe çfardo lloj beneficionesh në para ose natyrë (mall), siç janë shtesat në rrogë (bonuset), lejet familjare (family allowances), pushimet e paguajtura, pensionet etj.

Veglat

- Marrëveshjet kolektive, p.sh. nacionale, mbarë-industriale ose të mbështetura në ndërmarje/ sipërmarje;
- Ligjet dhe rregulloret nacionale, p.sh. ligji mbi pagesën minimale;
- Mekanizmat e përcaktimit të pagesave, p.sh. shkallët e pagesave të shërbimeve publike ;
- Kombinimi i të lartpërmendurave.

Strategjitë

- Anulimi i shablloneve në klasifikimin e punës dmth. shkathtësi dhe detyra të konsideruara me qenë tradicionalisht 'femrore', p.sh.përkujdesja, pastrimi, detyra e sekretares etj;
- Drejtimi i inspektiveve të punës;
- Zhvillimi dhe drejtimi i vlerësimeve objektive të punës;
- Zhvillimi i metodave të përshtatshme për përcaktimin e pagesave;

Akcioni që kërkohet nga qeveritë

- Të sigurojnë aplikimin e principit për pagim të barabartë për punë të vlerës së njejtë - kudo që të jetë e mundur, për shembull- në shërbimet publike;
- Të përkrahin këtë princip atje ku nuk ekziston kontroll i drejtpërdrejtë mbi caktimin e pagesave, siç është p.sh. sektori privat.

Konventa No.100 ka të bëjë me një aspekt të posaçëm të diskriminimit gjinor - dallimet në pagesat që i pranojnë burrat dhe gratë. Shpeshherë kjo mund të cilësohet si shkak - jo aq objektiv, veç se që punëtorët u takojnë gjinive të ndryshme . Megjithëse janë ndërmarrë hapa për t'iu adresue kësaj çështjeje, dhe për të zvogluar diferencat në paga, edhe shumë më tepër nevojitet për t'u bërë në këtë aspekt. Anise Konventa No.100 nuk i drejtohet në mënyrë të posaçme diskriminimit të bazuar në 'gjinë' ose 'përkatësinë etnike', ajo është e rëndësishme pasi që gratë e pakicave dhe të njerëzve vendës zakonisht janë të keqtrajtuara (diskriminuara) në vendet e punës, për shkak të gjinisë ose përkatësisë etnike, ose të dyjave, dhe kjo ndikon (bën shtypje) në potencialin e tyre të fitimit të pagesave.

2.2 Konventa e Diskriminimit (në Punësim dhe Punë) e vitit 1958 (No.111)

Konventa No.111 mbi diskriminimin në punësim dhe në procesin e punës është instrument kryesor që mund të përdoret për t'iu adresue çështjes së diskriminimit lidhur me punën - që u bëhet pakicave dhe njerëzve vendës. Konventa No.111 përkrah politikë në dobi të mundësive të barabarta.

Megjithëse ajo ka të bëjë me vendin e punës, ajo ka konsekuenca të gjëra dhe përmbledh një hapësirë të çështjeve që dikush nuk do t'i lidhte me këtë temë.

Qëllimi i Konventës

- Të përkrahë barabarsinë në punësim dhe në punë.

Fushëveprimi

- Të gjithë sektorët dhe situatat ku njerëzit janë të punësuar ose punojnë,- përfshirë edhe vetëpunësimin;
- Përmbledh secilin, duke përfshirë punëtorët nacionalë si dhe ata jo-nacionalë; p.sh. punëtorë e huaj.

Definimi i diskriminimit

- Çfarëdo dallimi, përjashtimi apo preference (parapëlqimi)- të bazuar në ndonjë ose më tepër fusha të ndaluara : në bazë të ngjyrës së lëkurës; përjashtime nacionale; mendimit politik; 'racës';; religjionit; gjinisë; origjinës shoqërore;ose fusha tjera të përcatuara nga legjislatura nacionale - p.sh. mosha, statusi civil, mungesa e aftësive, ose orientimi seksual; që ul vlerat ose i dëmton në barabarsinë e mundësive ose të trajtimit gjatë punësimit ose në punë.

Përjashtime

- Ndonjë dallim përjashtim ose preferencë për ndonjë punë të posaçme -i bazuar në nevojat e brendshme të asaj pune. Për shembull, aftësitë gjuhësore - nëse puna përfshin bashkëpunim me publikun, një shkallë e mprehtësisë së të pamurit për pilotët ajrorë, përkatësi ndonjë grupi religjioz - nëse puna kërkon kryerjen e shërbimeve fetare (të falurit);
- Masa të posaçme (në trajtim) për njerëz që kanë nevojë për ndihmë të posaçme ose asistim për shkaqe siç janë mosha, mungesa e aftësive, përgjegjësitë familjare, gjinia ose statusi social apo kulturor. Në programet e akcioneve afirmative p.sh. për pakicat etnike në sektorin publik, mund të aplikohen masa të posaçme.

Aplikimi

- Mundësi të barabarta në punësim dhe në punë - p.sh. punë të veçanta, regrutim dhe qirazim ;
- Mundësi të barabarta në ushtrimin e mjeshtrive;
- Kushte dhe rrethana të barabarta të punësimit, p.sh. mundësi për trajnim profesional, për përparim, përfitime tjera, shpërblim në të gjitha format e veta, etj;

Akcioni i nevojshëm nga qeveritë

- Miratimi i ligjeve dhe krijimi i programeve edukative mbi mundësitë e barabarta;
- Miratimi i politikës nacionale në baza të mundësive të barabarta;
- Bashkëpunimi i plotë me organizmat punëdhënëse dhe punëtorë;

- Themelimi i mundshëm i një agjencioni nacional mbi mundësitë e barabarta;
- Anulimi i ligjeve dhe praktikave të papajtueshme.

Konventa No.111 përcakton shtatë fusha të ndaluara të diskriminimit (shih në 'Përcatimi i Diskriminimit).

Ajo përmban një mundësi për për shtetet anëtare që të identifikojnë (përcaktojnë) fusha të tjera të diskriminimit. Disa shtete kanë përfshirë moshën, mungesën e aftësive dhe orientimin seksual si fusha plotësuese për diskriminim.

Në shqyrtimin e aplikimit të kësaj Konventeje, diskriminimi gjinor është çështje që është diskutuar më së shpeshti. Trupat mbikëqyrës të ILO's e kanë shqyrtue këtë problem praktikisht në të gjitha shtetet që e kanë ratifikuar këtë Konventë, duke përfshirë edhe Afganistanin, Austrinë, Bangladeshin, Bolivinë, Egjiptin, Guatemalën, Finlandën, Iranin, Spanjën, Sudanin, etj. - që janë disa nga ata.

Për të ofruar një tregues të gjërësisë dhe kompleksitetit të kësaj çështjeje; në vitin 2001, para rënies së regjimit Taliban në Afganistan, Komiteti i Ekspertëve mbi Aplikimet dhe Rekomandimet - trupi kryesor përgjegjës për mbikëqyrjen e pajtueshmërisë së shteteve antare me Konventat - shprehën shqetësim të thellë për keqpërdorimin e vazhdueshëm të rëndë të të drejtave njerëzore të grave në Afganistan, dhe në veçanti për shumë kufizime në fushën e edukimit të tyre, dhe punësimit ndërsa në Finlandë qeveria pranon se 'pabarazitë në gjini vazhdojnë të ekzistojnë vazhdimisht, kryesisht për arsye të mundësive të punësimit, natyrës, marrëdhënjëve të punësimit dhe pagesës'.¹³

Në kontekst të Konventës No.111 gjithashtu është shqyrtue edhe situata e grave që u përkasin pakicave ose njerëzve vendës. Për shembull, Komiteti i Ekspertëve, duke shqyrtuar akcionin për ekiminimin e diskriminimit gjinor në Australi, shprehu shqetësimin e vet për pozitën e grave të Aborixhinëve dhe të atyre - banore të Torres Strait Island, dhe të grave migruese, situata e të cilave më vonë u pranue (u plotësue) si një rritje e dukshme në drejtim të racizmit dhe ksenofobisë.¹⁴ Komiteti gjithashtu ka ngritur edhe çështjen e papunësisë së lartë në mesin e grave Maori, në Zelandë të Re.

Përfaqsimi i tepërt i grave në aktivitete të nivelit më të ultë dhe përfaqsimi i ultë në pozita të nivelit më të lartë, poashtu është ngritur për shqyrtim edhe në një sërë rastesh- përdërisa ka ligje dhe rregullore që i pengojnë mundësitë e barabarta. Meqenëse është bërë një përparim i dukshëm në disa shtete, prapsepapë problemi i pabarazisë ndërmjet burrave dhe grave vazhdon të ekzistojë në shumicën e shteteve, dhe ka edhe shumë vend për përmirësim.

Komiteti gjithashtu ka ngritur për diskutim edhe çështjen e diskriminimit të bazuar në mendimin politik

në disa shtete, duke përfshirë në Angolë, Kubë dhe Republikën e Çekisë. Sa për pakicat religjioze, çështja e diskriminimit është ngritur p.sh. në kontekst të anëtarëve të grupit Baha në Iran, dhe të atyre të grupeve Ahmedi, Kuadiani dhe Lahori në Pakistan.

Është me rëndësi të rikujtojmë se Konventa No.111 gjithashtu përfshin edhe qasje dhe mundësi për punësim dhe në punë. Kështu, institucionet edukative, iniciativat për vetëpunësim, dhe programet e aftësisimit të gjitha bien nën horizont të kësaj Konvente, siç ndodh edhe me procesin e rekrutimit (punësimit) - prej një shpalljeje fillestare në një gazetë, e më tej nëpërmes të një intervjuimi dhe oferte për t'u punësue, në bazë të kushteve dhe konditave të punësimit. Siç është sqarue nga ana e Komitetit të Ekspertëve:

'Aplikimi i principit të barazisë së mundësive dhe trajtimit për të gjithë personat në lidhje me mundësinë e punësimit sipas zgjedhjes së tyre të lirë nuki i akordon secilit person të drejtën që të fitojë një post të veçantë pa marrë parasysh kualifikimet e tija /saja ose kushtet tjera, por nënkupton se çdo person e ka të drejtën që ta ketë kërkesën e punësimit për atë post që e zgjedh vetë - të trajtuar në mënyrë të drejtë, pa diskriminim të bazuar në cilindo lloj të përcaktuar sipas Konventës'.¹⁵

Është në kuadër të studimit të lidhjes ndërmjet diskriminimit - në baza të ngjyrës së lëkurës, përjashtimeve nacionale, racës dhe origjinës sociale - dhe shkallëve të papunësisë së lartë dhe të edukimit të ultë, që ILO-ja e ka ngritur çështjen e pakicave dhe të njerëzve vendës për shqyrtim.¹⁶ Duke u rikthye psh. në Australi, Komiteti i Ekspertëve ka shprehur shqetësimin e vet për shkallën e lartë të vazhdueshme të papunësisë së njerëzve vendës në Australi (23% , krahasuar me 9% - për popullsinë e përgjithshme). Ai gjithashtu paraqiti vërejtje për largimin nga posti i Komisionerit për Drejtësi Sociale të Komisionit ATSIC - (Komisioni i Aborixhinëve dhe banorëve të Torres Strait Island), dhe kërkoi nga qeveria -'të vlerësojë ndikimin që ky vendim mund ta ketë në mundësitë e punësuarit dhe të procesit të punës tek Australianët vendës'.¹⁷

Komiteti i Ekspertëve gjithashtu ka paraqitur vërejtje mbi diskriminimin e shprehur me ndërrimet e planifikuara në Indi për arritjen e mundësive për punësim, sidomos në poste më të larta. Ai poashtu ka shqyrtuar influencën e kriterit 'racist' në arritjen e punësimit dhe të avancimit në punë në eru, ku shumë njerëz vendës janë të pashkolluar dhe të penguar nga barrierat gjuhësore. Ai gjithashtu ka theksue problemet me të cilat ndeshen pakicat në arritjen e mundësive për edukim dhe trajnim në Bullgari (Turqit), Çeki (Romët), Romani (Romët, Turqit, Rusët) etj, që janë disa shembuj.

Për informata plotsuese në çështje të diskriminimit, ju lutemi kontaktoni:
Equality and Employment Branch (EGALITE)
Standards Department

ILO
CH-1211 Geneva 22
Switzerland
Tel: +41 22 799 7115
Fax: +41 22 799 6344
e-mail: egalite@ilo.org

3. Puna e detyrimshme

Megjithëse skllavëria dhe tregëtia e skllavëve u gjykuan si të paligjshme (ilegale) qysh në shekullin XIX, kjo praktikë vazhdoi në shumë pjesë të botës. Kushtet mund të kenë ndryshuar por njerëzit ende kanë punuar në kushte të ngjajshme të atyre të skllavopronarisë. Kjo praktikë ishte e zakonshme në vendet koloniale, sidomos në mesin e atyre që konsideroheshin 'popullsi native' dmth. që përfshinte njerëzit që sot mund të u takojnë komuniteteve vendëse ose atyre minoritare (pakicore).

Më 1926, Liga e Kombeve - paraardhëse e Organizatës së Kombeve të Bashkuara e miratoi Konventën mbi Skllavërinë, Skllavopronarinë, Punën e Detyrimshme (e dhunshme) dhe Institucionet dhe Praktikrat e Ngjajshme – (Konventa e Skllavërisë) - për të ndaluar të gjitha aspektet e tregëtisë me skllavë. Prapsepapë, duke parë se problemi ishte kompleks dhe i shumë-anshëm, dhe se një standard i vetëm ishte i pamjaftueshëm që të merret me tërë gjërësinë e problemeve dhe situatave të shkaktuara nga ato, Liga e Kombeve kërkoi nga ILO-ja që ta plotësojë punën e saj.

Në 1930 ILO-ja e miratoi Konventën e Punës së Detyrimshme (No.29), dhe kjo Konventë, plotësuar më vonë me Konventën e dytë të ILO-s mbi Punën e Detyrimshme – të miratuar më 1957, siguron vegla të rëndësishme në luftën për të çrrënjësuar këtë praktikë të padrejtë.

Sqarim—Termi *Punë e Detyrimshme* identifikohet me termin *P. e Detyrueshme*, por ka edhe dallim, andaj edhe e kam preferuar në temë. Në origjinal –*forced labour* - (punë e detyrueshme dhe nën dhunë)

3.1 Konventa mbi Punën e Detyrimshme (Konventa No.29) (1930)

Teksti në vijim është një përshkrim i shkurtë i pikave kryesore të Konventës No.29;

Qëllimi i Konventës

· Të ndalojë përdorimin e punës së detyrimshme në të gjitha format e saja brenda një kohe sa më të shkurtë që të jetë e mundur.

Perkufizimi

· Çfardo punë ose shërbim që nuk është vullnetare dhe është përcaktuar me detyrim ose nën kërcënim të ndëshkimit/dënimit.

Elementet

· Ajo kryhet për shkak të frigës ose shtrëngesës, ose kërcënimit të një ndëshkimi me gjobë ose tjetërfare;

· Ajo nuk është vullnetare, dmth. jo e bërë lirisht dhe me dëshirë ;
· Ajo përfshin punën dhe shërbimin.

Aktiviteti i nevojshëm nga qeveritë

· Të kryejnë inspektime të rregullta të kushteve të punës;
· Të garantojnë se dënimet janë edhe adekuate, edhe efektive;
· Ta përkufizojnë punën e detyrimshme si shkelje e ligjit (kundërvajtje).

Përjashtime (dmth. jo të emërtuara si punë e detyrimshme)

· Rastet urgjente, - p.sh.-tërmete, epidemi, vërshime;
· Shërbimi ushtarak - por thjesht aktivitete ushtarake;
· Shërbime të komunitetit pakicë;
· Obligime normale qytetare, p.sh. votimi;
· Puna gjatë burgimit (megjithëse në përdorimin e kësaj praktike janë caktuar restriksione).

Të gjitha përjashtimet e tjera duhen patjetër të hiqen nga ligjet nacionale dhe nga praktika. Kështu, nëse ndonjë shtet ka ligje ose rregullore që kërkojnë nga banorët e tij që të kryejnë çfardo lloj pune ose shërbimi që nuk përfshihet në kuadër të 5 përjashtimeve të lartpërmendura, atëherë këto duhen patjetër të anulohen.

Në shumë shtete, pakicat dhe njerëzit vendës janë ndër ata që janë më të prekur. Raporti Global I ILO-s, - *Ndalimi i Punës së Detyrimshme* – përcakton:

'Koincidenca (Përputhja) e formave tradicionale të skllavopronarisë me ndarjet etnike sugjeron një lidhshmëri ndërmjet eliminimit të punës së detyrimshme dhe eliminimit të diskriminimit në shoqëritë'.¹⁸

Të përmendim disa shembuj : në Sudan, ku një konflikt etnik vazhdon të egërsohet, të burgosurit të robëruar gjatë luftimeve janë të shëndruar - në bazë të traditës së vjetër shekullore - në skllavëri ; në Kongo Brazavil ka raportime mbi punimin e Pigmejve (Twa) në dobi të popullsisë Bantu-nën kushte të punës së detyrimshme;¹⁹ dhe në Indonezi, ka raporte që lajmërojnë për popullsinë Dajak , në Kalimantanin lindor, për punën e tyre nën kushte të skllavërisë me borxh.²⁰ Serioziteti i problemit të punës skllavërore në Indi, përkundër asaj që legjislatura e vendit e ka shpallë atë si jo-legale në 1976, gjithashtu ka qenë shkak i vazhdueshëm interesimi për trupat mbikëqyrëse të ILO-s. Qeveria e Indisë është paraqitur përpara Komitetit mbi Miratimin e Standardeve (Application Committee)²¹ në një sërë rastesh, duke përfshirë edhe atë në Qershor 2000, dhe Qershor 2001, për të diskutuar problemin, dhe duke kërkuar një zgjidhje të zbatueshme dhe efektive prej saj. Shumë nga këto punëtorë të detyrueshëm janë Dalit-ët, ose vijnë prej komuniteteve vendëse.

Ekzistojnë gjithashtu raporte të punës së detyrimshme të komuniteteve vendëse edhe në Amerikën Latine. Për shembull, në Meksiko, nën

praktikën e rekrutimit detyrues -'enganche', njerëzit vendës janë mbajtur me mjete për jetesë me anë të pagesave të shtuara apo parapagesave që është dashur të bëhen në mallra dhe shërbime; dhe në Peru, Konfederata Botërore e Punës ka referue mbi skllavërinë dhe varësinë si borxh të njerëzve vendës, sidomos në regjionet Atalaja dhe Ukajali. Gjithashtu ka edhe raporte mbi punën e detyrimshme të njerëzve vendës në Bolivi, Brazil dhe Guatemalë.²²

3.2 Konventa e Zhdukjes së Punës së Detyrimshme (No.105) (1957)

Ndërmjet viteve 1930 dhe 1950, shumë njerëz janë vendosur në kampe dhe detyruar që të punojnë nën kushte ngjajshëm me të skllavo-pronarisë. Ata janë burgosur për shkaqe të bindjeve politike ose ideologjike. ILO arriti në përfundim se ky fenomen i ri duhet patjetër të shqyrtohet dhe në 1957 e miratoi Konventën mbi Zhdukjen e Punës së Detyrimshme (No. 105). Konventa No.105 plotëson Konventën më të hershme No.29 mbi punën e detyrimshme.

Elementet kryesore të Konventës janë:

Qëllimi i Konventës

· Të ndalojë punën e detyrimshme

Fushëveprimi (5 kategoritë e ndaluara)

- Puna e detyrimshme si mënyrë (mjet) e zhvillimit ekonomik;
- Si dënim për pjesmarrje në greva ose demonstrata;
- Si mjet i disiplinës në punë;
- Si mjet i shtrëngimit politik
- Diskrimine në fusha të përkatësisë racore, origjinës shoqërore, përkatësisë nacionale ose religjionit.

Aktiviteti i nevojshëm nga qeveritë

· Të mirren masa efektive për zhdukjen e menjëhershme dhe komplete të punës së detyrimshme.

Duke vështruar pyetjen se si realizohet kjo Konventë, në ligj dhe praktikë, trupat mbikëqyrëse të ILO-s e kanë ngritur çështjen e punës së detyrimshme (obligative) të caktuar nga nëpunësit publikë-komunalë si njëformë të masave disiplinore, psh. në Pakist dhe Trinidad dhe Tobago; si shtrëngim politik - (psh. në Turqi dhe Afganistan), dhe ndjekjen e anëtarëve të grupeve religjioze pakicore në Pakistan, psh. të grupeve Ahmedi, Lahori dhe Kuadiani.

Për informata më detale dhe plotsuese - kontakti:
Social Protection and Labour Conditions Branch (APPL)
Standards Department
ILO
CH 1211 Geneva 22

Switzerland
Tel: +41 22 799 7126
Fax: +41 22 799 6926
e-mail: appl@ilo.org

Ju mundeni gjithashtu të kontaktoni:

Anti-Slavery International:
Thomas Clarkson House
The Stableyard
Broomgrove Road
London SW9 9TL
UK
Tel: +44 207 501 8920
Fax: +44 207 738 4110
e-mail: info@antislavery.org

4. Liria e Asocimit

Liria e asocimit (bashkimit në shoqëri) ka qenë temë qendrore për ILO-n që nga krijimi i saj, dhe kjo gjë vazhdon edhe më tutje. Parathënja e ILO-s e vitit 1919 përcakton 'pranimin e principit të lirisë së asocimit' si një ndër qëllimet e ILO-s, dhe kjo u ripohua në Deklaratën e Filadelfisë më 1944: '...liria e të shprehurit dhe e asocimit janë thelbësore për përparim të të qëndrueshëm...'.

Teksti në vazhdim një përshkrim i shkurtë i elementeve kryesore të dy Konventave që kanë të bëjnë me këtë çështje. Meqenëse kjo gjë nuk është përmendur në mënyrë të veçantë, liria e asocimit përmban në vehte edhe të drejtën për grevë.

4.1 Konventa mbi Lirinë e Asocimit dhe Mbrojtjen e së Drejtës për t'u Organizue (Nr.87) (1948)

Parimi kryesor i kësaj Konvente është që t'i mbrojtë të drejtat e punëtorëve dhe të punëdhënësve që të anëtarë të ndonjë sindikate ose të ndonjë organizate të punëdhënësve, dhe të përdorin këtë të drejtë pa ndërhyrjen e shtetit.

Qëllimi i Konventës

· T'i mbrojtë të drejtat e punëtorëve dhe punëdhënësve për të formue organizata të tyre të veta.

Elementet kryesore

- E drejta për të zgjedhë një sindikatë ose asociacion në mënyrë të lirë, pa restriksione ose, diskriminime ose lejim apo autorizim nga organet e pushtetit;
- E drejta për të themelue ose për t'u bashkangjitë me ndonjë sindikatë ose asociacion;
- E drejta për të punue në të gjitha nivelet, duke përfshi edhe nivele ndërkombëtare, psh. anëtarësi në ndonjë organizatë ndërkombëtare.

Akzioni i nevojshëm nga qeveritë

· Të sigurojnë që ligji dhe rregulloret nacionale të jenë në pajtueshmëri me Konventën;

- Të mbrojtë të drejtën për organizim të lirë

Përjashtim

- Forcat ushtarake dhe policia (mund të zbatojnë rregulla të posaçme)

4.2 Konventa mbi të Drejtën për t'u Organizuar dhe Tregëtuar në Mënyrë Kolektive (1949) (Nr.98)

Konventa Nr.98 i plotëson klauzolat e Konventës Nr.87:

Qëllimi i Konventës

- Të mbrojtë të drejtën për tregëtim në mënyrë kolektive si një grup/union;
- Të mbrojtë të drejtën e punëtorëve dhe punëdhënësve për t'u organizuar.

Elemente

- Mbrojtje adekuatë e së drejtës për t'u antarësue në sindikata dhe e mundësisë për të tregëtue në mënyrë kolektive
- Mbrojtje nga kushtëzimi që punësimi të bëhet me kusht të mos-anëtarimit në sindikata apo të mospjesëmarrjes në ta;
- Mbrojtja nga humbja e vendit të punës për shkak të anëtarësisë në sindikata ;
- Mos-ndërhyrje nga ana e agjentëve ose antarëve të organizatave të tjera të punëtorëve/ punëdhënësve;

Aktiviteti i nevojshëm nga qeveritë

- Të themelojnë një maqineri që do të sigurojë respekt ndaj së drejtës për t'u organizue;
- Të njohtëjnë masat, të nxisë dhe të përkrahë zhvillimin dhe përdorimin e tregëtimit kolektiv, të zhvillojë bisedime mbi terminet dhe kushtet e punësimit

Përjashtime (të përcaktuara sipas ligjit nacional)

- Forcat ushtarake dhe policia;
- Nëpunësit komunalë.

ILO-ja e ka ndjekur me vëmendje aplikimin e këtyre dy Konventave pasi që ata janë fundamentale për operacionet e ILO-s që funksionojnë në baza të anëtarësisë 3-palëshe, d.m.th. ndërmjet qeverive, punëtorëve dhe punëdhënësve.

Sa i përket kësaj, vëmendja e ILO-s është përqëndruar në një numër çështjesh (por jo të kufizuara vetëm në ta) që përfshijnë: ligjet nacionale që bëjnë kufizimin ose cënimin e së drejtës për të organizue greva ose për të ndërmarrë aktivitete tjera industriale (Nikaragua, Norvegjia, Mbretëria e Bashkuar dhe Venecuela); efektiviteti i gjobave për diskriminimin anti-unionitar (Belize); legjislaturë restriktive dhe mohim të regjistrimit të sindikatave (Koreja Jugore); dhe shembulli i së drejtës për

asocim në zonat që prodhojnë për eksport (psh. Bangladeshi dhe Pakistani).

Për informata më detale mbi çështje të lirisë së asociimit kontaktoni:

Freedom of Association Branch (LIBSYND)
Standards Department; ILO
CH 1211 Geneva 22
Switzerland
Tel: +41 22 799 7122
Fax: +41 22 799 7670
e-mail: libsynd@ilo.org

5. Puna e fëmijëve

Puna e fëmijëve (puna në moshën fëmijërore) ka qenë çështje më e rëndësishme për ILO-n që nga fillimi i punës së saj, dhe ajo ka përpunuar një numër të standardeve me qëllim të mbrojtjes së fëmijëve. Qëllimi parësor i ILO-s sa i përket kësaj është që t'a eliminojë tërësisht punën në moshën fëmijërore. Nëse kjo gjë nuk është menjëherë e realizueshme, atëherë duhet të sigurohet mbrojtje maksimale për fëmijët që janë të detyruar të punojnë nga shkaqe të ndryshme - duke përfshirë skamjen.

- ILO vlerëson se ka përafërsisht 250 milionë fëmijë, ndërmjet moshave 5 - 14 që punojnë;
- Rreth 120 milionë fëmijë punojnë me orar të plotë;
- 41% prej të gjithë këtyre fëmijëve punojnë në Afrikën sub-Sahariane (pjesën jugore të Afrikës)
- 21% prej të gjithë fëmijëve punojnë në Azi dhe në Amerikën Latine ;
- Prej numrit të përgjithshëm -në botë- të punëtorëve argatë, të moshës fëmijërore - 61% janë në Azi, 32% janë në Afrikë dhe 7% - në Amerikën Latine.

(Burimi i të dhënave: IPEC, ILO, Geneva, 2001)

Shumë fëmijë punojnë që të mbajnë vetëveten dhe familjes. Në disa zona- prej fëmijëve ekonomikisht aktivë-20% e atyre janë të moshës nën 10 vjeçare.²³ Fëmijët janë të angazhuar në lloj-lloj detyra dhe mjedise duke përfshirë: të punuarit nëpër furra për pjekje të tullave, industrinë e qilimave, punët shtëpiake, në fabrika, në ferma, nëpër miniera , etj. Ata janë të përfshirë edhe në trafikimin e drogës dhe në prostitucionin fëmijor. Ekzistojnë raporte të komuniteteve pakicore dhe vendëse që punojnë në shërbime shtëpiake në Benin, për shembull, si dhe në plantazhe, në Benin, Togo, dhe Cote d'Ivoire.²⁴

ILO-ja ka miratuar 2 instrumente që të udhëheqin punën e saj në këtë hapësirë (çështje): Konventa e Moshës Minimale (1973) (Nr. 138), dhe Format më të Rënda të Punës Fëmijërore (1999) (Nr. 182), të cilat hynë në fuqi në vitin 2000. Më 1992 u caktua që (iu dha detyrë) Programi Ndërkombëtar për Eliminimin e Punës Fëmijërore (International Programme on the Elimination of Child Labour - IPEC) - t'i plotësojë

standardet e ILO-s në këtë çështje, dhe të kryejë programe për eliminimin progresiv të punës së fëmijëve.

5.1 Konventa e Moshës Minimale (1973) (Nr.138)

Konventa e Moshës Minimale' konsolidon dhe rishikon Konventën e mëparshme që mirrej me moshën minimale në sektorë të ndryshëm, siç janë: bujqësia, peshkataria, industria, detaria, punësimi jasht-industrial dhe puna nëntoksore.

Konventa Nr.138 siguron të vetmin komplet të gjithanshëm të direktivave në lidhje me atë se në cilën moshë të përshtatshme fëmijët mund të përfshihen në forcën punëtore. Elementet kryesore të saja janë:

Qëllimi i Konventës

·Të zhdukë punën fëmijërore.

Mjete veprimi

·Politika nacionale të zhdukë punën fëmijërore;
·Të ngrit në mënyrë të vazhdueshme moshën minimale nga e cila fëmijët mund të hyjnë në forcën punëtore, duke u orvatë të arrihet - në moshën 18 vjeçare.

Fusha të ndaluara të punës fëmijërore (nuk mund të bëhen përjashtime)

· Ndërtimtari;
· Puna me rrymë elektrike, gaz dhe ujëra;
· Prodhimtari;
· Miniera dhe gurishte;
· Plantazhe dhe ferma (me përjashtim të atyre që janë pronë familjare);
· Shërbime sanitare;
· Transport, rojtari dhe komunikacion.

Përjashtime nacionale (të bëra pas konsultimeve me organizatat punëtore dhe punëdhënëse)

· Shfaqje artistike;
· Punë të lehta që nuk pengojnë ndjekjen e shkollimit dhe që nuk janë dëmshme për shëndetin dhe zhvillimin e fëmijëve;
· Kategori të kufizuara të punësimit e të punës ku mund të paraqiten probleme në aplikimin e Konventës;
· Stërvitje profesionale dhe të çirakut;

Raportim i Detyrueshëm nga tereni (nuk mund të përjashtohet)

· Çfarëdo punësimi ose pune që për shkak të natyrës së vet dhe kushteve në të cilat kryhet nuk mund ta rrezikojë shëndetin, sigurinë apo moralin e të rinjve.

Aktivitete të nevojshme nga qeveritë

· Moshë minimale e përkufizuar për të punuar nuk guxon të jetë nën 14—15 vjeçare;
· Të shënojë listën e veprimtarive që nuk mund të përfshihen në grupin- 'përjashtime nacionale';
· Të caktojë moshën minimale për fëmijët që të mund të hyjnë në forcë punëtore.

Konventa Nr.138 ndalon punën të kryer nga fëmijët në një sërë hapsirash (veprimtarish) dhe sinon eliminimin e vazhdueshëm të punës së fëmijëve.Sidoqoftë ajo merr në konsiderim edhe kushtet që mbizotërojnë me shtete të ndryshme dhe parashikon një qasje fleksibile në zgjidhjen e këtij problemi. Anise shtetet mund të bëjnë përjashtime ndaj rregullës kryesore, qëllimi i fundit mbetet i njëjtë: zhdukja totale e punës në moshën fëmijërore.

5.2 Konventa mbi Format më të Rënda të Punës së Fëmijëve (1999) (Nr.182)

ILO erdhi në përfundim se ekzistonte nevoja për një Konventë që do të fokusohet në format më të dëmshme të punës së fëmijëve.Në 1998 në kryeqendrën e ILO-s në Gjenevë arriti një marrsh global kundër punës së fëmijëve, duke e detyruar ILO-n që të miratojë masa të rrepta ndaj kësaj çështjeje.Në Qershor 1999, ILO-ja miratoi Konventën mbi Format më të Këqia të Punës së Fëmijëve (Nr.182).

Konventa Nr.182 e plotëson Konventën Nr.138 dhe merr parasysh edhe klauzolat e instrumenteve relevante(dokumente)-siç janë Konventa mbi Punën e Detyrueshme (1930) dhe Konventën Shtuese të KB mbi Zhdukjen e Skllavërisë,Tregëtisë dhe të Institucioneve dhe Praktikave të Ngjajshme me Skllavopronarinë (1956).Ajo është e dizajnuar ashtu që të stimulojë programe me qëllime aksionale që këto t' I mbrojnë paraprakisht fëmijët nga punësimi apo puna në ato vende që padyshim konsiderohen të jenë më të këqia-sidomos t'i mbrojnë fëmijët e rinj.

Konventa Nr.182 hyri në fuqi më 19 Nëntor 2000.Të gjitha Konventat e ILO-s hyjnë në fuqi një vit pas datës kur ratifikimi i dytë të jetë depozituar në ILO, në lidhje me këtë psh.nga (ana e) Mallavi- më 19 Nëntor 1999. Sipas të dhënave nga Janari i 2002,113 shtete kanë ratifikuar Konventën Nr.182.Ajo dallohet përnga të qenurit Konventë e ILO-s me shkallë më të shpejtë të ratifikimit, që paraqet një tregues për mbarë botën për të ndaluar këtë praktikë (punën e fëmijëve).

Elementet kryesore të Konventës Nr.182 janë:

Qëllimi i Konventës

· Të ndalojë dhe eliminojë format më të këqia të punës së fëmijëve.

Elementet

· Ndalim absolut i veprimtarisë që fëmijët të jenë përfshirë ose punësuar në këto aktivitete;
· Akcion i menjëhershëm dhe efektiv.

Definimi i një fëmie

· Çdokush nën moshën 18 vjeçare.

Format më të këqia të punës së fëmijëve

· Të gjithë format e skllavopronarisë ose të praktikave të ngjajshme me te siç janë shitja dhe shkëmbimi i fëmijëve, robërimi si borxh dhe bujkrobëria, puna e detyruar (nën shtrëngim) ose e detyrueshme (nën forcë)

- duke përfshirë edhe rekrutimin e fëmijëve në konflikte të armatosura;
- Prostitucioni I fëmijëve ose pornografia;
- Aktivitete të ndaluara, posaçërisht shit-blerja dhe bartja e drogës;
- Puna që ka gjasa të dëmtojë shëndetin, sigurinë ose moralin e fëmijëve, (këto duhen të përcaktohen me anë të ligjeve dhe rregulloreve nacionale).

Mjetet

- Programet akcionale për t' i larguar (hjekur) fëjtë nga këto forma të punës;
- Kujdes ndaj fëmijëve që janë në pozitë të rrezikshme dhe vajzave;
- Ndihmë direkte për rehabilitimin dhe integrimin social të fëmijëve të zhvendosur;
- Programe edukative që përfshijnë mundësi për shkollim fillestar të papaguar dhe trajnim të mjeshtrove;
- Mekazma mbykëqirës.

Akcioni i nevojshëm nga qeveritë

- Dizajnim i autoritetit kompetent (të qeverisë) që do të bënte zbatimin në jetë të Konventës;
- Përforcimi i sanksioneve penale;
- Të formulojë listën e punëve që do të duhej të ndaloheshin (të rikallohen dhe rishqyrtohen për ndryshime sipas nevojës).

Konventa Nr.182 ka gjithashtu edhe një rekomandim shoqëruar - Rekomandimi Nr.190.

Rekomandimi shërben si udhëheqës për akcion nacional në punën e fëmijëve, dhe në mënyrën e zbatimit të Konventës Nr.182 dhe prandaj meriton vëmendje. Elementet kryesore të Rekomandimit Nr.190 janë se qeveritë duhen:

- Të marrin në konsiderim vështirimet jo vetëm të organizatave të punëdhënësve dhe të punëtorëve, por gjithashtu edhe të grupeve të tjera të përfshira, duke marrë në konsiderim ata të fëmijëve, të njerëzve të rinj dhe familjeve të tyre;
- Të përcaktojnë shembujt e posaçëm të asaj që cilësohet si punë që çënon shëndetin, sigurinë ose moralin e fëmijëve si që kërkohet sipas Konventës Nr.182 (shih më lartë nën "Format më të Këqia të Punës së Fëmijëve").

Juan Somavia, Drejtori -Gjeneral i ILO-s, në këtë mënyrë e ka përmbledhur çështjen:

Puna e fëmijëve (child labour) nuk don të thotëpunë (profesion) për fëmijë. Ajo nuk është as përvojë e dobishme pune, as çirakllëki i kombinuar me shkollim që ngrit prospektet e tanishme dhe të ardhëshme të një fëmie. Puna e fëmijëve - në formën më të keqe të saj -është shpërdorim i forcës. Ajo është eksploatim i të rinjve nga të moshuarit, (fëmijëve) naivë, të dobët, të pafajshëm, të lëndueshëm dhe të pasigurtë për përfitim personal; anise aq shumë përpjekje të vlefshme janë duke u bërë, ne akoma nuk kemi mjaft guxim dhe imagjinatë të shkojmë përtej se 'kruarjes së skajeve' dhe aktualisht ta

ndalojmë atë në të vërtetë. Krijimi dhe ratifikimi i kësaj Konvente është pjesa më e lehtë. Pjesa më e rëndë është të gjenden shkallë (për fëmijët) të ngjiten dhe dalin nga humnerat e dhunës dhe diskriminimit në të cilat jetojnë '25

Për informata të tjera mbi punën e fëmijëve, luteni kontakti:

International Programme on the Elimination of Child Labour (IPEC)

ILO

CH 1211 Geneva 22

Switzerland

Tel: +41 22 799 8181

Fax: +41 22 799 8771

e-mail: ipecc@ilo.org

Ju mund të kontaktoni gjithashtu edhe:

Anti-Slavery International

Thomas Clarkson House

The Stablesyard, Broomgrove Road

London SW9 9TL

UK

Tel: +44 207 501 8920

Fax: +44 207 738 4110

e-mail: info@antislavery.org

6. Deklarata mbi Principet dhe të Drejtat Fundamentale në Punë (1998)

Më 1998, ILO miratoi një deklaratë që ta ripohojë zotimin e 175 shteteve anëtare të ILO-s se do t'i respektojnë principet themelore të ILO-s, të cilat janë esnciale për realizimin e qëllimeve dhe objektivave të ILO-s.

Deklarata e ILO-s mbi Principet dhe të Drejtat Fundamentale në Punë i thërret të gjitha shtetet anëtare që t'a përkrahin dhe realizojnë aplikimin univerzal të të katër principeve të të drejtave fundamentale njerëzore, konkretisht: (i) zhdukja e punës së detyrimshme, (ii) liria e asociimit dhe e drejta për tregëti kolektive, (iii) zhdukja e punës së fëmijëve, dhe (iiii) barazia në punësim dhe punë. Deklarata thekson obligimin e të gjithë shteteve-anëtare që t'i respektojnë këto katër principe themelore, pa marrë parasysh se a i kanë ratifikuar ata Konventat përkatëse, apo jo.

ILO ka paramendue një strategji dy-krahëshe për të vlerësuar ndikimin e Deklaratës dhe për të tërhequr vëmendjen ndaj shkallës gjer të cilën shtetet anëtare janë duke i respektuar këto principe themelore:

- **Rishqyrtim (Inspektim) Vjetor** i shteteve të cilat ende nuk e kanë ratifikuar ndonjë, ose më tepër nga Konventat themelore. Kjo i përcakton fushat ku shtetet anëtare ndeshen me probleme, dhe ku ILO-ja mund të ofrojë ndihmën e saj.

- **Raport Global** në njërën nga të katër principet e të drejtave fundamentale njerëzore, siç janë rradhitur në Deklaratën mbi Principet dhe të Drejtat Fundamentale në Punë. Ky raport e përshkruan situatën në të gjitha shtetet anëtare;

edhe të atyre që e kanë ratifikuar atë, edhe të tjerat, për të siguruar një pasqyrë të të drejtave fundamentale, dhe një vlerësim të ndihmës që nevojitet të sigurojë ILO-ja si një rrugë për përcaktimin e përparësive për aksion në të ardhmen. Çdo vit raporti kaplon njëren nga të katër kategoritë.²⁶

Në Qershor 2000, Organizata për Kooperim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD- / Organization for Economic Co-operation and Development) e përdori Deklaratën si një bazë për të rishikuar direktivat për ndërmarjet multinacionale, duke treguar lidhshmërinë e rëndësishme ndërmjet standardeve themelore të punës dhe tregëtisë ndërkombëtare.

Meqenëse nuk është legalisht e detyrueshme, Deklarata mban një influencë morale dhe bindëse pasi që shtetet-anëtare pritët që të tregojnë besnikëri ndaj principeve të saja. Publikimi i Rishqyrtimit Vjetor dhe i Raportit Global janë poashtu elemente të rëndësishme në tërheqjen e vëmendjes kah të katër principet themelore dhe çështjet e lidhura me ta, dhe mund të jetë i dobishëm për organizatat e pakicave dhe të njerëzve vendës, si dhe për OJQ-të që mirren me ta.

Për informata më të hollësishme, kontaktoni:
In Focus Programme on Promoting the
Declaration (DECLARATION)
ILO
CH 1211 Geneva 22
Switzerland
Tel: +41 22 799 6329
Fax: +41 22 799 6561
e-mail: declaration@ilo.org

IV. Njerëzit autoktonë

1. Prapavija historike

ILO-ja e filloi punën e saj me njerëzit vendës në vitet e '30-ta kur vëmendja e saj qe e përqëndruar në ata që atëherë quheshin punëtorët vendës (native workers). Çështja kishte të bëjë me plantazhet dhe fermat në kolonitë e mëparshme ku popullata lokale mbante barrën e punës, shpeshherë nën kushte të eksploatimit. Përhapja e këtij problemi në pjesët e ndryshme të botës bëri që ILO-ja të miratojë Konventën mbi Punën e Detyrimshme (Nr.29) më 1930. Gjatë vënies në zbatim të kësaj Konvente, ILO arriti në përfundim se çështjet e njerëzve vendës duheshin shtruar në një mënyrë tjetër.

Në 1936, ILO e miratoi instrumentin e parë ndërkombëtar - specifik për njerëzit vendës. Ky përmbliidhte rekrutimin për projekte të zhvillimit ekonomik (Konventa Nr.50 mbi Rekrutimin e Punëtorëve Vendës) (1936) të orientuar, të orientuar nga një perspektivë e (organizatave të) punëdhësve.

ILO poashtu miratoi disa konventa lidhur me sanksionet dhe kontratat e punësimit për puntorët vendës në teritoret e varura. Shumë nga ata janë shpallë të pavlerë qysh atëherë, pasi që nuk janë më relevante ose të përshtatshme.

Në vitet e '50-ta, ILO ndërmori këto akcione:

- Krijimin e një Komiteti të Ekspertëve mbi Punën e Njerëzve Vendës (1951-1954);²⁷
- Zbatimin e Programit të Indianëve të Andeve (Argjentinë, Bolivi, Çile, Kollumbi, Ekuador, Peru dhe Venecuelë) ndërmjet 1954 dhe 1973. ILO e udhëhoqi këtë orvatje multi-agjencionale për t'u ndihmue popujve vendës në këtë regjion;
- Botimi i librit - '**Njerëzit vendës**': Kushtet e jetesës dhe të punës së popullatave vendëse në shtete të pavarura' në 1953²⁸. Këto hapa shtruan themelin e angazhimit të ILO-s në lidhje me njerëzit vendës dhe të drejtat e vendësve²⁹. Aktivitetet e tashme të ILO-s në këtë sferë përfshijnë: kërkime, përpilime të standardeve dhe ndihmë teknike.

2. Konventa e ILO-s mbi Njerëzit Vendës

Gjer më sot, ILO është trup i vetëm që ka miratuar Konventa ndërkombëtare që veçanërisht kanë të bëjnë me njerëzit vendës:

- Konventa Nr.107 - Mbi Popullatat Vendëse dhe Fisnore (1957)
- Konventa Nr. 169 mbi Njerëzit Vendës dhe Fisnorë (1989).

ILO ka ndërmarrë një qasje fleksibile kur i ka shqyrtuar pyetjet e vendësve, dhe shpeshherë ka bashkëpunuar në mënyrë të drejtpërdrejtë me OJQ-të dhe organizatat e vendësve, si dhe me sindikatat. Në mbikëqyrjen e zbatimit të Konventave përkatëse (shih më vonë për detale)

kjo ka ofruar një mundësi për organizatat e vendësve dhe OJQ-të e përfshira me ta, që të bashkëpunojnë më afërsisht me ILO-n në përkrahjen dhe mbrojtjen e të drejtave të vendësve.

2.1 Konventa Nr.107 mbi Popullatat Vendëse dhe Fisnore (1957)

Komiteti i Ekspertëve mbi Punën e Vendësve, i ILO-s, i sugjeroi Konferencës Ndërkombëtare të Punës që ajo të merr në konsiderim 'problemet sociale të popullatave vendëse në shtetet e pavarura'. Si rezultat, në 1957 u miratua Konventa Nr.107 mbi Popullatat Vendëse dhe Fisnore. Në kohën kur ajo u miratua, vështrimi /qasja ndaj njerëzve vendës ishte paternaliste, me mendim se integrimi duhet të jetë qëllimi kryesor (integrimi i vendësve në suaza të popullatës shumicë).

*'Konventa buron prej supozimit themelor që integrimi në kuadër të shoqërisë dominante duhej qenë qëllim i të gjitha programeve që kanë të bëjnë me njerëzit vendës dhe fisnorë.'*³⁰

ILO nuk e mban më këtë mendim, dhe integrimi nuk është më çështje interesimi ose angazhimi - e trupave mbikëqyrës. Teksti vijues paraqet një përmbledhje të shkurtë të Konventës:³¹

Qëllimi i Konventës

- Integrim progresiv në jetën kombëtare (pa asimilim me forcë);
- Mbrojtje e njerëzve të përfshirë³²

Fushëveprimi³³

- Popullatat vendëse;
- Popujt (njerëzit apo komunitetet) fisnorë ose gjysëm-fisnorë;

Elementet

- Barazi dhe jo-diskriminim në punësim dhe punë;
- Mësim në gjuhën amtare për fëmijët;
- Liri e asocimit;
- Përmirsim i kushteve të jetesës dhe punës;
- Përkrahje dhe mbrojtje e të drejtave sociale, ekonomike dhe kulturore të njerëzve vendës dhe fisnorë;
- Mbrojtje nga shpërngulja me forcë;
- Kushtëzimi për (dhe me) shërbime shëndetsore dhe sociale;
- Njohje e vlerave kulturore dhe religjioze, dhe i ligjeve të zakonshme;
- Pranimi i (njohja e) të drejtave tradicionale mbi pronësinë e tokës (në aspekt kolektiv dhe individual);
- Programe të posaçme edukative.

Akcioni i nevojshëm nga qeveritë

· Akcioni i koordinuar, p.sh. caktimi i një agjencioni nacional që do të kryejë zbatimin e klauzolave (kushteve) të Konventës dhe të vështrojë pajtueshmërinë;

· Masa të posaçme për t'i mbrojtur këto njerëz duke marrë parasysh karakteristikat e tyre kulturore.

Duke e shqyrtuar aplikimin e Konventës Nr.107, Komiteti i Ekspertëve ka tërhequr vëmendjen kah situata e njerëzve vendës në shumicën e vendeve ku ka bërë kërkime, duke përfshirë: Argjentinë, Brazil, Bangladesh, Kollumbi, Ekuador, Indi, Irak dhe Pakistan.³⁴ Çështjet kanë përfshirë: punën e detyrimshme, keqpërdorimin e të drejtave njerëzore, shëndetësinë, dhe keqpërdorimin / cënimin e pronësisë tokësore.

Komiteti i Ekspertëve kërkon nga të gjitha qeveritë pjesmarrëse që të ndërmarin masa të nevojshme që do të sigurojnë përshtatshmëri me klauzolat e Konventës, dhe të qëndrojnë (vazhdojnë) në raportimin e problemeve me të cilat ballafaqohen njerëzit vendës - gjersa ato të zgjidhen në mënyrë të kënaqshme. Kjo gjë do t'u kontribuonte përpjekjeve të Komitetit në provimin (orvatjen) që të sigurojë që kushtet jetësore dhe të punës të njerëzve vendës të jenë të përmirsuara. Për shembull:

- Brazil:

- Në 1993, Komiteti përmendi (rinjohtoi):
*'se situata e popullatës Yanomami ka qenë çështje komentimesh nga ana e Komitetit për vite me rradhë; qysh kur tokat e tyre ishin invaduar nga mijëra minatorë-kërkues të arit (garimperos), duke sjellë sëmundje, shkatërim të ambientit dhe probleme të tjera në këto hapësira - më parë -të izoluar. ...Komiteti kërkon nga qeveria që të ndërmarë masa urgjente për të përmirsuar këtë situatë, dhe të raportojë detalisht mbi masat që i ka ndërmarë ... Përveç kësaj, Komiteti është i shqetësuar nga raportet e vazhdueshme se Indianëve u imponohet puna e detyrimshme - së bashku me prezencën e garimperosëve- në këto hapësira.'*³⁵

- Në 1996, Qeveria e Brazilit doli para Komitetit të Zbatimeve (Application Committee).

Në raportin e vet të vitit 1997, që kishte të bëjë me këtë diskutim, Komiteti i Ekspertëve:

*'e kritikon faktin që invadimi i tokave të vendësve, e sidomos të tokave të popullatës Yanomami, vazhdon vite me rradhë me gjithë pasojat serioze që invadimi i shkakton në shëndetin dhe mbijetesën e këtyre njerëzve'*³⁶

- Sa i takon kësaj, Komiteti i Ekspertëve ia

tërhoqi vërejtjen Qeverisë në ndikimin e vendimit Nr.1775 të Janarit 1996 mbi pronat tokësore të njerëzve vendës.

Në vitin 1999 Komiteti i Ekspertëve komentoi mbi informatën e siguruar nga Qeveria mbi çështjet e epërme, përveç të tjerave, dhe kërkoi nga Qeveria që t'i mbajnë të informuar mbi përparimin dhe efektet e programeve për t'i dëbue garimpero-t nga territoret Yanomami'. Ai gjithashtu shprehte keqardhje mbi ramjen e shkallës së zhvillimit të banorëve Yanomami dhe të popujve të tjerë vendës (Ye'kuana Maiongong), dhe shprehu vërejtje mbi eksploatin e vazhdueshëm të punës së vendësve.³⁷

- Komiteti i Ekspertëve vazhdon të kontrollojë zbatimin e Konventës nga Qeveria.

Konventa Nr.107 siguron aparat të vlefshëm për mbrojtjen dhe përkrahjen e të drejtave të vendësve dhe prandaj nuk do të duhej të nënçmohet. Meqenëse e kritikuar për qasjen e saj si integracioniste dhe të vjetëruar, ajo përmbledh shumë klauzolatë cilat sigurojnë mbrojtje të fortë për njerëzit vendës, duke përfshirë edukatë, shëndet, të drejta njerëzore dhe të drejta tokësore. Prandaj ajo mund të sigurojë argumente bindëse për përforcimin e këtyre të drejtave në vendet të cilat e kanë miratuar këtë Konventë.

Konventa Nr.107 është në forcë në vendet vijuese : Angolë, Bangladesh, Belgji, Brazil, Kubë, Republikën Dominikane, Egjipt, El Salvador, Ganë, Guine Bisao, Haiti, Indi, Irak, Mallavi, Pakistan, Panama, Portugali, Republikën Arabe të Sirisë dhe Tunizi.

Konventa Nr.107 është shpallë automatikisht e pavlerësi rezultat i miratimit të Konventës Nr.169 në këto vende: Argjentinë, Bolivi, Kolumbi, Kosta Rikë, Ekuador, Meksiko, Paraguaj, dhe Peru.

Pasiqë Konventa Nr.107 u revizionue (rishikue) në 1989 nga Konventa Nr.169, ai nuk është i hapur për miratim. Sidoqoftë, ai mbetet i vlefshëm dhe detyruet për ato shtete që e kanë miratue atë. Për të gjitha shtetet tjera, Konventa Nr.169 paraqet Konventë të hapur për miratim.

Raportet mbi zbatimin e Konventës Nr.107 u marrën nga qeveritë në vitin 2000. Raportet e ardhëshme do të mirren në vitet 2005, 2010, 2015 etj. - me përjashtim të shteteve të cilave u është kërkuar që të sigurojnë raporte më herët nga Komisioni i Ekspertëve, ose në rast se procesin e mbikëqyrjes nga ILO - e aktivizojnë rrethana të tjera , p.sh. komente nga organizatat e punëdhënësve apo të punëtorëve.

Shënim: Konventa Nr.107 dhe 169 nuk janë të përcaktuara si Konventa prioritare për ILO-n, prandaj, ciklusi i tyre raportues është 5 vjet.

2.2 Konventa Nr.169 mbi Njerëzit Vendës dhe Popullatat Fisnore (1989)

Ndërmjet viteve 1957, kur u miratue Konventa Nr.107 dhe 1989, shumë ecuri e shtynë ILO-n që t'a merr në rishqyrtim Konventën Nr.107. Këtu përfshihen:

- Ngritja e vetëdijes dhe mobilizimit të njerëzve vendës dhe OJQ-ve të cilët konsideronin se Konventa 107 mbulonte shumë pak prej nevojave dhe interesave të tyre dhe se kishte shumë të meta³⁸
- Studimi orientues i KB 'Studim në çështjen e diskriminimit ndaj popullatave vendëse' të bërë nga Joze R. Martinez Cobo, raportues special i Nën-Komisionit të KB për Parandalimin e Diskriminimit dhe Mbrojtjen e Pakicave³⁹ (1971-86)⁴⁰.
- Një Grup Punues i KB mbi popullatat vendëse u themelue në 1982 dhe filloi të përpilojë një standard mbi të drejtat e vendësve në 1984⁴¹.

Në Shtator '86, ILO thirri një mbledhje të ekspertëve që t'a diskutojnë këshillueshmërinë e rishikimit (heqjes) të Konventës Nr.107. Kjo mbledhje ishte historike për atë se këtu, për herë të parë u thirrën formalisht OJQ-të (Survival International dhe World Council of Indigenous Peoples) që të marrin pjesë në një mbledhje zyrtare të ILO-s.⁴² Duke ndjekur këtë mbledhje, ILO e vuri këtë temë në rendin e ditës së Konferencës Ndërkombëtare të Punës.

Pas dy vitesh të debatit intenziv, dhe shpeshherë të ashpër, në Qershor të 1989, ILO e miratoi Konventën mbi Njerëzit Vendës dhe Popullatat Fisnore (Nr. 169). Një nga çështjet më polemike gjatë procesit të miratimit ishte përdorimi i termit 'njerëzit' (peoples) pasi që disa pjesëmarrës, kryesisht qeveritë, besonin se përdorimi i termit 'peoples' njerëzve vendës do t'u kishte dhënë të drejtën për vetëpërcaktim, dhe si shtesë, të drejtën për shkëputje. Për njerëzit vendës, termi i vetëm i saktë ishte 'peoples'.

Në përpjekje që të thehej një situatë e dështimit të plotë u propozua një kompromis: të përdoret termi 'peoples' por, t'a përfshijë shprehjen kualifikuese që thotë:

Përdorimi i termit 'peoples' në këtë Konventë nuk do të interpretohet sikur me pasë nënkuptim siç që do t'i takonin të drejtat që do t'i bashkangjiteshin këtij termi sipas ligjit ndërkombëtar.' (artikulli - 1 /3)

Njerëzit vendës - pjesëmarrës të kësaj mbledhjeje ishin kundër këtij opcioni; prapëseprapë Konventa u miratua duke e përdorë këtë formulim. Si pasojë, njerëzit vendës e kanë kritikuar përfshirjen e këtij Artikulli në Konventë, pasi ai nuk mjafton për t'i plotësue pritjet e tyre dhe krijon një përparësi të rrezikshme. Pozita e ILO-s është se kuptimi dhe nënkuptimi (implikimi) i termit 'peoples' është një çështje për OKB të vendosë, dhe se përdorimi i kësaj

shprehjeje në Konventë bën të qartë se kjo çështje është jashta jurisdiksionit të ILOs.

Çështje tjetër gjatë miratimit që shkaktoi shumë debat ishte çështja e pjesëmarrjes së njerëzve vendës. Njerëzit vendës mundeshin, dhe kjo ndodhi, të japin kontributin në mbledhjet si përfaqësues të - **(i)**-delegacioneve të qeverive, të punëdhënësve dhe të punëtorëve, **(ii)** OJQ-ve, psh. Anti-Slavery International dhe International Work Group for Indigenous Affairs (Organizata Ndërkombëtare Kundër-Robërimit, dhe Grupi Punues Ndërkombëtar për Çështje të Vendësve), dhe **(iii)** - të organizatave vendëse, p.sh. The Four Directions Council, Saami Council dhe 'the World Council of Indigenous People' - (Këshilli Katër-Drejtimësh, Këshilli 'Saami' dhe Këshilli Botëror i Njerëzve Vendës). Prapëseprapë, pjesmarja e vendësve në ILO gjatë miratimit të Konventës Nr.169, ishte e kufizuar. Përkundër këtyre të metave, Konventa u bë përcaktues për çështjet e vendësve, dhe mbetet instrument më përmbledhës dhe më detal në këtë temë.

Në vijim është një pasqyrë e shkurtë e çështjeve kyçe të Konventës Nr.169⁴³:

Qëllimi i Konventës

- Njohje e së drejtës së njerëzve vendës dhe fisnorë që të ekzistojnë si njerëz të veçantë (distinct peoples)

Orientimi

- Konsultimi dhe pjesëmarrja si elemente fundamentale për çdo akcion;
- Respekti ndaj traditave, kulturave dhe mënyrave të jetesës së njerëzve vendës dhe fisnorë;
- Kah vetë-qeverisja - të sigurojë resurset dhe mundësitë që njerëzit vendës dhe fisnorë të vendosin vetë për ardhmërinë e tyre;

Fusha e veprimit

- Të përfshijë njerëzit vendës dhe fisnorë, pa diferencim ose përcaktim të tyre;

Parimet themelore

- E drejta për vetë-përcaktim si kriter themelor;
- E drejta për konsultim dhe pjesëmarrje;
- E drejta për të vendosë për prioritetet e tyre të veta në lidhje me zhvillimin.

Çështjet kryesore

- Kontaktet ndërkufitare (njerëzit vendës të ndarë me kufij nacionalë);
- Edukimi duke përfshirë udhëzime në gjuhën amtare;
- Punësim dhe punë;
- Të drejtat ndaj tokës, duke përfshirë resurset natyrore dhe ambientin;
- Shërbime të sigurimit social dhe shëndetësor duke përfshirë shërbimet tradicionale shëndetësore;
- Trajnim (ushtrim) mjeshtëror dhe aktivitete tradicionale.

Akcioni i kërkuar nga qeveritë

- Të zhvillojë akcion të koordinuar dhe sistematik për t'i mbrojtur këta njerëz dhe për të respektuar integritetin e tyre;
- Të sigurojë burimet për zhvillimin e tyre.

Konventa Nr. 169 është një ndër instrumentet më të gjithanshme në fushën e së drejtës ndërkombëtare, që prek në të gjitha aspektet e jetës së njerëzve vendës siç janë edukimi dy-gjuhësor, ligji i zakonshëm, rrethi jetësor, të drejtat mbi pronat tokësore, vlerat shpirtërore etj. Ai është poashtu i rëndësishëm sepse ai formon konceptin-ose shpall për herë të parë të drejtën për vetëpërcaktim dhe të drejtën për konsultim dhe participim. Kjo gjë ndihmoi që këto çështje të fitojnë njohjen si elemente kyçe në ligjin ndërkombëtar që ka të bëjë me njerëzit vendës.

Konsultimi dhe participimi, duke u përfshirë në fushën e zhvillimit, janë udhëzime ose porosi fundamentale të Konventës. Konventa Nr. 169 parashikon që njerëzit vendës do të duhej të jenë të përfshirë në çdo hap të çdo procesi të zhvillimit që do të kishte ndikim mbi ta, dhe se ata do të duhej të kontrollojnë dhe qeverisin proceset e tyre të veta të zhvillimit. Veç kësaj, studimet e mëparshme të vlerësimit të ndikimit duhet patjetër të jenë të drejtuara që të udhëheqin intervencat e zhvillimit në çështjet e vendësve (artikulli 7). Konventa Nr. 169 gjithashtu rithekson se njerëzit vendës duhet të marrin pjesë në përdorimin, udhëheqjen dhe kontrollin e rrethinës së resurseve natyrore në tokat-prona të vendësve (artikulli 15).

Në rastin e zhvendosjes së njerëzve vendës Konventa i dikton direktivat e qarta proceduriale për relokacionin (rivendosjen e tyre), ashtuqë ata (direktivat) të përmbajnë mbrojtjen e informatave publike. Kjo është parashikuar si një masë emergjence (psh. tërmete, vërshime etj) dhe është për t'u zbatue vetëm me pëlqimin e tyre të lirë dhe të informuar. Sidoqoftë, pasiqë shumë projekte zhvillimore ndodhin në tokat - pronë e njerëzve vendës, kjo klauzolë (artikulli 16) është kritikuar si faktor përgjegjës për të ndihmuar dislokimin e njerëzve vendës nga tokat e tyre tradicionale. Konventa Nr. 169 vazhdon të sqarojë se atje ku këto zhvendosje janë patjetër të nevojshme, njerëzit që i përfshinë duhet patjetër të kompenzohen për humbjen e tyre, dhe ku dëmshpërblimi nuk është i mundshëm - njerëzit vendës do të duhej të furnizoheshin me prona tokësore që janë të barazvlefshme në kualitet dhe status me ata që u janë marrë.

Konventa Nr. 169 është ratifikuar (sipas evidencave të Janar - 2002) nga ana e: Argjentinës, Bolivisë, Kollumbisë, Kosta-Rikës, Danimarkës, Ekuadorit, Fixhit, Guatemalës, Hondurasit, Meksikos, Holandës, Norvegjisë, Paraguajit dhe Perus.

Konventa është një instrument i vlefshëm bisedimesh për njerëzit vendës dhe organizatat që punojnë për ta. Ndikimi i saj dhe influenca shkon përtej (kufirit të) shteteve që e kanë miratuar atë dhe ai është përdorur për të zgjerue direktivat për njerëzit vendës-psh. në Kamboxhë, ku Qeveria është në etapat e fundit të miratimit të direktivave për ndihmë në zhvillimin e njerëzve nga malësia.⁴⁴

Mbikëqyrja dhe ndikimi

Trupat mbikëqyrës të ILO-s, të quajtura Komitetet e Ekspertëve, e kanë pasë vëzhguar zbatimin e Konventës Nr. 169 në shtetet që e kanë miratuar atë. Të drejtat tokësore kanë marrë përparësi mbi të gjitha çështjet tjera, dhe komentet e Komitetit të Ekspertëve mbi Konventën gati se gjithmonë kanë qenë të përqëndruara në këtë temë.

Si shtesë, janë paraqitur një numër ankesash⁴⁵ (të bëra nga ana e sindikatave, në emër të njerëzve vendës) lidhur me shkeljen e Konventës Nr. 169. Megjithëse të gjitha ata kanë përfshirë ankesa lidhur me mospërfilljen e koncepteve kyçe të Konventës, siç janë konsultimi dhe participimi që është rast në Kollumbi (shih më poshtë), ata, të gjitha, kanë përqëndruar vëmendjen në mos-zbatimin e klauzolave të Konventës që kanë të bëjnë me pronat tokësore (Artikulli 13-19) - ku përfshihen: Bolivia, Kollumbia, Danimarka, Ekuadori, Meksikoja dhe Peru. Psh. në lidhje me Kollumbinë, Komiteti i Ekspertëve - në raportin e vitit 2001- shënoi këtë:

“Në lidhje me situatën e komunitetit Embera Katio në regjionin Alto Sinu, të ndeshur me ndërtimin e një pende hidroelektrike (proekti Urra), Komiteti shënon se shumë pyetje që kanë të bëjnë me këtë situatë, pjesërisht si shkak i orvajtjes së dështuar për t' u konsultuar me popullatën e përfshirë, dhe dëmit të pashërueshëm të shkaktuar ndaj rrethit të tyre, janë duke u shqyrtuar në kontekst të dy paraqitjeve të bëra në bazë të artikullit 24 të Kushtetutës, që konsiderohen si të pranueshme nga Trupi Drejtues”⁴⁶

Përsëri, në lidhje me Kosta Rikën, Paraguajin dhe Peru-n, Komiteti i Ekspertëve i përqëndroi komentet për 2001 në klauzolat e pronave tokësore. Sa i përket Perus, Komiteti vuri në dukje se Konfederata Qendrore e Punëtorëve në Peru (CUT) kishte paraqitë vërejtje që dëshmonin mosrespektimin e Konventës nga ana e Qeverisë së Perus:

“CUT pohon se Qeveria e Peru-s ka vënë në qarkullim Dekretin Suprem Nr. 17-99-AG, të datës 03 Qershor 1999 që shpronëson 111,656 Hektarë të tokave stërgjyshore që u takonin Bashkësive Vendase të Santo Domingo de Olmos (“Bashkësisë”), një bashkësi vendëse... Bashkësia e lut qeverinë t'i furnizojë me informata në orvatjet e bëra për demarkimin e tokave stërgjyshore të Komunitetit, duke përfshirë edhe 111,656 hektarët e tokave...”⁴⁷

Konventa Nr.169 është përdorur për dialog ndihmues gjatë konfliktëve të një numri rastesh. Gjatë negociatave paqësore ndërmjet qeverisë së Guatemalës dhe Unionit Nacional-Revolucionar të Guatemalas (URNG0) që filluan në 1987 dhe arritën kulminacionin me marrveshje paqësore që përfshinte Marrveshjen mbi Identitetin dhe të Drejtat e Njerëzve Vendës të pajtuar nën patronazhin e OKB në 1994, Konventa Nr.169 siguroi bazën për diskutimet. Guatemala e miratoi Konventën Nr.169 si parakusht të marrëveshjeve.

Në një rast tjetër, më 16 Shkurt 1996, Qeveria e Meksikos dhe Armata Nacional Çlirimtare e Zapatës (EZLN) e nënshkruajtën marrëveshjen e paqës në San Andres me ndihmën e Chiapave që përdornin Konventën në negociatë.⁴⁸ Meksikoja ishte vendi i dytë që miratoi Konventën në Shtator 1990.

Konventa Nr.169 mundet gjithashtu të ndihmojë për të orientue ndihmën për zhvillim për shtetet industriale, psh. Gjermania dhe Zvicra. Holanda e miratoi Konventën mu për këtë arsye. Ajo gjithashtu është përdorur edhe në bërjen politikë për njerëzit vendës me anë të institucioneve ndërkombëtare financiare, siç janë Banka Aziatike e Zhvillimit, Bashkësia Europiane dhe Banka Botërore në revizionin e tij të fundit të direktivave operative. Si Konventë e vetme e gjithanshme, ndërkombëtare - mbi njerëzit vendës, ajo është bërë pikë referuese për të drejtat e vendësve dhe një Konventë e rëndësishme për përcaktimin e standardeve lidhur me këtë.⁴⁹

Sidoqoftë është me rëndësi të mbajmë në mend se kjo Konventë përcakton pikën fillestare për të drejtat e njerëzve vendës. OJQ -të dhe njerëzit vendës duhet të jenë të vetëdijshëm se ajo shërben si njësi për matje dhe përshkruan standardet minimale; nuk ka kurrjë që i ndalon qeveritë nga tejkalimi i parametrave të konventës Nr.169.

Për informata plotsuese mbi Konventën Nr.169, kontaktoni:
Equality and Employment Branch (EGALITE)
Standards Department
ILO
Switzerland
Tel:+41 22 799 7115
Fax:+41 22 799 6344
e-mail: egalite@ilo.org

Sipas ciklit të rregullt raportues, raportet do të arrijnë në Konventën Nr.169 të 2003. Mandej raportet do të jenë në disponim në vitin 2008, 2013 etj, poqëse nuk janë kërkuar më herët.

Ndihma teknike

ILO ka dy programe kooperative teknike të dizajnuara në mënyrë specifike për njerëzit vendës;
· Programi INDISCO (Program Inter Regjional për Përforcimin e Vetëbesimit të Vendësve dhe Komuniteteve Fisnore me anë të Kooperativave dhe Organizatave Vetëkontribuese), i cili punon

nëpërmes kooperativave, huave qarkulluese dhe mekanizmave të tjera të këtilla për të ndihmue njerëzit vendës të bëhen më të vetëmjaftueshëm (vetëkënaqur) në aspekt financiar. Ai ka projekte në Azi, Afrikë dhe Amerikën Latine;

· Projektin për Përkrahjen e Politikës së ILO-s ndaj Njerëzve Vendës dhe Fisnorë. Ky u themelue në 1996 në kuadrin e miratimit të Konventës Nr.169 nga ana e Danimarkës (me ndihmë të fondit nga Programi Danez për ndihmë në zhvillim - DANIDA). Qëllimi i tij kryesor është që të ngritë vetëdijen dhe zbatimin e Konventës Nr.169 dhe, ku ka mundësi, zbatimin e Konventës Nr.107. Ai vepron kryesisht në Afrikë dhe Azi, dhe në një farë mase edhe në Amerikën Latine.

Të dy këto programe punojnë ngushtë me organizatat e vendësve dhe OJQ-të, si edhe me qeveritë.

Për informata plotsuese kontaktoni:
Project to Promote ILO Policy on Indigenous and Tribal People
Equality and employment branch (EGALITE)
Standards Department
ILO
Geneva
Switzerland
Tel: +41 22 799 7445
Fax: +41 22 799 8572
e-mail: coop@ilo.org

INDISCO Programme
Cooperatives Department (COOP)
ILO
Geneva
Switzerland
Tel: +41 22 799 7445
Fax: +41 22 799 8572
e-mail: coop@ilo.org

V. Mekanizmat që sigurojnë pajtim me standardet e ILO-s

1. Sistemi mbikëqyrës

ILO ka një numër të madh të Konventave dhe Rekomandimeve mbi çështjet ndërkombëtare socio-ekonomike dhe të punës. Sidoqoftë, standardet nuk mund të veprojnë në vakuum, dhe kanë nevojë për një sistem mbikëqyrës për të vlerë vlerësuar efektivitetin e tyre. Ky kapitull ju furnizon me një pasqyrë të sistemit mbikëqyrës të ILO-s.

1.1 Raportet e rregullta (për shtetet anëtare)

Artikulli i 22 i Kushtetutës së ILO-s kërkon që shtetet anëtare të paraqesin raporte ndaj ILO mbi hapat që i kanë ndërmarrë për t'i implementuar (miratuar) Konventat ndaj të cilave ata janë një organizatë-palë (party) (d.m.th ata janë një palë - organizative -shtetërore / State Party/ nëse ata e kanë miratuar një Konventë).

Proçesi raportues është siç vijon:

· Pasiqë një shtet anëtarë miraton një Konventë të posaçme, kjo Konventë do të hyjë në fuqi për atë shtet saktësisht një vit më vonë.

· Shteti anëtar që e ka miratuar një Konventë kërkohet që të dërgojë raportin e parë detal ndaj ILO-s, pasiqë Konventa të hyjë në fuqi për atë shtet, dhe raportin e dytë detal - dy vite më vonë. Këto dy raporte do të duhet patjetër të përfshinë informata në të gjitha kushtet administrative, vendimet gjyqësore, ligjet, rregullativat, etj, që mund të kenë lidhje me shkallën gjer ku ligji kombëtar dhe praktika ndeshen me klauzolat e Konventës.

· Bazuar në informatën e raportit të qeverisë, dhe informatën tjetër plotësuese nga burimet e besueshme (Komitetet e OKB, raporte nga sindikatat, OJQ-t etj), ILO-ja bën vlerësimin e gjithanshëm të ligjit dhe të praktikës në atë shtet në kuadrin e Konventës përkatëse. Është me rëndësi të shënohet se kjo siguron bazën për punën e ardhshme të ILO-s në këtë fushë. Pakicat dhe OJQ-të e njerëzve vendës duhet të garantojnë se interesat e tyre janë marrë në konsiderim gjatë kësaj periudhe fillestare të raportimit, duke ofruar informatë me anë të ndonjë sindikate miqësore.

· Pas kësaj raportet duhet të bëhen në bazë të rregullt dhe t' u dorëzohen trupave mbykëqyrës të ILO-s.

Ja një shpjegim të sistemit të raportimit:

· Janar 1993: Republika Çeke e miraton Konventën Nr.111 të ILO-s mbi diskriminimin (punësimi dhe proçesi i punës) (1958);

· Janar 1994: Konventa Nr.111 hyn në fuqi për

Republikën Çeke;

· Shtator 1994: Raporti i parë është për shkak të nënshtrimit ndaj ILO-s;

· Shtator 1996 : Raporti i dytë nevojitet për shkak të nënshtrimit (poashtu);

· 1997 e tutje: Raporte të rregullta çdo dy vjet pasiqë Konventa Nr.111 është një ndër 12 Konventat fundamentale (shih më poshtë).

Cikli i raportimit

Në vitet e mëparshme, shtetet anëtare duheshin patjetër të dorëzojnë raporte çdo vit në lidhje me të gjitha Konventat për të cilat ishin të lidhur. Sidoqoftë, kjo u kritikua si diçka e rëndë, sidomos për ata vende me resurse të kufizuara, duke marrë në konsiderim numrin e madh të Konventave dhe numrin rritës të ratifikimeve nga ana e shteteve anëtare. Në 1995 kërkesat raportuese u rishikuan dhe u vendos që periudha raportuese të ndryshojë prej 1 në 5 vite, varësisht nga Konventa dhe situata në shtet.

Rregulla e përgjithshme është që raportet duhet të dorëzohen çdo pesë vjetme dy përjashtime:

· Raportet mbi 12 Konventat fundamentale dhe prioritare. Siç u sqarua më herët, këto janë të ndara në 4 kategori-puna e fëmijëve, diskriminimi, liria e asociimit dhe puna e detyrueshme - dhe raportet janë të detyrueshme për çdo kategori çdo vjet, me Konventën përkatëse në çdo kategori. Psh. Republika Çeke duhet patjetër të sigurojë një raport mbi Konventën Nr.111 në njërin vit dhe për Konventën Nr.100-vitin e ardhshëm, pasiqë këto janë dy Konventat fundamentale në lidhje me diskriminimin (shih gjithashtu në kapitullin II). Të katër Konventat e tjera prioritare janë - Nr.81, 122, 129 dhe 144.

· Komiteti i Ekspertëve mundet të kërkojë edhe raporte plotësuese jashtë ciklit të rregullt raportues pasiqë ai është trup kryesor i ILO-s që shqyrton se si zbatohet një Konventë në ligj dhe praktikë. Kjo mund të ndodhë nëse :

- Paraqiten ankesa në lidhje me shpërdorimin e madh të të drejtave njerëzore⁵⁰ që tregojnë se situata në vendin e dhënë është serioze dhe meriton shqyrtim më të afërt. Për shembull, Komiteti i Ekspertëve mund të shprehë dëshirë për të mbajtur vështrim të afërt ndaj ngjarjeve në zhvillim në një shtet të caktuar, si një mjet të presionit ndaj qeverisë që të ndërmerr hapa për të zgjidhur problemin (për detale të tjera-shih më vonë);

- Një organizatë punëdhënëse ose e punëtorëve paraqet 'vërejtje' duke dëshmuar se shteti anëtar nuk i plotëson obligimet e veta në lidhje me

Konventën e dhënë. Kjo mund të vjen prej një organizate lokale kombëtare ose ndërkombëtare dhe në praktikë shprehet në formë të një komunikimi të shkruar në adresë të ILO-s; Bëhet një kërkesë prej Komitetit të zbatimeve (Applications Committee), ose një komiteti të themeluar nën procedura të veçanta konstitucionale, që kërkon nga Komiteti i Ekspertëve të vazhdojë zbatimin e rekomandimeve të përfshira në raportet e këtyre komiteteve (shih më vonë në 2.2 për detale).

Përjashtimet e sipërme ofrojnë një mundësi për të theksuar çështjet jashta ciklit të rregullt raportues dhe kanë një rëndësi të madhe në lidhje me ato Konventa që kanë ciklin raportues pesë vjeçar - psh. Konventat që merren me njerëzit vendës - Konventat Nr.107 dhe 169.

Organizatat e pakicave dhe të vendësve, si dhe OJQ-të e interesuara që dëshirojnë të punojnë me ILO-n për të mbrojtur të drejtat e vendësve dhe të pakicave, duhet t'i konsiderojnë këto mundësi si një mënyrë për të bërë ndikim në punën e Komitetit të Ekspertëve. Ata mund t'i dërgojnë informatat drejtpërdrejtë në ILO ose nëpërmjet një organizate punëdhënëse miqësore apo organizate punëtore miqësore, anise sindikatat e punëtorëve janë zakonisht më të pranueshme. Nëse ai përmban fakte (të dhëna) të rënda, ligje dhe klauzola administrative (zyrtare), raporte të rasteve e tjerë, Komiteti mund ta marrë atë parasysht në punën e tij mbikëqyrëse.

Informata mund të dërgohet me anë të cilësdo organizatë të punëtorëve, ose për raste të nevojshme, organizate të punëdhënësve; ajo nuk është e kushtëzuar të jetë prej shtetit përkatës. Pasiqë informata vjen prej një anëtari përbërës, dmth një organizate të punëtorëve ose të punëdhënësve, ILO-ja duhet patjetër ta marrë atë në shqyrtim

Organizatat e punëdhënësve dhe të punëtorëve

Element tjetër i procesit të raportimit është nevoja, që përfshihet në të gjitha Konventat e ILO-s, që kërkon që raportet duhen patjetër t' u dërgohen organizatave të punëdhënësve dhe të punëtorëve, dhe këta organizata e kanë të drejtën që t'i plotësojnë me komentet e tyre të veta. Shikuar në mënyrë ideale raportet do të duhej të pregatiten në konsultim me këto organizata, por shkalla gjer ku kjo gjë realizohet ndryshon prej shteti në shtet.

Ky do të mund të ishte një rrugë tjetër për organizatat e pakicave dhe të vendësve si dhe për OJQ-të e përfshira që të bashkëpunojnë ngusht me organizatat e punëdhënësve dhe të punëtorëve në sigurimin e përputhshmërisë më të madhe me Konventat e ILO-s.

1.1 Raportet mbi Konventat e pamiratuara (Vështrimet e Përgjithshme) çështjes.

Artikulli (Neni) 19 i Kushtetutës së ILO-s i obligon shtetet anëtare të u ofrojnë raporte trupave mbikëqyrëse të ILO-s për gjendjen në ligj dhe praktikë në lidhje me Konventat ose Rekomandimet e veçanta. Kështu, shtetet anëtare të ILO-s janë poashtu të obliguar të ofrojnë informatë mbi shkaqet e shtyerjes ose pengimit të miratimit.

Trupi Drejtues i ILO-s vendos se cilat çështje do të duhej të shqyrtohen, dhe e thekson Konventën përkatëse, ose grupin e Konventave dhe Rekomandimeve që kanë të bëjnë me atë temë të çështjes. Zgjedhja bazohet në interesat momentale të ILO-s. Kohët e fundit temat janë bartë prej barazisë së mundësisë dhe trajtimit - në 1996, në punëtorët migruar - në 1999, konsultimit trepalësh në - 2000 dhe punës së natës së grave në industrinë 2001.

Menjëherë pasi që Trupi Drejtues vendos për ndonjë temë, pyetësorët u dërgohen shteteve anëtare. Përgjigjet e shteteve anëtare analizohen dhe përpilohen në një raport të ashtuquajtur 'Vështrimi i Përgjithshëm' (General Survey). Këto vështrime prodhojnë raporte në thellësi, që të mundësojnë që ILO të krijojë bindje se a veprojnë në mënyrë efektive standardet e posaçme. Ata poashtu ndihmojnë që të tërhiqet vëmendja kah qeveritë që nuk e kanë miratuar apo zbatuar ndonjë Konventë të posaçme, dhe në këtë mënyrë duke forcuar shtypjen në të që t'a bëjnë atë. Së fundi, ata përdoren për të përcaktuar se a janë Konventat dhe Rekomandimet e caktuara të përshtatshme për kohën ose nevoiten të rishqyrtohen.

2. Trupat mbikëqyrës

Zbatimin e Konventave dhe Rekomandimeve të ILO-s e mbikëqyrin një numër trupash dhe mekanizmash. Ja një pasqyrë të sistemit:

2.1 Komiteti i Ekspertëve në Zbatimin e Konventave dhe Rekomandimeve

Komiteti i Ekspertëve në Zbatimin e Konventave dhe Rekomandimeve (shkurt - Komiteti i Ekspertëve) është trupi i vetëm përgjegjës për të shqyrtuar raportet prej shteteve anëtare.

Komiteti i Ekspertëve u krijua në 1926 nga ana e Konferencës Ndërkombëtare të Punës (International Labour Conference) që të analizojë:

- Raportet një-vjeçare që paraqiteshin në bazë të artikullit të Kushtetutës;
- Informatat dhe raportet mbi Konventat dhe Rekomandimet e pa-miratuara (Artikulli 19)
- Informatat dhe raportet mbi zbatimin e Konventave në territoret jo-metropolitane⁵¹ - territoret nën përkujdesje të KB ose territoreve tej-oqeanike (jashta-Europiane) (Artikulli 35).

Komiteti i Ekspertëve përbëhet prej 20 ekspertëve të pavarur. Parimet e tija fundamentale janë - paanshmëria, pavarësia dhe objektiviteti. Ekspertët

janë të caktuar sipas kapacitetit të tyre personal, dhe e kanë prejardhjen prej sistemeve të ndryshme legale, ekonomike dhe shoqërore, ashtuqë të sigurojnë një balans të gjërë gjeografik dhe teknik. Ata janë të emëruar nga ana e Trupit Drejtues, në sugjerim të Drejtorisë së Përgjithshme, për një periudhë prej 3 vitesh , që zakonisht përtrihet. Në këtë mënyrë përforcohen edhe vazhdimësia, edhe paanshmëria.

Komiteti i Ekspertëve mban sesion vjetor prej Nëntorit gjer në Dhjetor në kohë kohë prej përafërsisht 3 javë. Sesionet, sidoqoftë, janë të mbyllura për publikun kështuqë nuk ka qasje gjer te OJQ-të ose organizatat tjera, apo individët. Kjo është bazë për kritikim të sistemit të ILO-s sikur asaj i mungon transparenca dhe qasja. Nën kushte të këtilla, alternativa për organizatat e pakicave dhe të vendësve, dhe për OJQ-të tjera të përfshira, është të i dorëzojnë informatë ILO-s për nënshtrim (përlulje) ndaj Komitetit të Ekspertëve. Kjo do të ishte mirë të bëhej përpara takimit të tyre. (Për detale të mëtejshme shih në Kap.VIII)

Një listë e plotë e anëtarëve të Komitetit të tanishëm të Ekspertëve është e përfshirë në Raportin Vjetor të Komitetit, dhe gjithashtu mund të merret nga ILO-ja.

Metodat e punës

Komiteti i Ekspertëve i ka këto metoda të punës:

- Secili ekspert është përgjegjës për një grup të Konventave ose temave;
- Në vlerësimin e situatës në një shtet të caktuar, në lidhje me klauzolat e Konventës, ose Konventave përkatëse, eksperti mund të i fusë (përfshijë) dokumentet vijuese në analizën e vet:
 - Komente të parashtruara nga ana e organizatave të punëdhënësve dhe të punëtorëve;
 - Informata dhe dokumente të ofruara nga qeveria;
 - Raporte nga trupa të tjerë ndërkombëtarë, p.sh. Komisioni Inter-Amerikan mbi të Drejtat e Njeriut, Organizata për Siguri dhe Kooperim në Europë, Banka Botërore;
 - Dokumente të OKB-së, p.sh. Komiteti i KB për Eliminimin e Diskriminimit Racial, Komisioni i KB mbi të Drejtat e Njeriut;
 - Çfarëdo informate tjetër që mund të jetë e vërtetueshme dhe mbështetet në evidenca konkrete siç janë ligjet, rregullativat, vendimet gjyqësore etj. Kjo mund të përfshijë informata prej organizatave të pakicave dhe të vendësve, si dhe të OJQ-ve të interesuara. Për shembull, informata e siguruar nga ana e Amnesty International , Anti-Slavery International dhe Survival International, është përdorur nga ana e trupave mbikëqyrëse të ILO-s.
- Nuk ka kurrfarë rregullash në lidhje me pranueshmërinë e cilësdo informate. Ajo mirret sipas meritave të saja dhe është në liri të trupit

përkatës që të vendosë. Sidoqoftë, informata e verifikueshme që mundet të vërtetohet nga burime të tjera , p.sh. organizata të të drejtave të njerëzve, gazeta ditore, raporte të KB-së, kryesisht quhen të pranueshme, siç janë të gjitha llojet e dokumenteve zyrtare, si p.sh. kopjet e proces-verbaleve gjyqësore, vendimeve, ligjeve, teksteve legjislative etj.

- Eksperti individual, mandej, përpilon skica konkluzionesh për diskutim nga ana e Komitetit të plotë të Ekspertëve.
- Komiteti i Ekspertëve gjithmonë vepron si një trup dhe anise secili ekspert është përgjegjës për raportim në një numër ose grup të caktuar të Konventave, Komiteti vepron në bazë të principit të unanimitetit dhe konsenzusit (marrëveshjes).
- Komiteti i Ekspertëve i bën komentet e veta si Observime (vrojtime, vëzhgime).

Observimet

- Këto janë në një bazë shtet-pranë-shteti (country-by-country), dhe publikohen në Raportin Vjetor, që organizohet në bazë të numrit të Konventës.
- Observimet përdoren që të tregojnë problemet shumë-vjeçare ose dështimet serioze në zbatimin e Konventave të ILO-s, dhe paraqesin mënyrë se si Komiteti i Ekspertëve kërkon nga një Qeveri që të ndërmer aksion që do të sigurojë zbatimin e plotë të ndonjë Konvente. Ata gjithashtu mund të përdoren për të mirëpritur përparim të arritur si rezultat të komenteve të mëparshme të Komitetit.
- Komiteti i Ekspertëve mund të shtojë një shënim në fund të Observimit për të kërkuar nga ndonjë qeveri që ajo të dorëzojë raportin e ardhshëm - para afatit (d.m.th. jashta ciklit të rregullt të raportimit), ose të paraqitet para Konferencës Ndërkombëtare të Punës.
- Observimet janë efektive në ushtrimin e një shkalle të shtypjes morale dhe shërbejnë për t'u dhënë publicitet situatave specifike. Qeveritë janë përgjithsisht shumë të ndieshme në lidhje me ngritjen e publicitetit të situatës në vendet e tyre. Në këtë mënyrë, Observimet kanë vlerë të vërtetë.
- Nëse ka zhvillime serioze, dhe qeveria nuk i ka ndërmarrë masat e nevojshme për të zgjidhur situatën, Komiteti i Ekspertëve mund ta ftojë qeverinë që t'a shqyrtojë çështjen në Konferencë (shih më poshtë për detale).

Kërkesat Direkte

Komiteti i Ekspertëve, si plotësim të Observimeve, bën gjithashtu edhe kërkesa për informata në hapësira që kanë nevojë për sqarim ose koment, si dhe në pyetje teknike. Ata shpeshherë janë si plotësim i Observimeve, por mund të paraqiten edhe veçmazi.

- Kërkesat Direkte, sikur Observimet, mund të kërkojnë që të u paraqitet ndonjë raport detal.

Kërkesat Direkte nuk publikohen në raportin e Kom.të Ekspertëve⁵² por u dërgohen drejtpërsëdrejti qeverisë/qeverive përkatëse.

- Analizat dhe përfundimet e Komitetit të Ekspertëve publikohen si Raporte Vjetore (Annual Reports)

Raportet Vjetore

Këto botohen si *Zbatim: Konventat Ndërkombëtare të Punës*, (Raporti III [Pjesa 1A]) - e në origjinal - *Application: International Labour Conventions*. Raporti Vjetor i ka dy pjesë:

- Raporti i Përgjithshëm në të cilin ometeti i Ekspertëve i përmbledh (në retrospektivë) pyetjet që kanë të bëjnë me standardet ndërkombëtare të punës dhe zbatimin e tyre.
- Seksioni i dytë - me Observimet ndaj shteteve individuale të marrun vesh me Konventë (sipas datës së pranimit).⁵³

Vështrimet (Analizat) e Përgjithshme

Këto publikohen në Raportin III (Pjesa 1B), i cili është një përmbledhje e raporteve të pranuar në lidhje me Konventat dhe Rekomandimet e parratuara, dhe janë një analizë se si janë futur në përdorim këto, standarde, nga ana e shteteve që i kanë miratuar si dhe ata që nuk i kanë miratuar.

Raporti i Komitetit të Ekspertëve pranohet në fund të sesionit të tij të Nëntorit-Dhjetorit, dhe publikohet në Mars të vitit të ardhshëm, në kohën e mbledhjes pranverore të Trupit Drejtues.⁵⁴

- Konferenca vjetore e ILO-s e merr atë raport në konsiderim në sesionin e vet të Qershorit, dhe diskutimet e tija në raportin e Komitetit të Ekspertëve përfshihen në raportin e tij konferencial.

- ILO u dërgon shteteve anëtare kërkesa për raporte periodike në Shkurt, së bashku me çfarëdo Observimesh ose Kërkesash Direkte nga Komiteti i Ekspertëve.

Kopjet e raportit të Komitetit të Ekspertëve duhen gjithashtu t'u dërgohen organizatave të punëdhënësve dhe sindikatave, që janë përfaqësuese nacionale, dhe kjo duhet të bëhet nga ana e qeverisë së shtetit të përfshirë. Siç u theksua më herët, niveli i pajtueshmërisë për këtë nevojë ndryshon në varësi nga qëndrimi i qeverisë ndaj kësaj gjëje, dhe nivelit të bashkëpunimit me organizatat e punëtorëve dhe të punëdhënësve. Sidoqoftë, qëllimi është që t'i sigurojë këto organizata me një mundësi që t'i kundërshtojnë vlerësimin të qeverisë, dhe të nxjerrin një informatë plotësuese para Komitetit të Ekspertëve që t'i ndihmojnë atij, t'a bëjë vlerësimin e plotë të pjesmarrjes praktike të standardeve ndërkombëtare të punës.

Komentet e organizatave të punëdhënësve dhe të punëtorëve

Organizatat e punëdhënësve dhe të punëtorëve mund të paraqesin raporte mbi zbatimin e ndonjë

Konvente të ILKO-s në çdo kohë, pa marrë parasysh se kur kërkohet raporti mbi atë Konventë, ose se a janë të obliguar ndaj asaj Konvente në atë shtet. Këto njihen si 'komente' (ose 'vërejtje'). Ato patjetër duhen të paraqiten në formë të shkruar, të i referohen një Konvente të miratuar dhe të tregojnë, sa të jetë e mundur më saktë, se si është shkelur ajo. Të gjitha komentet duhen patjetër të dorëzohen drejtpërdrejtë në ILO.

ILO-ja e dërgon nga një kopje të çfarëdo komenti që e ka pranuar, nga ana e organizatave të punëtorëve apo të punëdhënësve, në adresë të qeverisë përkatëse, ashtuqë qeveria të mundet të reagojë ndaj çështjeve të shtruarra në komente.

Duhet theksuar se këto komente mund të paraqiten vetëm nga ana e partnerëve tradicionalë të ILO-s, psh.organizatat e punëdhënësve dhe të punëtorëve. Të gjitha komentet iu dorëzohen Komitetit të Ekspertëve. Në raportin vjetor të vitit 2001, Komiteti i Ekspertëve e theksoi rolin vital të organizatave të punëdhënësve dhe të punëtorëve në zbatimin e standardeve:

*'Në çdo sesion, Komiteti ua tërheq vëmendjen qeverive ndaj rolit që organizatat e punëdhënësve dhe të punëtorëve e kanë zbatimin e Konventave dhe të Rekomandimeve, dhe faktit që Konventa të shumta kanë nevojë për konsultime me organizatat e punëtorëve dhe të punëdhënësve, ose për bashkëpunim me ta në përmasa të ndryshme....Në pajtim me praktikën e vendosur, në Prill të vitit 2000, Zyra u dërgoi organizatave përfaqësuese të punëdhënësve dhe të punëtorëve- një letër, ku përshkruheshin mundësitë e ndryshme që atyre u hapeshin me dhënjen e kontributit ndaj zbatimit të Konventave dhe të Rekomandimeve- të shoqëruar me materiale dokumentare përkatëse;- dhe një listë të raporteve të nevojshme nga qeveritë e tyre përkatëse dhe kopje të komenteve të Komitetit - ndaj të cilave qeveritë ishin ftuar të përgjigjen në raportet e tyre.'*⁵⁵

ILO-ja dëshiron t'a përforcojë rolin e organizatave të punëdhënësve dhe të punëtorëve në punën e vet të mbikëqyrjes dhe prandaj e sheh me pëlqim bashkëveprimin e tyre në këtë proces.

Organizatat e pakicave dhe të vendësve, dhe OJQ-të e tjera të interesuara mund të shfrytëzojnë këtë hapje dhe të dërgojnë informata mbi shkëlqen e Konventave të ILO-s - nëpërmes një organizateje miqësore punëdhënëse ose një sindikati - me kërkesë që ta dorëzojnë këtë dokumentacion në adresë të ILO-s.

Anise komentet mund të dorëzohen në çdo kohë, për të qenë të sigurtë se ata do të mirren në shqyrtim nga ana e Komitetit të Ekspertëve në sesionin e tyre të ardhshëm (Nëntor - Dhjetor), duhet që dorëzimi të kryhet gjer në fund të Shtatorit, nëse kjo nuk është bërë më herët.

Ky është një shembull i mirë se si të sjellim një çështje të posaçme nën vëmendje të trupave mbikëqyrës të ILO-s, dhe ka hyrë në përdorim me efekt të mirë nga ana e organizatave të pakicave dhe të vendësve dhe të OJQ-ve tjera të interesuara që kanë patur dëshirë të tërheqin vëmendjen në një çështje të caktuar.

2.2 Komiteti i Konferencës mbi Zbatimin e Standardeve ë s të këtij raporti

Komiteti i Konferencës mbi zbatimin e Standardeve (Komiteti i Zbatimeve) është një Komitet i Konferencës Ndërkombëtare të Punës. Ai është trepalësh në strukturë, me grupin qeveritar, atë të punëdhënësve dhe atë sindikal, që marrin pjesë aktivisht në Këshillime. Ai takohet njëherë në vit, gjatë Konferencës Ndërkombëtare të Punës në Qershor, dhe shqyrton çështje lidhur me mitatimin dhe zbatimin e Konventave të ILO-s.

Fokusi primar i punës së tij është pasqyra e raportit të Komitetit Ekspertëve. Gjatë analizës së këtij raporti, Komiteti i zbatimeve bën një listë të situatave në shtete që të bëhet një diskutim-në thellësi-gjatë sesionit të tij. Zgjedhja bëhet prej grupit të atyre shteteve që kanë pranuar ndonjë Opservim nga Komiteti i Ekspertëve dhe zakonisht përfshin shkelle të rënda të të drejtave njerëzore dhe/ose ndonjë dështim të përsëritur të veprohet në përputhje me standardet e ILO-s. Përpjekje janë bërë për të siguruar balans të mirë në kushte të shteteve dhe Konventave lidhur me këtë procedurë.

Në praktikë, grupi i punëtorëve është ai që jep propozim për çështjet e diskutimit në Komitetin e zbatimeve, në konsulltim me punëdhënësit. Organizatat e pakicave dhe të vendësve dhe OJQ-të tjera të interesuara mund të orvaten të bëjnë ndikim në sindikatat që të sigurojnë përfshirjen e një shteti të posaçëm në listën e shteteve, të thirret përpara Komitetit të Zbatimeve, të sigurojë që shteti për pyetje të ketë pranuar një Observim prej Komitetit të Ekspertëve

Metodat e punës

Sa i takon raportit të Komitetit të Ekspertëve, menjëherë posa të jetë caktuar lista e shteteve ndërmerren këto veprime:

- Komiteti i Zbatimeve e fton qeverin në pyetje, të paraqitet përpara tij që të prezentojë kuptueshmërinë e situatës. Rrallëherë mund të ndodhë një qeveri të refuzojë, sidomos ngase ftesa bëhet në frymë të dialogut dhe bashkëpunimit, element kyç i ILO-s.
- Pasiqë qeveria të ketë prezentuar kuptueshmërinë e situatës, hapet diskutimi dhe anëtarë individualë të Komitetit të Zbatimeve janë të lirë të ofrojnë komentet e tyre, kritikën dhe sugjerimet. Përfaqësuesit e organizatave të punëtorëve dhe të punëdhënësve, si edhe

delegatët e qeverisë mund t'i parashtojnë pyetjet e veta drejtpërdrejtë qeverisë përkatëse.

- Përfaqësuesi i qeverisë e ka të drejtën t'i përgjigjet cilëndo pyetje apo komenti. Pasi të kryhet kjo, zëdhënësit e punëdhënësve dhe të sindikatave, të dy, i bëjnë vërejtjet e tyre përfunduese (zakonisht qeveritë nuk e bëjnë këtë).

- Shqyrtimet e Komitetit të Zbatimeve janë të fokusuar në mënyrë ekstreme. Ky proces shërben për të tërhequr vëmendjen në rastet specifike të mospajtimit me ndonjë Konventë.

- Sesionet e Komitetit të Zbatimeve janë zakonisht të hapura për publikun;

- Komiteti shërben për të ushtruar shtypje në qeverinë përkatëse pasi që ajo duhet që të përgjigjet publikisht në kritika nga të dy anët - organizatat kombëtare dhe ndërkombëtare.

- Diskutimet zakonisht janë të gjalla, dhe janë të përfshira brenda një fryme të dialogut dhe bashkëpunimit.

- Kryetari i Komitetit të Zbatimeve, sipas traditës - një përfaqësues qeveritar, e përmbledh diskutimin në Konkluzione dhe Rekomandime të cilat janë miratuar nga Komiteti i Zbatimeve.

- Në rastet më të këqia të mospajtimit me Konventën, Komiteti mund të vendosë që t'a përfshijë rastin në një 'paragraf special' në raportin e vet, dhe /ose të raportin e vet, dhe /ose të paraqesë se për zbatimin e një Konvente ka patur 'dështim të vazhdueshëm':

- Këto janë cenzurat më të forta të Komitetit të Zbatimeve dhe tërheqin vëmendjen ndërkombëtare ndaj dështimit të qeverisë që të i respektojë standardet e punës, të pranuar në mënyrë ndërkombëtare.

- Qeveritë që pranojnë vendim si 'paragraf special' dhe/ose 'dështim të vazhdueshëm', kanë gjasa që në vitin e ardhshëm, përsëri të thirren përpara Komitetit të Zbatimeve.

- Shqyrtimet e Komitetit të Zbatimeve publikohen si një raport dy-pjesësh:- pjesa e parë është një raport i përgjithshëm, ndërsa pjesa e dytë përmban Observimet dhe informim në lidhje me shtetet e posaçme, duke përfshirë edhe raportin detal të diskutimit në Komitet.

- Raporti mandej i dorëzohet Konferencës së plotë Ndërkombëtare të Punës ku ai diskutohet në sesionet plenare përpara se ai të miratohet.

- Raporti final iu përcillet Komitetit të Ekspertëve në sesionin e tyre të ardhshëm. Komiteti i Ekspertëve mandej e vazhdon punën e tij në monitorim (vëzhgim) të përpjekjeve të qeverisë përkatëse për zbatim më të mirë të Konventës përkatëse, duke përfshirë, në zbatim, edhe Rekomandimet dhe sugjerimet e Komitetit të Zbatimeve (si që u përmend më lartë).

Në këtë mënyrë, pajtueshmëria e një vendi me një Konventë të posaçme të ILO-s inspektohet në mënyrë të rreptënga ana e trupave mbikëqyrëse të ILO-s.

Komiteti i Ekspertëve është i njohur për ëmbëngulësinë e tij në tërheqjen e qëndrueshme të vëmendjes ndaj rasteve specifike të mospajtueshmërisë së standardet ndërkombëtare të punës, dhe për vazhdimësinë që një çështje specifike ta theksojë përpara një qeverie përkatëse gjer sa ajo yë zgjidhet në mënyrë të kënaqshme.


Shteti në fjalë mund të ndeshet edhe me kritikë të fortë nga ana e Komitetit të Zbatimeve.

Të dy Komitetet veprojnë në mënyrë të pavarur, por në mënyrë plotësuese, duke ndjekur punën e njëri tjetrit me qëllim të sigurimit të imponimit më të

madh të standardeve të ILO-s.

Duke ndjekur pranimin e raportit nga ana e Konferencës Ndërkombëtare të Punës, ai i dorëzohet Komitetit të Ekspertëve për t'u vazhduar. Komiteti i Ekspertëve vazhdon t'a shqyrtojë çështjen dhe të jep komente gjer sa qeveria përkatëse t'i plotësojë, në mënyrë të kënaqshme, obligimet e saja në lidhje me Konventën në fjalë.

Kur një qeveri nuk e paraqet një raport para trupave mbikëqyrëse të ILO-s, si që nevojitet në bazë të obligimeve raportuese, Komiteti i Ekspertëve i përsërit komentet e mëparshme. Një listë e qeverive



që kanë dështuar në paraqitje të raporteve, gjendet në Raportin Vjetor të Komitetit të Ekspertëve. Kjo është një mënyrë e tërheqjes së vëmendjes publike ndaj këtyre qeverive. Komiteti i Ekspertëve mundet gjithashtu të vendosë të shqyrtojë situatën në bazë të informatave që i ka në disponim, sidomos në rast të refuzimeve të përsëritura të u përgjigjen komenteve të dërguara nga trupat mbikëqyrës.

3. Ndihma teknike

ILO-ja ofron ndihmën e saj shteteve anëtare që të arrihet një zbatim sa më i plotë i standardeve ndërkombëtare të punës. Kjo gjë mund të bëhet në këta forma:

- **Kooperim teknik** - Atje ku ekziston një problem i vazhdueshëm, ose qeveria bën të ditur se mund të ketë nevojë për ndihmë - ILO-ja u ofron ndihmën e saj teknike. Ajo zhvillon programe, posaçërisht të dizajnuara t'u ndihmojnë qeverive individuale që t'a përshtasin ligjin e tyre nacional dhe praktikën- në pajtim me standardet ndërkombëtare. Ekziston një mori programesh të ndihmës teknike prej të cilave më të dalluara janë: Programi Ndërkombëtar për Eliminimin e Punës së Fëmijëve (IPEC) dhe Programi për Përkrahje Gjinore.

- **Trajnimi** - ILO-ja poashtu ofron një varg seminaresh dhe formash tjera të trajnimit në lidhje me standardet ndërkombëtare të punës. Për shembull, në 1999 në Harare të Zimbabves u mbajt një seminar sub-regjional për punëtorët e gjykatës, mbi barabarësinë në punësim; në Rabat të Marokos u mbajt një seminar nacional - trepalësh - mbi lirinë e asocimit (shoqërim); dhe në Turin, Itali, u mbajt një seminar për juristët dhe edukatorët legalë në lidhje me standardet ndërkombëtare të punës.⁵⁶

Aktivitetet për përparim - ILO-ja poashtu ndërmerr një numër aktivitete të dizajnuara për të ngritur vetëdijen mbi rëndësinë e punës së saj dhe të standardeve ndërkombëtare të punës. Për shembull, një kampanjë për të nxitur të gjitha anëtarët e ILO-s që t'i miratojnë Konventat fundamentale, ka qenë në veprim që nga 1995.

VI. Ankesat

1. Procedura kushtetuese

Përveç kontrollimit të përljes me anë të sistemit të rregullt të mbikëqyrjes, ekzistojnë edhe dy rrugë për ankesat, që ata të dërgohen në ILO. Ata mbahen në Kushtetutën e ILO-s dhe përdoren vetëm për raste serioze të mosbindjes:

- Paraqitjet (Ankesat) nën Artikullin 24 të Kushtetutës;
- Ankesat nën Artikullin 26 të Kushtetutës.

Këto dy procedura janë mënyrë tjetër e tërheqjes së vëmendjes kah shkeljet e Konventave të ILO-s, si formë e shtypjes ndaj një qeverie që ta sjell ligjin kombëtar dhe praktikën në një përshtatshmëri më të madhe me standardet ndërkombëtare. Kështu, organizatat e pakicave dhe të vendësve, dhe OJQ-të e tjera të interesuara, duhet ta marrin këtë në konsiderim në punën e tyre për të siguruar mbrojtje të pakicave dhe të njerëzve vendës.

1.1 Procedura e paraqitjes (ankesës) - (Artikulli 24)

Kjo procedurë është përshkruar në Artikullin 24 dhe 25 të Kushtetutës së ILO-s;

Artikulli 24

“Në rast të ndonjë paraqitjeje të bërë në Zyrën Ndërkombëtare të Punës (ILO - International Labour Office) nga ana e ndonjë bashkësie (asociacioni) industriale të punëdhënësve ose të punëtorëve, se cilido nga anëtarët ka dështuar të sigurojë, në çfarëdo pikpamje, zbatimin efektiv - brenda jurisprudencës së vet të cilësdo Konvente, ndaj së cilës është anëtar, Trupi Drejtues mundet ta përcjellë këtë paraqitje, qeverisë, kundër së cilës ajo është bërë, dhe mundet ta thërret qeverinë që ajo të bëjë një deklaratë, lidhur me çështjen gjersa ai ta konsiderojë atë si të kënaqshme.”

Artikulli 25

“ Nëse brenda afatit të arsyeshëm, nga qeveria në fjalë nuk është pranuar kurrfarë deklaratë, ose nëse deklarata e arritur nuk është konsideruar si e kënaqshme nga ana e Trupit Drejtues, ky i fundit do t'a ketë të drejtën ta publikojë paraqitjen dhe Deklaratën, po qe se të tillë ka, të bërë si përgjigje ndaj saj”.

Qe një pasqyrë të procedurës:

- Paraqitja (ankesa) është një refuzim (dështim) nga një shtet-anëtar t'i zbatojë kushtet e një Konvente të cilën e ka miratue zyrtarisht.
- Menjëherë posa që ILO ta pranojë ndonjë paraqitje, Drejtoria e Përgjithshme e vërteton pranimin e saj dhe ia bën të ditur qeverisë përkatëse duke i dorëzuar asaj një kopje.

Paraqitja mandej përcillet në Trupin Drejtues. Trupi Drejtues vendos se a është paraqitja 'e pranueshme' ose jo (shih kutinë më poshtë). Ai nuk e analizon temën e paraqitjes në këtë nivel (shkallë).

Elementet themelore që një paraqitje duhet t'i ketë për të arritur në ILO:

- Të jetë në lidhje me Konventën e miratuar nga ana e shtetit anëtar të përfshirë;
- Të jetë i përlur/nënshtruar ndaj ILO-s;
- Të jetë prej ndonjë organizate të punëdhënësve ose të punëtorëve;
- Të ketë të bëjë me ndonjë shtet-anëtar të ILO-s;
- Të jetë në formë të shkruar;
- Ai duhet patjetër të bëjë të ditur mjaft qartë se si dhe në çfarë mënyre, shteti anëtar ka dështue t' i zbatojë kushtet e Konventës specifike;
- Të i bëjë referencë të posaçme Artikullit 24 të Kushtetutës (ta përmendë atë).

- Nëqoftëse Trupi Drejtues është i kënaqur ngase paraqitja është dorëzue në mënyrë të rregullt, dmth. ai i plotëson kërkesat e sipërpërmendura, ai formon një komitet trepalësh për ta shqyrtuar çështjen. Sidoqoftë, nëse ajo i takon të drejtave të sindikatave, atëherë ai e paraqet atë në Komitetin mbi Lirinë e Asocimit (shih më vonë).
- Komiteti trepalësh përbëhet prej tre anëtarëve të trupit drejtues, nga një prej secilit grup: atij të punëtorëve, të punëdhënësve dhe të qeverisë. Ai mund të kërkojë informata plotësuese nga qeveria e përfshirë në çështjen ose nga organizata që e sjell paraqitjen.
- Qeveria në fjalë e ka mundësinë të kërkojë që një përfaqësues i Drejtorisë së Përgjithshme ta vizitojë vendin e tyre që të mbledhë më tepër informata. Këto vizita gjithashtu sigurojnë mundësi për OJQ-të në vend që të takohen me Komitetin trepalësh dhe t'i furnizojnë Komitetet trepalëshe me më tepër informata nëpërmjet të përfaqësuesit të tyre.
- Komiteti trepalësh ia dorëzon raportin e vet Trupit Drejtues, duke ua bërë të njohur shkallët e ndërmarra për të shqyrtuar paraqitjen, përfundimet (e tyre) dhe Rekomandimet.
- Trupi Drejtues e shqyrton dhe e pranon raportin e Komitetit trepalësh në sesionin e vet të ardhshëm. Qeveria e përfshirë thirret që të dërgojë një përfaqësues që të merr pjesë në këtë sesion. Organizata e punëdhënësve ose punëtorëve, që ka paraqitur atë paraqitje, nuk ftohet të paraqitet përpara Komitetit.
- Trupi Drejtues vendos gjithashtu se a duhet publikuar paraqitja si dhe ndonjë përgjigje e marrur prej qeverisë, dhe e njofton organizatën dhe qeverinë në fjalë për vendimin e marrur. Në përgjithsi, shumica e paraqitjeve publikohen dhe kopje nga ata janë në disponim në website - 26

faqeja e ILO-s.⁵⁷

- Posaqë Komiteti trepalësh ta përfundon punën e tij, Komiteti i Ekspertëve vazhdon me Konkludime dhe Rekomandime.
- Gjersa një paraqitje është në vazhdim, puna e rregullt në mbikëqyrje të zbatimit të kësaj Konvente të veçantë në shtetin në fjalë është e pezulluar, së paku në lidhje me pyetjen që shqyrtohet në paraqitjen.
- Posaqë të kompletohet procedura lidhur me Artikullin 24, trupat mbikëqyrës të rregullt e

rivazhdojnë punën e tyre.

Paraqitjet në bazë të artikullit 24 janë dorëzue (sjellë) kundër një numri të shteteve. Një listë e pjesëshme për vitin 2001 përfshin:⁵⁸

Të quajtura si të pranueshme:

- **Konventa Nr.169** mbi Njerëzit Vendës dhe Fisnor (1989).
- (i) Kollumbi-sjellur nga ana e Central Unitary Workers' Union (CUT) dhe Colombian Medical Trade Union Association (ASMEDAS);

Diagrami i procedurës së paraqitjes sipas Artikullit 24

Organizatrat e punëdhënësve dhe/ose të punëtorëve i dorëzojnë paraqitjet e veta në adresë të ILO-s; ILO-ja e vërteton pranimin, e informon qeverinë e përfshirë dhe e sjell çështjen /temën përpara Trupit Drejtues

Nëse paraqitja tërheq (pas veti) statusin 'Liri e Asociimit', ajo iu referohet Komitetit (të Trupit Drejtues) mbi Lirinë e Asociimit.

Zyra ndërkombëtare e Punëtare e Punës

Trupi Drejtues

Komiteti mbi Lirinë e Asociacionit

Nëse paraqitja i plotëson kriteret, Trupi Drejtues krijon një Komitet për të shqyrtuar çështjen

Komiteti Trepalësh

Komiteti trepalësh e shqyrton paraqitjen

Qeveria e përfshirë mund të kontaktohet

Qeveria e përfshirë

Trupi Drejtues

Trupi Drejtues e merr në konsiderim privatisht (jo-zyrtarisht) raportin e Komitetit të tij trepalësh. Qeveria e përfshirë thirret që të dërgojë një përfaqësues.

Trupi Drejtues mund të vendosë se a do të publikojë paraqitjen, apo jo.

Publikimi

Ai mundet poashtu të vendosë që të nisë ankesë nën artikujt 26 - 34 të Kushtetutës së ILO-s

Ankesa sipas Artikullit 26

Komiteti i Ekspertëve vazhdon me zbatimin e raportit të komitetit trepalësh, pasi që të pranohet nga Trupi Drejtues.

Komiteti i Ekspertëve mbi Zbatimin e Konventave dhe Rekomandimeve

- (ii) Danimarkë- sjellur nga Sulinermik Inuusutissarsieuteqartut Kattuffiat (SIK); dhe
- (iii) Ekuador - sjellur nga Ecuadorian Confederation of Free Trade Union Organizations (CEOSL).

Të pazgjidhura:

- Konventa Nr.29 mbi Punën e detirymshme 1930;
- Zelanda e Re-sjellur nga New Zealand Trade Union Federation (Federata e Sindikatave të Zelandës së Re).
- Konventa Nr.111 mbi Diskriminimin (në punësim dhe punë) (1958) dhe Konventa Nr.158 mbi Përfundimin e Punës/Punësimit (1982).
- Etiopi - sjellur nga National Confederation of Eritrean Workers (NCEW); (Konfederata Nacionale e Punëtorëve të Eritresë).
- Konventa Nr.169
- (i) Kollumbi - sjellur nga Central Unitary Workers' Union (CUT), dhe
- (ii) Peru -sjellur nga General Confederation of Workers of Peru (CGTP).

Efekti i procedurës së paraqitjes është se ajo e vë në qendër të vëmendjes dështimin e qeverisë për të zbatuar një Konventë ndaj së cilës është anëtarësuar. Në disa raste kjo gjë është e mjaftueshme për ta nxitë një qeveri që të ndërmerr akcion të nevojshëm.

Sidoqoftë atje ku qeveria e përfshirë refuzon të zbatojë rekomandimet e komitetit trepalësh, Trupi Drejtues mund të vendosë të nisë procedurën e parashikuar të ankesës nën Artikullin 26 të Kushtetutës së ILO-s. (shih më poshtë ankesat në lidhje me të). Kjo mundësi mund të vazhdohet në çfarëdo kohe gjatë procedurës së paraqitjes.

1.2 Procedura e Ankesave (artikulli 26)

Një ankesë mund të shtrohet në bazë të artikullit të Kushtetutës së ILO-s:

Artikulli 26

‘1. Secili nga Anëtarët do ta ketë të drejtën ta shtrojë një ankesë në Zyrën Ndërkombëtare të Punës nëqoftëse ai nuk është i kënaqur ngase cilido anëtarë tjetër siguron përmbajtje efektive ndaj cilëndo Konventë të cilën të dy e kanë pasë miratuar’. Kjo procedurë nisët në këtë mënyrë:

- Një ankesë e vendosur në dosje nën

‘Drejtorja e Përgjithshme’ (Director- General) pohon se një shtet anëtarë nuk po i përmbush obligimet e tija lidhur me ndonjë Konventë që ai e ka miratuar.

- Ajo mund të jetë e dhënë nga :
- Ndonjë delegat i punëdhënësve ose i sindikatave - dërguar në Konferencën Ndërkombëtare të Punës (çdo vit në Qershor);
- Një qeveri tjetër që gjithashtu e ka miratuar të njejtën Konventë;
- Trupi drejtues.
- Posa që të jetë pranuar ankesa, Trupi Drejtues e ka mundësinë që të komunikojë me qeverinë që është përfshirë ose ai mundet drejtpërdrejtë të caktojë një Komision për Hetime.
- Komisioni i Hetimeve ndërmerr hetime mbi lëndën.Për këtë veprim nuk ka periudhë të fiksuar kohore dhe çdo komision zgjedh rregulla të veta në këtë procedurë.
- Sindikatat dhe OJQ-të mund t’i paraqesin opservimet dhe raportet e tyre drejtpërdrejtë Komisionit të Hetimeve.
- Posaqë Komisioni i Hetimeve ta përfundon punën e tij, ai e dorëzon raportin Trupit Drejtues si dhe palëve të përfshira në të. Raporti përmban përfundime dhe rekomandime dhe ai mundet të publikohet.
- Nëse një qeveri i pranon Rekomandimet e Komisionit por nuk i zbaton ato brenda kohës së caktuar, Trupi Drejtues mund të sugjerojë që Konferenca Ndërkombëtare e Punës të ndërmerr akcion të nevojshëm për të siguruar lëshim pe (psh.suspendim nga anëtarësia e ILO-s dhe nga aktivitetet e ndihmës teknike).
- Nëse një qeveri nuk i pranon Rekomandimet, opcioni i saj i vetëm është që ta paraqes ankesën në Gjygin Ndërkombëtar të Drejtësisë. Ky gjygj është autoriteti i vetëm kompetent, i cili mund t’i inspektojë (rishikojë) standardet e ILO-s dhe vendimet e ILO-s. Vendimi i tij është përfundimtar.
- Një qeveri që akuzohet për mosplotësim mundet poashtu ta informojë Trupin Drejtues se ajo i ka zbatuar Rekomandimet dhe të kërkojë nga Trupi Drejtues që të caktojë një komision të ri të Hetimeve që ta vërtetojë këtë deklaratë. Nëse raporti i Komisionit të ri të Hetimeve gjen fakte në dobi të qeverisë së akuzuar, Trupi Drejtues do të rekomandojë që të suspendohet çfarëdo aksioni i ndërmarrur nga Konferenca Ndërkombëtare e Punës (Artikulli 34 i Kushtetutës së ILO-s).

2. Procedurat speciale për ankesat në lidhje me Lirinë e Asocimit⁵⁹

Pasiqë e drejta për të organizuar është pikë qendrore për ILO-n, për ta mbrojtë këtë të drejtë janë themeluar edhe mekanizma, pa marrë parasysh se a kanë qenë të miratuara Konventa të caktuara apo jo. ILO-ja ka dy komitete që i shqyrtojnë ankesat që kanë të bëjnë me lirinë e

asocimit:

- Komiteti i Trupit Drejtues në lidhje me Lirinë e Asocimit;
- Komisioni Gjurmues dhe Pajtuës në lidhje me Lirinë e Asocimit.

2.1 Komiteti i Trupit Drejtues në lidhje me Lirinë e Asocimit

Një ankesë mund të regjistrohet në këtë Komitet

Diagrami i procedurës së ankesave

Një shtet tjetër - anëtar, një delegat i Konferencës Ndërkombëtare të Punës ose Trupi Drejtues - mund të paraqesin një ankesë;

Trupi Drejtues vendos se a duhet të caktohet Komisioni i Hetimeve;

Nëse ankesa tërheq Liri të Asocimit, ajo mund t'i referohet Komitetit të Trupit Drejtues për Liri të Asocimit

Komiteti mbi Lirinë e Asocimit

Qeveira në jalë mund të vizitohet

Qeveria e përfshirë


Komisioni i Hetimeve i raporton faktet e gjetura, jep Rekomandime dhe një afat kohor për t'u zbatuar ato.

Raporti i dërgohet qeverisë së përfshirë, ai publikohet, dhe i transmetohet Trupit Drejtues që të merr shënim.

Qeveria e përfshirë

GjND

Qeveria e përfshirë mund ta referojë ankesën Gjyqit Ndërkombëtar të Drejtësisë për një vendim përfundimtar.



Trupi drejtues

Komisioni i Hetimeve

Komisioni i pavarur i Hetimeve e shqyrton tërësisht ankesën, duke i përcaktuar procedurat e saja ashtu si që nevojitet nga rasti.

Raporti

Trupi drejtues

Komiteti i Ekspertëve mbi Zbatimin e Konventave dhe Rekomandimeve

Komiteti i Ekspertëve e vazhdon procesin e zbatimit të Rekomandimeve të Komisionit të Hetimeve.

pa marë parasysh se a i ka miratuar, shteti gjegjës, Konventat e ILO-s që kanë të bëjnë me Lirinë e Asocimit.

Vetëm në vazhdim ka ndryshim në qasje, siç është sqaruar me detale më poshtë.

Komiteti është themeluar nga Trupi Drejtues në Nëntor 1951. Ai është një trup trepalësh me nëntë antarë (nga tre prej grupeve qeveritare, të punëdhënësve dhe të punëtorëve) dhe një ose nga ana e qeverisë dhe zakonisht shërben për ta thyer situatën pezull. Komiteti i Ekspertëve mundet gjithashtu të sugjerojë vizitë të Kontakteve Direkte.

- Ajo mund të realizohet vetëm në bashkëpunim të, dhe sipas ftesës së Qeverisë së përfshirë. Kjo ofron mundësi për t'u mbajtur diskutime konstruktive, në vendin e përfshirë me udhëheqës i pavarur. Ankesat mund t'u paraqiten nga organizatat e punëdhënësve ose të sindikatave (kombëtare ose ndërkombëtare), ose nga qeveritë (kjo gjë ngjet rrallë)

Komiteti takohen në Gjenevë tre herë në vit. Ankesat duhen të jenë të shkruara, të nënshkruara dhe të dorëzuara me evidencë. Qeveria e përfshirë është e garantuar me mundësi për të reaguuar dhe, në raste urgjente ose serioze Drejtoria e Përgjithshme mund ta lusë qeverinë që të lejojë hetime në moment, për t'i ndihmuar Komitetit në punën e tij.

Kur Komiteti ta të ketë kompletuar shqyrtimin e vet të çështjes, nëse qeveria në fjalë i ka miratuar Konventat e ILO-s, atëherë trupat e rregullt mbikëqyrës të ILO-s (të quajtura Komiteti i Ekspertëve) vijnë në atë rast.

Nëse Qeveria nuk i ka miratuar Konventat, atëherë Drejtoria e Përgjithshme e ka përgjegjësinë që të vijojë me qeverinë e përfshirë, në intervale të rregullta.

Sipas raportit të Qershorit, 2001, Komiteti mbi Lirinë e Asocimit ka patur 56 raste kundër qeverive në të kaluarën. Këto i kaplonin shtetet në vijim: Australia, Bangladeshi, Bugaria, Kanadaja, Kameruni, Kosta Rika, El Salvadori, Gaboni, Indonezia, Republika e Koresë, Japonia, Pakistani, Peru-ja, Filipinet, Nepali, Spanja, Libani, Tajlanda, Turqia, dhe Ukraina.

Si shtesë, kishte edhe raste 'serioze dhe urgjente' që kanë qenë në lidhje me Etiopinë (rasti Nr, 1888), Haitin (rasti Nr.2052) dhe Venecuelën (rastet Nr.2067 dhe 2088).⁶⁰

2.2 Komisioni Gjurmues dhe Pajtuës në lidhje me Lirinë e Asocimit

Komisioni punon në grupe prej tre anëtarëve që janë të kualifikuar lartë, të pavarur, të caktuar nga Trupi Drejtues i ILO-s. Ai është në radhë të parë një trup gjurmues. Raportet e tija publikohen. Si rregullë e përgjithshme, qeveria e përfshirë duhet patjetër të pajtohet para se një ankesë të mund t'i dorëzohet këtij komisioni (për dallim prej Komitetit mbi Lirinë e Asocimit ku kjo gjë nuk është e domosdoshme). Si rezultat komisioni mbledhet rrallë.

Komisioni mund t'i shqyrtojë ankesat e paraqitura asaj nga Trupi Drejtues i shteteve përkatëse që nuk i kanë miratuar Konventat përkatëse ose në kërkesë të Këshillit Ekonomik dhe Social të KB-së, edhe në rast se shteti i përfshirë nuk është anëtar i ILO-s.

3. Kontaktet Direkte (K. e drejtpërdrejta)

Në 1964 u miratua një procedurë speciale nëpërmes së cilës një shtet mund ta ftojë një përfaqësues të Drejtorisë së Përgjithshme që ta vizitojë shtetin. Kjo njihet si "Kontakte Direkte" (të drejtpërdrejta) dhe Drejtoria e Përgjithshme e cakton përfaqësuesin. Përfaqësuesi mund të jetë një zyrtar i ILO-s ose ndonjë person i pavarur.

- Vizita e Kontakteve Direkte përgjithësisht ndodh kur nuk ka përparim të dukshëm në ndonjë çështje që rishqyrtohet nga trupat mbikëqyrës të ILO-s. Ajo mund t'i propozohet Komitetit të Aplikacioneve (kërkesave, lutjeve) nga ana e delegatëve të sindikatave ose të punëdhënësve, ose nga ana e qeverisë dhe zakonisht shërben për ta thyer situatën pezull. Komiteti i Ekspertëve mundet gjithashtu të sugjerojë vizitë të Kontakteve Direkte.

- Ajo mund të realizohet vetëm në bashkëpunim të, dhe sipas ftesës së Qeverisë së përfshirë. Kjo ofron mundësi për t'u mbajtur diskutime konstruktive, në vendin e përfshirë me agjencionet relevante qeveritare dhe me partnerët trepalësh.

- Nëse ndodh që një qeveri të refuzojë vizitën e Kontakteve Direkte, kjo gjë në përgjithësi tërheq ende më tepër vëmendjen në mungesën e bashkëpunimit të saj me ILO-n dhe refuzimin e vullnetit për të respektuar një standard të posaçëm të punës, duke shkaktuar kështu kritikim më intenziv. Për shembull, në Qershor 2000 dhe Qershor 2001, anëtarët e Komitetit të Aplikacioneve sugjeruan fortë që një vizitë e Kontakteve Direkte të gjurmohet raportet e rrëmbimeve me forcë dhe të skllavërisë në Sudan, dhe të vlerësojë se çfarë lloj ndihme do të mundej t'i ofrojë qeverisë. Pasiqë qeveria nuk e pranoi vizitën, përfundimet e Komitetit u vendosën nën "paragraf special".

- Përparia e vizitës së Kontakteve Direkte është se kjo zakonisht çon nga dialogu konstruktiv ndërmjet ILO-s dhe qeverisë në zgjidhje praktike të problemit.

· Kur nuk vërehet përparim i dukshëm si rezultat i vizitës së Kontakteve Direkte, atëherë autoriteti i ILO-s mund të përdoret për të paraqitur vërejtje lidhur me situatën e posaçme dhe të kritikojë qeverinë e përfshirë. Kjo ndihmon që të mbahet shtypja politike ndaj qeverisë së përfshirë, që t'i sjellë ligjet e saja dhe praktikën në pajtueshmëri me standardet ndërkombëtare të punës. Për shembull, kur qeveria e Bangladeshit u ftua që të paraqitet para mbledhjes së Komitetit të Aplikacioneve që duhej të mbahej në Qershor

1985, për të diskutuar raportet e shkeljeve të mëdha të të drejtave njerëzore të njerëzve vendës në provincën Çitagong Hill -bazuar në Konventën Nr.107 mbi njerëzit vendës dhe fisnorë (1957) - Qeveria e Bangladeshit kërkoi 'Kontakte Direkte' (për detale vijuese shih në kapitullin VII). agjencionet relevante qeveritare dhe me partnerët trepalësh.

- Nëse ndodh që një qeveri të refuzojë vizitën e Kontakteve Direkte, kjo gjë në përgjithësi tërheq ende më tepër vëmendjen në mungesën e bashkëpunimit të saj me ILO-n dhe refuzimin e vullnetit për të respektuar një standard të posaçëm të punës, duke shkaktuar kështu kritikim më intenziv. Për shembull, në Qershor 2000 dhe Qershor 2001, anëtarët e Komitetit të Aplikacioneve sugjeruan fortë që një vizitë e Kontakteve Direkte të gjurmojë raportet e rrëmbimeve me forcë dhe të skllavërisë në Sudan, dhe të vlerësojë se çfarë lloj ndihme do të mundej t'i ofrojë qeverisë. Pasiqë qeveria nuk e pranoi vizitën, përfundimet e Komitetit u vendosën nën "paragraf special".

- Përparsia e vizitës së Kontakteve Direkte është se kjo zakonisht çon nga dialogu konstruktiv ndërmjet ILO-s dhe qeverisë në zgjidhje praktike të problemit.

- Kur nuk vërehet përparim i dukshëm si rezultat i vizitës së Kontakteve Direkte, atëherë autoriteti i ILO-s mund të përdoret për të paraqitur vërejtje lidhur me situatën e posaçme dhe të kritikojë qeverinë e përfshirë. Kjo ndihmon që të mbahet shtypja politike ndaj qeverisë së përfshirë, që t'i sjellë ligjet e saja dhe praktikën në pajtueshmëri me standardet ndërkombëtare të punës. Për shembull, kur qeveria e Bangladeshit u ftua që të paraqitet para mbledhjes së Komitetit të Aplikacioneve që duhej të mbahej në Qershor 1985, për të diskutuar raportet e shkeljeve të mëdha të të drejtave njerëzore të njerëzve vendës në provincën Çitagong Hill -bazuar në Konventën Nr.107 mbi njerëzit vendës dhe fisnorë (1957) - Qeveria e Bangladeshit kërkoi 'Kontakte Direkte' (për detale vijuese shih në kapitullin VII).

VI. Studimet e rasteve

1. Hyrje

Kjo pjesë e Doracakut përshkruan se si e bën ILO-ja mbikëqyrjen e Konventave të saja, duke ofruar studime të rasteve të veçanta si shembuj.

Studimet e rasteve poashtu mundet të ilustronë se si mundet të drejtohet/tërhiqet vëmendja ndërkombëtare që të dëshmojë mbi shkeljen e Konventave ndërkombëtare dhe se si ndikon kjo në rritjen e shtypjes ndaj qeverive që ato t'i zbatojnë obligimet e tyre ndaj banorëve, duke përfshirë këtu edhe pakicat dhe njerëzit vendës. Studimet e rasteve poashtu demonstrojnë se si sindikatat, OJQ-të dhe organizatat tjera që punojnë me pakicat dhe njerëzit vendës-mund t'i përdorin sistemet e të drejtave njerëzore.

Vërejtje: ILO-ja nuk ka kurrfarë autoriteti ndëshkimor përtej cenzurimit të një shteti anëtar në rast të mosplotësimit të obligimeve të tija. Ajo është organizatë interqeveritare dhe, anise organizatat e punëtorëve dhe të punëdhënësve kanë pozitë në ILO, ajo është me peshë në favor të qeverive. Qeveritë kanë nga dy vota, kundrejt punëdhënësve dhe punëtorëve që kanë nga një votë.

Forca e ILO-s qëndron në mundësinë që t'i qortojë qeveritë për shkeljen e direktivave dhe principeve univerzale të cilat ata janë pajtuar vullnetarisht t'i mbrojnë. Ky veprim mund të realizohet me anë të publikimit se si shtetet anëtare i kryejnë këta përgjegjësi me anë të raporteve dhe publikimeve tjera; dhe /ose me thirrjen e qeverive të paraqiten përpara Komitetit të Aplikacioneve për diskutim publik mbi ndonjë çështje.

Për një kohë të gjatë këto procese ndihmojnë në shtimin e vëmendjes duke qenë të fokusuar në të drejtat njerëzore të pakicave dhe të njerëzve vendës.

2. Burma (Myanmar)

Që nga viti 1955, kur Burma e miratoi Konventën mbi Punën e Detyrimshme (1930) (Nr.29), trupat mbikëqyrës të ILO-s e kanë pasë kontrolluar punën e detyrimshme në Burmë. Që nga 1964, Komiteti i Ekspertëve filloi të pyesë për informata plotësuese në këtë temë. Në kohëra të fundit, eksploatimi i hamallëve nga forcat e armatosura ka qenë shkak që rezultuar në kritika më të ashpra. Pakicat dhe njerëzit vendës poashtu janë shfrytëzuar si punëtorë - argatë nga ana e armatës. Studimi i këtij rasti shtjellon diskriminimin, punën e detyrimshme dhe pakicat dhe njerëzit vendës.

- Artikulli 24, procedura e paraqitjes :
- Në Janar 1993, Konfederata Ndërkombëtare e Sindikatave të Lira (International Confederation

of Free Trade Unions - ICFTU) paraqiti një ankesë sipas Artikullit 24 kundër Burmës për shkak të mos-zbatimit të Konventës Nr.29 mbi Punën e Detyrimshme.

- Një Komitet trepalësh i formuar për të shqyrtuar ankesën e përfundoi punën e tij në Nëntor 1994 dhe ia dorëzoi raportin e vet Trupit Drejtues.

- Trupi Drejtues i pranoi (miratoi) Rekomandimet e Komitetit më 7 Nëntor 1994 dhe kërkoi nga Qeveria ta informojë Komitetin e Ekspertëve mbi masat që ajo i ka ndërmarrë të veprojnë në përputhje me Rekomandimet e Komitetit trepalësh.

- Në Shkurt 1995, Komiteti i Ekspertëve bëri një observim duke shënuar se ai nuk ka pranuar kurrfarë informate nga qeveria. Në Konferencën Ndërkombëtare të Punës në Qershor të 1995, Komiteti i Aplikacioneve pranoi një 'paragraf special', duke kërkuar nga Qeveria të veprojnë në përputhje me Rekomandimet e komitetit trepalësh dhe të raportojë në Komitetin e Ekspertëve në Nëntor të atij viti. Qeveria nuk bëri kështu.

- Në Qershor 1996, 25 delegatë të punëtorëve në Konferencën Ndërkombëtare të Punës e dorëzuan një ankesë kundër qeverisë mbështetur në artikullin 26 të Kushtetutës së ILO-s.⁶¹

- Procedura e ankesës në bazë të Artikullit 26 :
 - Trupi Drejtues ia dërgoi ankesën Qeverisë, e cila e dërgoi përgjigjen (reagimin) në Shkurt 1997. Trupi Drejtues nuk e vlerësoi përgjigjen si të kënaqshme dhe formoi një Komision për Hetime.

- Komisioni i Hetimeve e mori vendimin e vet përfundimtar dhe e shpalli në Korrik 1998. Pak kohë pas emërimit në detyrë, Komisioni i Hetimeve nxorri në qarkullim një kërkesë për informim mbi punën e detyrimshme në Burmë, duke ia dorëzuar atë qeverive të zgjedhura, Organizatave Ndërkombëtare, OJQ-ve me, ose pa status konsultativ të ILO-s dhe kompanive me njohuri mbi Burmën. Sasia më e madhe e dokumentacionit të pranuar (duke përfshirë edhe atë të dorëzuar nga qeveritë), e kishte origjinën e saj nga raportet e përgatitura nga organizatat e pakicave dhe të vendësve dhe OJQ-ve të tjera të interesuara. Komisioni i Hetimeve organizoi dëshmi (dëgjime) në Gjenevë në Nëntor 1997, ku shumica e dëshmitarëve ishin përfaqësues të OJQ-ve ose viktime të punës së detyrimshme të banorëve të pakicave dhe njerëzve vendës. Në vizitën që ia bëri regjionit në fillim të vitit 1998, Komisioni i Hetimeve bëri 246 intervista, kryesisht me banorë të pakicave dhe të vendësve.

- Qeveria i pranoi Rekomandimet e Komisionit Hetimor në Shtator 1998, por nuk i zbatoi ato.

- Në 1999, Konferenca Ndërkombëtare e Punës e miratoi një Rezolutë duke deklaruar se situata

në Burmë është e papajftueshme me kushtet dhe principet e anëtarisë ndaj ILO-s, dhe se ILO-ja do të duhet të ndërpresë t'i ofrojë çfarëdo lloji të bashkëpunimit teknik ose ndihme ndaj qeverisë. Ekzistonte vetëm një lloj përjashtimi ndaj këtij restriksioni: ndihmë (asistencë) në zbatimin e Rekomandimeve të Komisionit të Hetimeve.

- Konferenca Ndërkombëtare e Punës në Qershor 2000 miratoi një Rezolutë tjetër bazuar në artikullin 33 të Kushtetutës së ILO-s, duke rekomanduar se nëse Burma nuk ndërmerr hapa konkrete për t'i zbatuar Rekomandimet e Komisionit të Hetimeve gjer më 30 Nëntor 2000, ILO-ja do t'i lusë anëtarët e vet konstituivë si dhe organizatat e tjera ndërkombëtare që t'i rishqyrtojnë marrëdhëniet e tyre me Burmën.⁶²

- Në Tetor, 2000 një ekip për bashkëpunim teknik e vizitoi Burmën për ta vlerësuar situatën, dhe për t'i ofruar shërbimet e tija Qeverisë.

- Në Nëntor 2000 duke u mbështetur në vizitën e ekipit për bashkëpunim, trupi drejtues i ILO-s konkludoi se Rekomandimet e Komisionit të Hetimeve nuk janë zbatuar. Drejtorja e përgjithshme kontaktoi me organizata ndërkombëtare dhe kërkoi nga ata që të ndalin çfarëdo bashkëpunimi me Burmën dhe të ndërpresin çfarëdo aktiviteteve që do të mund të përmbanin (në mënyrë direkte ose indirekte) ushtrimin e punës së detyrimit. Të gjithë përbërësit e ILO-s poashtu u nxitën që të rishqyrtojnë marrëdhëniet e tyre me Burmën dhe të ndërmarrin masa që do të sigurojnë që Burma s'do të mund të sheh përparim prej këtyre marrëdhënieve duke e përjetësuar punën e detyrimit.

- Në raportin e vet të vitit 2001, Komiteti i Ekspertëve vërejtë se në një letër të 29 Nëntorit të vitit 2000 dërguar Drejtorisë së Përgjithshme të ILO-s, qeveria e shprehur 'vullnetin e vet politik për të vërtetuar se nuk ka punë të detyrimit në Myanmar, as në ligj e as në praktikë', dhe Komiteti kërkoi nga qeveria që të jep raport në detale mbi çdo lloj përparimi të bërë në zbatimin e Rekomandimeve të Komisionit të Hetimeve.⁶³

- Burma u diskutua përsëri në Konferencën Ndërkombëtare të Punës në vitin 2001 dhe në Shtator 2001, ILO-ja dërgoi një ekip katër antarësh për tre javë që të rishikojnë se çfarë përparimi ishte bërë në zbatimin e Rekomandimeve të Komisionit të Hetimeve. Ekipi arriti në përfundim se, meqenëse qeveria kishte bërë pakë përparim, ai ishte i pamjaftueshëm dhe puna e detyrimit ende po praktikohet në masë të madhe.

- Burma mbetet nën inspektim.

3. Bangladeshi

Studimi i këtij rasti demonstroi se si vëmendja e vazhdueshme e ILO-s mund të ndihmojë që të ushtrojë shtypje në shtetet anëtare, me ndihmën e sindikatave dhe OJQ-ve.

- Që nga miratimi i parë i Konventës Nr.107 në vitin 1972 trupat mbikëqyrës të ILO-s e kanë pasë adresue çështjen e njerëzve vendës të regjionit Çitagong Hill Trakts (Chittagong Hill Tracts - shkurt CHT) . Dy çështjet kryesore kanë qenë - të drejtat e njerëzve dhe tokat (pronat tokësore).

- Komentet e Komitetit të Ekspertëve u intensifikuan në mesin e 1980-ve për shkak të vazhdimin të raporteve të shkeljeve të mëdha të të drejtave njerëzore të kryera nga forcat e armatosura, zakonisht në bashkëpunim të fshehtë me kolonë (ardhacakë) të sjellur nga rrafshinat në bazë të politikës qeveritare të transferimit të popullatës. Në 1985, duke ndjekur një observim të Komitetit të Ekspertëve mbi raportet e vazhdueshme të shpërdorimeve të të drejtave njerëzore, Komiteti i Aplikacioneve mbajti diskutime detale me Qeverinë lidhur me temën. Në Nëntor 1985, një përfaqësues i Drejtorisë së Përgjithshme e vizitoi Bangladeshin në një vizitë të Kontakteve Direkte.

- Komiteti i Ekspertëve në raportin e tij të 1986 shprehu keqardhje që për përfaqësuesin e Drejtorisë së Përgjithshme, gjatë vizitës së Kontakteve Direkte, kanë qenë organizuar 'vetëm diskutime të kufizuara' - përshkruar nga anëtarët e punëdhënësve në Komitetin e Aplikacioneve, si dështim nga Qeveria . Qeveria u thirr që të paraqitet përsëri përpara Komitetit të Aplikacioneve dhe në raport u fut një 'paragraf special', për të treguar seriozitetin e situatës. Gjatë diskutimeve në Komitetin e Aplikacioneve, detyra e Komitetit që t'i mbrojë pakicat dhe të dobëtit në Bangladesh si dhe në shtetet e tjera ku ky lloj problemi u rrit , ishte e theksuar.⁶⁴

- Komiteti i Ekspertëve bëri një Observim tjetër në 1987 mbi konfliktet e vazhdueshme ndërmjet njerëzve vendës (në një anë) dhe kolonëve dhe armatës (në anën tjetër), që referohej nga raportet e arritura nga OJQ-të, duke përfshirë edhe 'Amnesty International' dhe 'the International Work Group for Indigenous Affairs' - IWGIA - (Grupi Punues Ndërkombëtar për Çështje të Vendësve) . Qeveria u thirr që të paraqitet përsëri para Komitetit të Aplikacioneve në Qershor 1987 dhe u morr vendim për emërtim me 'paragraf special', duke e shtyrë Qeverinë të ndërmerr masa konkrete për zgjidhjen e situatës.

- Në 1988 ILO-ja e pranoi një 'vërejtje' (koment) nga ana e 'the International Confederation of Free Trade Unions' (ICFTU) (Konfederata Ndërkombëtare e Sindikatave të Lira) lidhur me raportet e shkeljeve të të drejtave njerëzore të njerëzve vendës në CHT, përfshirë këtu edhe të drejtën për jetesë dhe siguri fizike. ICFTU në kontekst të Artikullit 13 të Konventës Nr.107 mbi të drejtat e pronës tokësore⁶⁵, gjithashtu e ngriti çështjen e:

'Derdhjes (ardhjes) masive të kolonëve jo-fisnorë në Chittagong Hill Tracts për vite me rradhë dhe

të një numri të madh të raporteve ... [të] dhunës dhe rrëmbimeve me forcë me qëllim që të cënohet toka - pronë e popullatës fisnore vendëse’.

- Kjo gjë e ngriti vëmendjen e ILO-s ndaj çështjes së CHT dhe në 1988 u ndërmor një vizitë tjetër e Kontakteve Direkte në Bangladesh që raportoi se nuk është bërë kurrfarë përparimi të vërtetë nga ana e Qeverisë për t’a zgjidhur situatën në CHT.

- Në 1989, Komiteti i Aplikacioneve pati sërish diskutime detale me Qeverinë, duke përsëritur se hapa të tutjeshëm duhen patjetër të ndërmirren, duke përfshirë : shqyrtim efektiv të shkeljeve të të drejtave njerëzore, njohje (pranim) dhe demarkim (përcaktim) të të drejtave tokësore, dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve ndërmjet njerëzve vendës dhe kolonëve.

- Situata në CHT mbeti nën vëzhgim të Komitetit të Ekspertëve me Observime të pranuar praktikisht çdo vjet ndërmjet 1990 - 1998. Në rishqyrtim të situatës në CHT- Komiteti i mirrte në konsiderim edhe informatat të ofruara nga Qeveria , si dhe ato të ofruara nga organizatat e vendësve, të OJQ-ve (‘Anti-Slavery Int.’, ‘IWGIA’, ‘Minority Rights Group International’ dhe ‘Survival International’) dhe të trupave të KB-së. Kjo gjë ndihmoi që të mbahet çështja e CHT nën vështrim të përqëndruar publik. Në 1997 u nënshkrua një marrëveshje e paqës ndërmjet Qeverisë së Bangladeshit dhe të njerëzve vendës.

- Çështja e CHT mbetet nën rishikim, dhe komentet e fundit të Komitetit të Ekspertëve janë përqëndruar në zbatimin e marrëveshjes paqësore, nën kontekst të vijimit të raporteve të përdorimit të dhunës. Çështjet tjera të ngritura nga Komiteti përqëndroheshin në shkeljen e të drejtave njerëzore, pronat tokë - sore dhe ri-atdhesimin e (kthimin e) refugjatëve , duke e përqëndruar vëmendjen në nevojën për të zgjidhur problemet e vazhdueshme në CHT.⁶⁶

4. Meksikoja

Raporti vijues është një ilustrim se si Konventa Nr.169 është monitorue dhe si munden organizatat e punëtorëve të bashkëpunojnë me organizatat e vendësve në paraqitjen e ankesave para ILO-s.

- Gjatë kryengritjes së ashpër në Chiapas, Meksiko, qeveria e Meksiko-s u thirr që të paraqitet para Komitetit të Aplikacioneve në Qershor të 1995. Në observimin e tij të 1996, Komiteti i Ekspertëve vazhdoi me Rekomandimet e Komitetit të Aplikacioneve që të mirret parasysht ndihma teknike e ILO-s -‘me qëllim të ngritjes së mbrojtjes themelore të punëtorëve vendës dhe të përmirsimit të kushteve të punës’⁶⁷.

- Në Shkurt 1996, Qeveria e Meksikos dhe Armata Nacional Çlirimtare e Zapatista-s (Zapatista Army of National Liberation) (EZLN) nënshkruajtën një marrëveshje të paqës në San Andres, si pjesë e procesit të paqës në Chiapas. Konventa u përdor si pikë referuese në

negociatat.⁶⁸

- Në 1997, Komiteti i Ekspertëve e vazhdoi vështrimin e përqëndruar ndaj situatës në Meksiko dhe komentonte mbi: (i) procesin e konsultimeve anembanë vendit mbi të drejtat dhe pjesmarjen e njerëzve vendës, që rezultoi në një Rekomandim për përshtatje më të mirë (më të plotë) të ligjshmërisë nacionale me Konventën; (ii) Komete nga ana e Frontit Autentik Punëtor (‘Authentic Labour Front’ ose në origj. ‘Frente Autentico del Trabajo’), ‘që vërtetonin shkeljen e Konventës për arsye të konflikteve të lidhura me konstruktimin e një pende hidroelektrike në Oaxaca’; dhe (iii) çështjen e eksploatimit të punëtorëve vendës me zbatimin e ‘enganche’-së (formë e regrutimit të detyrueshëm). Komiteti gjithashtu e përsëriti ofertën e ndihmës teknike nga ana e ILO-s.⁶⁹

- Në Janar 1997 u soll një paraqitje në bazë të Artikullit 24 kundër Qeverisë, parashtruar nga Sindikata Nacionale e Punëtorëve Edukativë (National Trade Union of Educational Workers -/ SNTTE) , Radio Edukimi (‘Radio Education’) që dëshmonin për mosrespektimin e Konventës Nr.169. Ajo u soll me anë të sindikatës në emër të ‘Unionit të Huichol banorëve vendës të Jalisco-s’ (‘Huichol Indigenous Communities of Jalisco’) në lidhje me kërkesat e tyre historike ndaj tokave të tyre tradicionale.

- Paraqitja u pranua dhe u krijue një komitet trepalësh për ta shqyrtue rastin. Në Qershor 1998 Trupi Drejtues e pranoi raportin e këtij komiteti, i cili kishte gjetur se Qeveria nuk iu është përmbytur obligimeve të veta për t’i mbrojtur të drejtat e banorëve të fiseve Huichol mbi tokat që ata i kanë pasë zotëruar. Ai rekomandonte që Qeveria do të duhej të sigurojë mbrojtje efektive të të drejtave të banorëve Huichol mbi pronat e tyre , si që kërkohet në bazë të Artikullit 14 të Konventës (Marrëveshjes); dhe ajo duhej të ndërmerr masa të posaçme për të mbrojtur ekzistencën dhe mënyrën e tyre të jetesës, duke përfshirë dhënie të tokave të mjaftueshme banorëve Huichol ‘për të siguruar kushtet esenciale për një ekzistencë normale ose për çfardo shtese të mundshme në numër të tyre, në pajtim me Artikullin 19 të Konventës ...’⁷⁰

- Në 1999 Komiteti i Ekspertëve kërkoi nga Qeveria informata se çfarë masash ka ndërmarrë ajo për të zbatuar Rekomandimet e komitetit trepalësh.⁷¹

- Në 1998, një paraqitje tjetër në bazë të Artikullit 24 u soll kundër Qeverisë - parashtruar nga ‘ Sindikata Radikale e Punëtorëve Metalikë dhe të Ngjajshëm’ - (‘Radical Trade Union of Metal and Similar Workers’), që pohonte mos-respektim të Konventës Nr.169, në lidhje të veçantë me furnizimin e tyre me pronat tokësore. Kjo paraqitje ishte në lidhje me konstruktimin e pendës Cerro del Oro në San Lucas Ojitlan, Oaxaca, dhe

përfshinte çvendosje me force të familjeve vendëse - Chiantec nga tokat e tyre tradicionale në luginën Uxpanapa.

- Komiteti tre-palësh e përfundoi shqyrtimin e tij të rastit dhe gjeti se anise Konventa Nr. 169 nuk mundej të zbatohet në mënyrë retroaktive (penda ishte e konstruktuar në 1972) pasojat e saja vazhdonin të kenë efekt të drejtpërdrejtë në njerëzit vendës - kështu Konventa gjeti zbatim; ai prandaj i rekomandoi Qeverisë që të konsultohet me këta njerëz për të kërkuar një zgjidhje ndaj problemeve me të cilat ata po ndesheshin. Trupi Drejtues e mori vendimin e tij në Nëntor 1999, dhe në 2000 Komiteti i Ekspertëve kërkoi nga Qeveria që të ofrojë informata plotsuese mbi masat e ndërmarruna për zbatimin e Rekomandimeve të komitetit tre-palësh.

- Në komentimin e vet ndaj të dy paraqitjeve - Komiteti i Ekspertëve observoi:

*“Të dy paraqitjet e bazuara në Artikullin 24 rezultuan që Trupi Drejtues të shqetsohet nga shkakut i mungesës së dukshme të dukshme të dialogut ndërmjet Qeverisë dhe bashkësive vendëse, për të diskutuar situatën e tyre dhe për të gjetur përgjigje problemeve të tyre në frymë konsultative , në të cilën kjo Konventë edhe mbështetet”.*⁷²

- Rasti i Meksikos u diskutua në thellësi në Konferencën Ndërkombëtare të Punës të vitit 2000 nga ana e Komitetit të Aplikacioneve, që mbajti diskutime detale me Qeverinë dhe kërkoi të furnizohet më tutje me informata plotsuese mbi masat e ndërmarruna për zbatimin më efektiv të Konventës, posaçërisht për Rekomandimet e dy komiteteve tre-palëshe. Grupi i punëtorëve në konferencë shprehën dëshirë që t'a çojnë këtë rast më tutje (më lartë) gjatë konferencës së vitit 1999, megjithatë, si që u përmend më herët te procedura e ankesave, një çështje e pazgjidhur - nën paraqitje të bazuar në artikullin 24 - mund të diskutohet vetëm pasiqë çështja e paraqitjes të jetë e mbyllur (përfunduar).

- Rasti i Meksikos mbetet nën shqyrtim nga ana e ILO-s.

Këto janë vetëm disa shembuj se si mund të përdoret ILO-ja për të diskutuar problemet që i hasin njerëzit vendës me Qeverinë përkatëse, si një mënyrë që siguron masa për të zgjidhur situatën. Megjithatë, si që u përmend më herët, këto iniciativa, sikur edhe të gjitha proceset ndërkombëtare, kërkojnë kohë të duhur dhe vëmendje, dhe patjetër duhen nisur me perspektivë të gjatë kohore.

Shpresohet se studimet e këtyre rasteve do t'i inkurajojnë të tjerët që të punojnë me ILO-n, me qëllim që t'i përkrahin të drejtat dhe çështjet e pakicave dhe të njerëzve vendës.

VI. Si të punohet me ILO-n

1. Qasja në ILO

Forca e ILO-s qëndron në monitorimin se si shtetet anëtare i respektojnë obligimet e tyre, dhe në përqëndrimin e vëmendjes në lëshimet dhe gabimet e tyre, sikur edhe në zhvillimet pozitive. Megjithatë, është me rëndësi të mbahen në mend edhe kufizimet e ILO-s si një organizatë ndërqeveritare- ndërkombëtare. Përderisa akcionet dhe vendimet e saja mbajnë një autoritet moral dhe ushtrojnë influencë bindëse, ILO-ja nuk mundet të ngarkojë me masa ndëshkimore.

Si masë ekstreme, anëtarët mund të përjashtohen nga ndihma teknike ose tjetërfare e ILO-s, si në rastin e Burmës (shih Kapitullin VII). Kërkesa e ILO-s dërguar organizatave qeveritare ndërkombëtare dhe grupeve të punëtorëve e të punëdhënësve, që t'i shqyrtojnë marrëdhënjet e tyre me Burmën - që të garantojnë se ata nuk jepnin kontribut në punën e detyrueshme- ishte një mesazh shumë i fortë, një që mund të përdorej nga OJQ-të duke dashur të ushtrojnë shtypje në qeveritë dhe kompanitë lidhur me investimet e tyre në Burmë ose në ndihmë të Qeverisë së Burmës.

Si rregull e përgjithshme-qeveritë janë shumë të ndieshme ndaj vështirimit të përqëndruar publik dhe ekzistimi i mos përputhjeve ndërmjet ligjit nacional dhe praktikës (në një anë) dhe obligimeve ndërkombëtare të theksuara (në anën tjetër) mund të veprojnë si katalizator për ndryshime pozitive. Mekanizmat e ILO-s për lëshim pe, raportet dhe dokumentet tjera sigurojnë njëfarë horizonti për përqëndrimin e vëmendjes ndaj rasteve të posaçme të shkeljeve të të drejtave njerëzore, dhe nuk do të duhej të mos vërehen (tejkalohe) nga organizatat e pakicave dhe të vendësve, dhe nga OJQ-të e tjera të interesuara - gjatë gjurmimeve të rrugëve të ndryshme për mbrojtje më efektive të të drejtave.

Sadoqë partnerët tradicionalë të ILO-s janë qeveritë dhe organizatat e punëdhënësve e të punëtorëve, edhe organizatat e pakicave dhe të vendësve, si dhe OJQ-të tjera të interesuara mund të marrin pjesë në aktivitetet dhe proceset e ILO-s. Kjo gjë mund të bëhet me anë të:

- Njërit nga anëtarët trepalësh të ILO-s;
- Si një OJQ në Listën Speciale të ILO-s;
- Mënyrës së drejtpërdrejtë.

1.1 Me anë të qeverive, organizatave të punëdhënësve dhe të punëtorëve

Kjo është zakonisht rruga më e thjeshtë për t'u qasur në ILO. Për shembull, gjatë miratimit të Konventës Nr.169 të ILO-s njerëzit vendës marrin pjesë në trupa të ndryshëm të ILO-s si pjesëtarë të delegacioneve zyrtare.

- Prej tre partnerëve tradicionalë, organizatat e sindikatave janë përgjithsisht më të hapura ndaj

çështjeve të pakicave dhe të vendësve. Ata shpeshherë kanë ndihmuar që çështjet e vendësve të sillen në vëmendjen e ILO-s edhe me punë të rregullt në Komitetin e Ekspertëve, sikur edhe me procedurat konstitucionale të veçanta. Për shembull, të gjitha paraqitjet bazuar në Artikullin 24, të sjellura nën Konventën Nr.169 janë prurë nga sindikatat, në emër të bashkësive vendëse dhe të organizatave të tyre. Në shprehje të mbrojtjes, kjo është pika themelore e ndikimit për organizatat e pakicave dhe të vendësve dhe të OJQ-ve tjera të interesuara.

- Ai mund të jetë një sindikatë lokale, kombëtare ose ndërkombëtare. Për shembull, sindikata ICFTU - (International Confederation of Free Trade Unions) (Konfederata Ndërkombëtare e Sindikatave të Lira) që është themeluar në Bruksel, ka prurë një numër të konsiderueshëm të çështjeve në vëmendje të ILO-s.

Shënim: Sindikata mundet edhe të mos jetë prej të njejtit shtet, por ajo duhet patjetër të jetë një organizatë punëtore. Në rastin e sjellur kundër Danimarkës (përmendur në Kapitullin VI) një paraqitje - bazuar në Artikullin 24 në emër të Grenlandës u pru nga ana e një organizate të punëtorëve vendës.

1.2 OJQ-të

ILO-ja vendosi që ajo t'i formalizojë marrëdhënjet e ILO-s me organizatat - jashta atyre që u takojnë organizatave të punëdhënësve e të punëtorëve, të cilat qëllimet dhe objektivat i kanë në pajtim me qëllimet, parimet dhe frymën e Kushtetutës dhe të Deklaratave të ILO-s, dhe që (do të) luajnë një rol të rëndësishëm në punën e saj.

Ekzistojnë tre kategori të OJQ-ve në ILO:

- OJQ-të ndërkombëtare me interes të rëndësishëm në gjërësi të madhe të aktiviteteve të ILO-s. Këtyre iu njihet statusi konsultativ - i përgjithshëm ose regional.
- OJQ-të ndërkombëtare me interes të pjesërishëm- p.sh. për takime të posaçme. (Cilado OJQ e interesuar për të punuar me ILO-n në ndonjë hapësirë të posaçme do të duhej të kontaktonte ILO-n dhe të kërkojë të jetë e informuar mbi çfardo mbledhje përkatëse.)
- Lista Speciale e OJQ-ve ndërkombëtare.

Prej këtyre, kategoria e tretë është më relevante. Për t'u vendosur në Listën Speciale të ILO-s, të OJQ-ve - një OJQ duhet t'i ketë përmbushur këto kritere:

- Duhet dorëzuar ILO-s një lutje formale në formë të shkruar;

OJQ duhet patjetër të demonstrojë se qëllimet dhe objektivat e saja janë në harmoni me qëllimet, parimet dhe frymën e ILO-s;

- Ajo duhet të ketë një lloj interesimi të dukshëm në, së paku, njërën prej fushave të veprimtarisë së ILO-s;
- Ajo duhet të jetë një organizatë ndërkombëtare me përfaqësi ose filiala në shtete të ndryshme;
- Bashkë me lutjen ajo duhet patjetër të dorëzojë :raporte vjetore, një kopje të statuteve të saja, përbërje të anëtarisë, emrat dhe adresat e zyrtarëve të saja dhe informata të saja të vlefshme që i kanë;
- Posa të pranohet një lutje, Trupi Drejtues e shqyrton atë dhe vendos se a do të duhej vendoset OJQ-ja gjegjëse në Listën Speciale.
- Lutjet për të ndjekë një mbledhje të posaçme (për pjesëmarrje) duhen patjetër të kenë arritur së paku një muaj para sesionit të Trupit Drejtues duke i paraprirë mbledhjes;
- Statusi oficial, d.m.th akreditimi me Këshillin Ekonomik ose Social të KB, ose ndonjë agjencion tjetër të specializuar të KB-është i rëndësishëm, por jo esencial ;
- OJQ në listën speciale mund të kërkojnë të furnizohen me thirrjet për të marrë pjesë në mbledhjet e ILO-s që janë në lidhshmëri me qëllimet dhe objektivat e tyre. ILO-ja siguron informim për këto mbledhje. Ata gjithashtu mund të kërkojnë të jenë të thirrur për Konferencën Ndërkombëtare të Punës.
- OJQ-të e Listës Speciale marrin pjesë si vëzhgues (observerë) pa leje për votim.
- OJQ-të e vendësve në Listën Speciale janë: 'Këshilli i Katër Drejtimeve' ('the Four Direction Council') ; 'Asociacioni Botëror i Vendësve' ('Indigenous World Association'); 'Këshilli Saami' ('Saami Council') dhe 'Këshilli Botëror i Njerëzve Vendës' ('World Council of Indigenous Peoples'-WCIP).
- OJQ-të ndërkombëtare në Listën Speciale përfshin: 'Org. Ndërkombëtare për Amnesti' ('Amnesty International'), ' Org. Ndërkombëtare Kundër Skllavërisë' ('Anti-Slavery International'), 'Qendra Ndërkombëtare për të Drejta Njerëzore dhe Zhvillim Demokratik' ('International Centre for Human Rights and Democratic Development'), 'Komisioni Ndërkombëtar për Juristë' ('International Commission for Jurists'), 'Trupi Punues Ndërkombëtar për Çështje të Vendësve' ('International Work Group for Indigenous Affairs'-IWGIA), 'Organizata Ndërkombëtare për Mbijetesë' ('Survival International') dhe 'Këshilli Botëror i Kishave' ('the World Council of Churches').

Shënim: OJQ-të nacionale mund të punojnë me ILO-n duke hapur filialë në ndonjë OJQ ndërkombëtare. Ata gjithashtu mund të kontaktojnë me zyrën lokale të ILO-s, duke u bërë të njohur fushën e tyre të interesimit, dhe të kërkojnë të informohen për çfarëdo mbledhje ose çështje që do të mundet të jetë e rëndësishme për punën e tyre.

Ata mundën poashtu të kenë rol të rëndësishëm në rastet e hetimeve dhe të dokumentimeve të Konventave të ILO-s me anë të publikimeve dhe seminareve (zyrave) konsultative.

Për detale plotësuese kontaktoni:

ILO Bureau for External Relations and Partnerships
ILO
Geneva 22
CH 1211, Switzerland
Tel: + 41 22 799 7867
Fax: + 41 22 799 7146
e-mail: exrel@ilo.org

1.2 Drejtpërdrejtë

OJQ-të mund të marrin pjesë në këto mënyra:

- Mitingje dhe seminare - Organizatat e pakicave dhe të vendësve dhe OJQ-të e interesuara mund të marrin pjesë në mbledhjet dhe rastet e ILO-s të cilat janë të rëndësishme për ta, psh.-ushtrimi për standardet. Këto janë ngjarje ad - hoc (speciale) dhe bëhen përgjithësisht sipas thirrjes së zyrës organizuese ose programit të ILO-s.
- Informime - Informimet e pranuar nga organizatat e pakicave të vendasve dhe nga OJQ-të tjera të interesuara, do të arrijnë gjer në trupin gjegjës nëse ata përmbajnë fakte të rënda, d.m.th informata të vërtetueshme ose fakte të njohura mirë. Këto informime mund të përfshijnë dokumente publike siç janë marrëveshjet, vendime të rasteve, ligje, rregullativë, raporte etj. Për shembull: raportet prej Amnesty International, Anti - Slavery International, Human Rights Watch, IWGIA, dhe MRG - të gjitha janë përdorur për referencë nga trupat drejtues.
- Proçesi i raportimit - Në një shembull unik (proçes), Parlamenti Sami i Norvegjisë i dërgon komentet e veta në ILO- mbi zbatimin e Konventës Nr.169 në Norvegji. Ky është rezultat i një pajtimi ndërmjet Qeverisë së Norvegjisë dhe Parlamentit Sami me anë të të cilit - raporti i parlamentit formon një pjesë të raportit zyrtar të qeverisë-dërguar Komitetit të Ekspertëve. Komiteti i inkurajon edhe qeveritë tjera që të ndjekin këtë shembull të bashkëpunimit.
- Programet teknike - Për grupet vullnetare janë dizajnuar dhe zbatuar projekte dhe programe të ndryshme të ILO-s, në bashkëpunim me ta. Programi Nërkombëtar për Eliminimin e Punës së Fëmijëve (IPEC) u ka dhënë OJQ-ve një rol të rëndësishëm në zbatimin programeve të tija. Ky inovacion i kohës së fundit në praktikën e ILO-s është në pranim të kompleksitetit të këtyre çështjeve, dhe nevojës për të i arritur (përfshirë) bashkësitë (komunitetet) në nivel lokal nëpërmes asociacioneve dhe organizatave që nuk janë të lidhura me lëvizjen puntore. Kjo gjithashtu mund të mvishet pjesërisht faktit që në disa situata mund të paraqitet konflikti i interesave me grupet e punëdhënësve dhe/ose të punëtorëve. Për

shembull, organizatat e punëtorëve dhe të punëdhënësve mund të mos jenë në pëlqim rreth kushteve më të mira të punës për punëtorët e palidhur me organizatat. Projekti INDISCO dhe Projekti për Përkrahjen e Konventës Nr. 169 (shih kapitullin IV) poashtu bashkëpunojnë ngushtë me organizatat e pakicave dhe të vendit dhe OJQ-të e interesuara. Këto janë tregues të rëndësishëm të qëndrimit më të hapur të ILO-s ndaj OJQ-ve.

1. Puna me ILO-n

Këto janë pikat që duhen patur në mend kur zotohemi të punojmë në ILO-n:

1.1 Temë - përmbajtja

- Vërtetohu se çështja që dëshiron ta ngrisish (parashtrish) bie në brendi të mandatit të ILO-s. Për të bërë këtë juve ju duhet të identifikoni Konventën e ILO-s e cila kaplon hapsirën e juaj të interesit:
 - Ju mund të konsultoni listën e plotë të Konventave të ILO-s dhe të teksteve në Website-in e ILO-s (e cila është në dispozicion në shumë gjuhëra, duke përfshirë Anglisht, Frengjisht, gj.Spanjolle) në www.ilo.org⁷³ ose ju mund ta merrni atë nga ILO-ja.
 - Kjo është sidomos e rëndësishme nëse ju dëshironi të bëni shfrytëzim të plotë të sistemit mbikëqyrës të ILO-s, psh.një paraqitje në bazë të Artikullit 24, pasi referimet duhen patjetër bërë ndaj Artikujve të posaçëm të Konventës përkatëse dhe duhen patjetër vërtetuar se si ata nuk po respektohen.
 - Mbani në mend se në parashtrim të çështjes mund të jenë relevante më tepër se vetëm një Konventë.
 - Për shembull, nëse organizata e juaj është e interesuar mbi ushtrimin e politikës diskriminuese në punësim ndaj grupeve të vendësve në një vend (shtet) të caktuar, atëherë mund të jenë me relevancë Konventa Nr.100 mbi Shpërbimin e Barabartë në Punë, Konventa Nr.111-mbi Diskriminimin (në Punësim dhe Punë) dhe Konventa Nr.169 mbi Njerëzit Vendës dhe Fisnorë.
 - Nëse juve ju duhen informata plotësuese mbi këtë çështje, ju mund të kontaktoni zyrën më të afërt të ILO-s për sqarime. (Kontakttoni ilo@ilo.org për listën e zyrave regjionale).

2.2 Miratimi

- Posa të jeni bindur se si çështja e juaj përshtatet me strukturën e Konventave të ILO-s ju duhet të kontrolloni se a i ka miratuar Konventat, për të cilat ju jeni të interesuar, shteti në të cilën ju punoni.
 - Ju mund ta bëni këtë duke kontrolluar në një libër të botuar nga ILO i cili i nxjerr në listë të gjitha shtetet që i kanë miratuar secilën Konventë - Listë e Miratimeve sipas Konventave dhe sipas

Shteteve, Raporti III (Pjesa2) (List of Ratifications by Convention and by Country, Report III-part2), të cilën mund ta fitoni prej zyrave të ILO-sose nëpërmjet internetit në ILOLEX database ose Website-in e ILO-s.⁷⁴

- Nëse qeveria nuk e ka miratuar Konventën që është drejtpërdrejt e rëndësishme, atëherë kontrolloni se a mundeni që ta parashtroni të njejtën informatë (çështje) nën kompetencë të ndonjë Konvente tjetër, të cilë ai shtet e ka miratuar.

- Në disa qeveritë mund të thirren që të raportojnë mbi Konventat që ata nuk i kanë miratuar. Shih seksionet mbi Vështirimet e Përgjithshme (Kapitulli V) dhe Deklarata mbi Parimet dhe të Drejtat Fundamentale në Punë (Kapitulli VI), si dhe Procedurat e Ankesave (Kapitulli VI) - për detale mbi atë se kur dhe si këto procedura arrijnë efekt.

2.3 Hulumtimi

- Pastaj, ju duhet të siguroheni se a i keni të gjitha informatat e fundit. Këtu do të duhej të përfshiheshin - aktiviteti i ILO-s në kohë të fundit si dhe çfardo Konventash të bëra nga qeveria ose cilado organizatë sindikale dhe e punëtorëve- në lidhje me çështjen. Ekziston një numër i konsiderueshëm i raporteve të ILO-sqë nevoiten të rishikohen, prej të cilave më të rëndësishëm janë:
 - Raporti i kohës së fundit i Komitetit të Ekspertëve (Raporti III, Pjesa 1A) i cili mund të mirret nga ILO-ja ose mund të kërkohet nga Website-i i tyre.⁷⁵ Ky i kaplon vendimet (përfundimet) e Komitetit në bazë të Konventave dhe në shteteve gjegjëse, dhe publikohet në Mars të çdo viti. Ky është një raport shumë i dobishëm. Ai ka poashtu edhe një numër të treguesve, duke përfshirë edhe një që jep hollësi të komenteve të organizatave sindikale ose të punëdhënësve mbi shtetet dhe Konventat. Këto mund të jenë të dobishme për identifikimin e partnerëve të mundshëm për bashkëpunim.⁷⁶
 - Gjithashtu kontrolloni se a ka qenë shteti në pyetje subjekt i ndonjë paraqitjeje, ankese ose procedure të posaçme në lidhje me lirinë e asociimit. Kjo gjë mund të gjindet poashtu në Raportin Vjetor të Komitetit të Ekspertëve (Pjesa e Parë, Raporti i Përgjithshëm), nën 'Procedurat Konstitucionale dhe të tjera' - (Committee of Experts' Annual Report /Part one, General Report/, 'Constitutional and other procedures').
 - Vendimet specifike mbi këtë shtet, nga raporti i fundit i Komitetit të Standardeve - shih Pjesën e Dytë të raportit të tij të titulluar *Observimet dhe informimet që kaplon shtete në veçanti (Observations and information concerning particular countries)*.⁷⁷
 - Kontrolloni edhe atë se a është marrë në shqyrtim shteti dhe Konventa për të cilën ju jeni

të interesuar, dhe nëse -po, atëherë çfarë përfundimesh janë sjellë.

Aty ku ekziston një histori e përfshirjes së ILO-s me një çështje të posaçme, hulumtimi i juaj do të ju bëjë të ditur se çfarë ka thënë dhe bërë ILO-ja gjer në kohën e fundit ⁷⁸ dhe poashtu se cila është pozita e qeverisë lidhur me pajtueshmërinë e qeverisë me Konventën në pyetje:

- Posa të furnizoheni me këtë informatë, ju mund të siguronit se paraqitje e juaj (parashtrimi i juaj) përqëndrohet në çështjet e debatimit dhe siguron evidencë që vërteton se qeveria nuk i përmbahet zbatimit të obligimeve të tija nën Konventën përkatëse.

- Nëse, pas kontrollimit të këtyre raporteve, ju nuk gjeni kurrfarë komentesh lidhur me Konventën ose shtetin që ju intereson, kjo tregon se Komiteti i Ekspertëve nuk ka pranuar kurrfarë informatash të rëndësishme lidhur me atë shtet dhe Konventë nga qeveria e përfshirë. Në atë rast, çfardo informate relevante që ju mund ta gjeni, mund të jetë posaçërisht e dobishme.

2.4 Parashtrimi i informatës

- Tani që ju i keni të gjithë këto informata, ju duhet të vendosni se si do të veni informatën në dispozicion të Komitetit të Ekspertëve, dhe cila është rruga më e mirë që të ndiqet:

- A do të ndiqni raportimin e rregullt, procedurën e komentimit ose procedurat konstitucionale speciale.

- Gjatë vlerësimit të këtyre ju duhet të peshoni me kujdes lëndën e informimit që ju e keni mbledhur dhe cila do të kishte qenë metoda më e mirë për t'a përdorur, bazuar në informatën dhe kushtet mbisunduese (egzistuese).

- Ju mund të shprehni dëshirë të lidheni me organizata tjera me qëllim të siguronit informata plotësuese, të diskutoni që të bëni paraqitje të bashkuara (të përbashkëta) ose të merni parasysh përdorimin e aspekteve alternative të sistemit mbikëqyrës të ILO-së, si p.sh. procedura e paraqitjeve ose e ankesave.

2.5 Orari i ILO-së

- Pas marrjes parasysh të këtyre pikave ju poashtu do të duhet të shikoni në orarin e trupave mbikëqyrës të ILO-së për shqyrtimin e parashtrimeve, ashtu që ju të mund të planifikoni që puna e juaj të jetë e suksesshme.

- Planifikuesi i akcionit i dhënë më poshtë thekson disa nga pikat kryesore gjatë vitit kur informata duhet të rishqyrtohet dhe kur duhet të parashtrihen raportet.

Planifikuesi për akcion për përdorimin e sistemit mbikëqyrës të ILO-së

Shkurt-ILO-ja kërkon nga qeveritë të dërgojnë raportet për atë vit. Ajo gjithashtu kërkon prej qeverive të japin përgjigje (reagim) ndaj çfarëdo Observimeve ose kërkesave direkte nga Komiteti i Ekspertëve ose ndaj komenteve nga cilado prej trupave mbikëqyrës të ILO-s. Raportet për atë vit duhen paraqitur nga qeveritë në adresë të ILO-s ndërmjet 1 Qershorit dhe 1 Shtatorit për t'u shqyrtuar nga Komiteti i Ekspertëve në Nëntor. Qeveritë duhet të dërgojnë kopjet e raporteve të tyre edhe organizatave përfaqësuese nacionale të sindikatave dhe të punëdhënësve.

- **Akcion** - Kontaktoni ndonjë organizatë të punëdhënësve ose të punëtorëve dhe pyetni se a ka pranuar ajo një kopje të raportit qeveritar. Nëse po, kërkonte a mundeni ju të rishikoni deklaratën e qeverisë. Në bazë të kësaj, ju pastaj mundeni të pregaditni një raport plotsues për t'ia dorëzuar ILO-s, qoftë drejtpërdrejt ose, me qëllim që ai të ketë peshë më të madhe, nëpërmes ndonjë sindikate miqësore.

Mars - Publikohet raporti (i vitit të kaluar) i Komitetit të Ekspertëve.

- **Akcion** - Analizoni raportin bazuar në shtete dhe/ose në Konventa. Përfundimet e Komitetit të Ekspertëve janë të çmuara lartë, dhe nëse ajo është e (ose ata janë të) përshtatshme, mund të publikohen dhe të përmenden në përkrahje të fushatës së organizatës suaj.

- Duhet t'u kushtoni vëmendje të posaçme çfardo Observimeve të bëra nga Komiteti, pasi këto janë çështje ku ato janë të përqëndruara dhe prandaj edhe të tilla që ju duhet t'i keni në konsiderim.

